



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

RAPORTI I MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024 - 2030

Tiranë më, 16.04.2026

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Informacion përmbledhës mbi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planit të Veprimit 2024-2026

- 1.1 Hyrje
- 1.2 Metodologjia e monitorimit
- 1.3 Konsultimi publik

II. Progresi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe i Planit të Veprimit 2024-2026

- 2.1 Reforma të implementuara me sukses në periudhën përkatëse
- 2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritimit evropian
- 2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit
- 2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

III. Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

- 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit
- 3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit
- 3.3 Konkluzione dhe rekomandime

IV. Progresi lidhur me objektivat, rezultatet dhe impaktin

- 4.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit
- 4.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit
- 4.3 Konkluzione dhe rekomandime

V. Risqet dhe hapat për tu adresuar

- 5.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit
- 5.2 Hapat e radhës

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AMP	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
AK	Autoritetet Kontraktore
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMSHC	Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AP	Autoritete Publike
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronës
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
AS	Akademia e Sigurisë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
ALTRI	Instituti Shqiptar për Kërkime Ligjore dhe Territoriale
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPAK	Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DSHPA	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës
DVP	Drejtoria Vendore e Policisë
CPL	Corruption Proofing of Legislation/Vlerësim I hapësirës për korrupsion në legjislacion
COD	Qendra për Hapje dhe Dialog
EKB	Enti Kombëtar i Banesave
ERRE	Enti Rregullator i Energjisë
EJCN	Rrjeti Gjyqësor Evropian për Krimin Kibernetik
GMR	Grupi i Menaxhimit të Risqeve
GJKKO	Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
INSTAT	Instituti i Statistikave
IP	Inspektorati i Përgjithshëm
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
IPSIS/SIPI	Sistemi Informatik I Planifikimit të Integruar
ICC	Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IKMT	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KL.GJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KMSHC	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KSHZ	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
KSH	Kuvendi i Shqipërisë
MAPA	Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MF	Ministria e Financave
MSHMP	Ministër Shteti për Marrdhëniet me Parlamentin
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHPV	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor
MSHSKB	Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
OSHC	Organizatet e Shoqërisë Civile
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OPGJ	Oficer i Policisë Gjyqësore
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PSH	Policia e Shtetit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
QKVT	Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale
QTTB	Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësorë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
REKPD1	Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve
RASH	Qendra Ndërinstitucionale Rrjeti Akademik Shqiptar
RAI	Iniciativa Rajonale Antikorrupsion
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës

SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SND	Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë
EACIDS	Sistemi elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave private
SHM	Shkolla e Magjistraturës
TVP	Trajnimi I Vazhdueshëm Profesional
UAT	Universiteti i Arteve Tiranë
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
UT	Universiteti i Tiranës
UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
WBCJ	Projekti i Drejtësisë Penale në Ballkanin Perëndimor
ZRA	Zyra e Rikuperimit të Aseteve

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 përbën kuadrin kryesor të politikave dhe masave në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri. Strategjia vendos një qasje të integruar, të bazuar në parandalim, ndëshkim dhe ndërgjegjësim, në përputhje me standardet evropiane dhe angazhimet e vendit në procesin e integritetit.

Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2025 paraqet progresin e arritur në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të saj të Veprimit, duke evidentuar zhvillimet kryesore, sfidat e hasura dhe prioritetet për vijim.

Raporti bazohet në të dhënat e raportuara nga institucionet zbatuese, të përpunuara dhe të konsoliduara përmes një procesi të strukturuar monitorimi, të koordinuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në rolin e sekretariatit teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Gjatë vitit 2025, fokusi ka vijuar të mbetet te **parandalimi i korrupsionit**, përmes miratimit të paketës ligjore “Antikorrupsion”, si dhe përmes miratimit dhe vendosjes së rregullave të vlerësimit përmes Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik dhe Metodologjisë së Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në shërbimet e Kuvendit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar forcimit të instrumenteve të integritetit, mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike, në autoritetet e pushtetit qendror dhe vendor.

Në drejtim të **ndëshkimit**, janë intensifikuar përpjekjet për rritjen e efektivitetit të hetimit dhe ndjekjes penale të korrupsionit, përmes forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, rritjes së kapaciteteve teknike dhe analitike të strukturave ligjzbatuese dhe përmirësimit të cilësisë së referimeve dhe hetimeve. Është vërejtur një rritje e qasjes proaktive në hetime, si dhe një përdorim më i gjerë i mjeteve analitike dhe aksesit në databaza shtetërore.

Në fushën e **ndërgjegjësimit**, janë zgjeruar format e komunikimit publik dhe edukimit për integritet, përmes integritetit të tematikave antikorrupsion në kurrikulën arsimore, zhvillimit të aktiviteteve me nxënës dhe studentë, si dhe përmes komunikimit të vazhdueshëm institucional (e-buletini, rrjetet sociale, aktivitete publike). Përfshirja e të rinjve, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e një kulture integriteti dhe sjelljeje.


Çfarë përmban Raporti?

Raporti vjetor i monitorimit 2025 analizon progresin e 16 objektivëve specifikë, zbatimin e 47 masave dhe 138 aktiviteteve si dhe matjen e performancës përmes 24 treguesve të performancës.

Plani i Veprimit Antikorrupsion ka arritur një nivel zbatimi prej 83.5%, dhe i ndarë sipas qëllimeve të politikës, është:

Politikat Strategjike

Realizimi



Niveli i përgjithshëm i zbatimit

Nga monitorimi rezulton se janë:

- 24 masa dhe 91 aktivitete të realizuara;
- 16 masa dhe 20 aktivitete pjesërisht të realizuara (ende në proces zbatimi);
- 7 masa dhe 27 aktivitete të porealizuara.

Arritjet kryesore të vitit 2025:

1. Parandalimi i korrupsionit:

- U përparua me hartimin dhe miratimin e akteve të paketës ligjore “Antikorrupsioni” dhe u krijuan baza për një kuadër më të plotë dhe të harmonizuar me standardet e BE-së për të rregulluar veprimtari si lobimi, donacionet dhe sponsorizimet, konflikti i interesit në ushtrimin e detyrës.
- U miratua Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit dhe nisi shtrirja e saj në aktet metodologjike sektoriale dhe nga zbatimi i saj në sektorë prioritarë si prokurimi publik.
- U miratua Metodologjia e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në shërbimet e Kuvendit, dhe zbatimi në 8 akte ligjore në bashkëpunim me ekspertë të shoqërisë civile. Janë kryer vlerësime të hapësirave për korrupsion për rreth 1050 projektakteve (projektligje dhe vendim të Këshillit të Ministrave).
- U konsolidua rrjeti i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në nivel qendror dhe vendor dhe mekanizmat institucionalë të parandalimit të korrupsionit (koordinatorë antikorrupsioni, koordinatorë integriteti, koordinatorë të së drejtës së informimit).
- Platforma e-Albania arriti në 3,43 milionë përdorues aktive, qytetarë dhe biznese për 1,266 shërbime elektronike.

2. Ndëshkimi i korrupsionit:

- U forcua roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit me fokus verifikimin dhe hetimin administrativë me shtimin e kapaciteteve teknike dhe miratimin e akteve rregullatore. Janë trajtuar 439 raste verifikimi dhe hetimi administrativ, finalizuar 71 raporte përfundimtare, për të cilat janë propozuar 207 masa administrative dhe 234 rekomandime, si dhe depozituar 2 kallëzime penale.
- Prokuroria e Posaçme ka shtuar aksesin në databaza shtetërore, në 22 gjithsej duke përmirësuar eficiencën dhe cilësinë e hetimeve, veçanërisht për rastet komplekse financiare dhe pasurore. Janë zgjeruar mjetet analitike dhe hetimore, duke ndikuar në rritjen me 31%

të akteve të ekspertimit në laboratorët e BKH, ngritur seksioni i përgjimit parandalues në BKH dhe avancimin e strukturave të reja për vlerësimin e riskut dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

- Prokuroria e Posaçme ka regjistruar 294 procedime penale të reja, nga të cilat 109 të iniciuara kryesisht, duke reflektuar një rritje të qasjes proaktive në hetimin e korrupsionit. Pjesa tjetër e procedimeve penale për korrupsion ka ardhur nga referimet e policisë gjyqësore, institucionet dhe subjektet e tjera, me një rritje të ndjeshme të referimeve nga Policia e Shtetit (rreth 70%) dhe autoritetet publike (rreth 15%).
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka intensifikuar veprimtarinë hetimore në bashkëpunim me prokuroritë, referuar 336 çështje penale për 444 subjekte dhe duke zbatuar 133 masa sigurimi, përfshirë ndalime dhe arrestime në flagrancë, kryesisht ndaj punonjësve të strukturave policore.
- Është forcuar bashkëpunimi operacional ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar, përmes realizimit të 11 operacioneve të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë, nga të cilat 5 nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Interpol dhe Europol dhe 6 nga Prokuroria e Posaçme me autoritete të huaja.
- Është intensifikuar shkëmbimi i informacionit, me 36,632 komunikime ndërkombëtare përmes kanaleve Interpol, Europol dhe oficerëve të kontaktit, si dhe janë krijuar 6 Skuadra të Përbashkëta Hetimore, dhe 16 takime koordinuese.

3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi antikorrupsion:

- U forcua komunikimi publik dhe ndërgjegjësimi në luftën kundër korrupsionit, përmes zhvillimit të mjeteve të informimit dhe ndërveprimit me qytetarët, si dhe ngritjes dhe funksionalizimit të faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.
- U zhvillua edicioni i 7-të i “Javës së Integritetit”, si një platformë gjithëpërfshirëse ndërgjegjësimi dhe dialogu ndërinstytucional, me pjesëmarrje të institucioneve publike, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë
- U promovua përfshirja aktive e të rinjve përmes aktiviteteve edukative, debateve, forumeve dhe nismave ndërgjegjësuese, përfshirë organizimin e aktiviteteve në universitete në Durrës, Shkodër dhe Tiranë.
- U forcua integrimi i perspektivës gjinore në politikën dhe aktivitetet antikorrupsion, përmes përfshirjes së komponentit gjinor në 4 projektet konkrete të mbështetura nga AMSHC mbi çështje që lidhen me antikorrupsionin me fokus gjinor, si dhe organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe forumeve me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave, me synim rritjen e rolit të tyre në identifikimin dhe adresimin e korrupsionit.

Sfida dhe përfundime:

Gjatë vitit 2025, progresi i arritur ka evidentuar një konsolidim të qendrueshëm të mekanizmave të zbatimit të strategjisë, por njëkohësisht edhe disa sfida që kërkojnë adresim të vazhdueshëm. Ndër to përfshihen nevoja për përshpejtimin e miratimit të kuadrit ligjor, forcimin e kapaciteteve në nivel vendor, si dhe përmirësimin e mekanizmave të matjes së impaktit të masave antikorrupsion.

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024-2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024-2026

1.1 Hyrje

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 përfaqëson angazhimin më të lartë politik dhe institucional të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, si një nga sfidat më të ndjeshme për shoqërinë dhe zhvillimin demokratik të vendit. Ky dokument strategjik është hartuar në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës, transparencës, përgjegjshmërisë dhe integritetit, dhe synon krijimin e një mjedisi më me integritet dhe më efektiv në funksionimin e administratës publike dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Vizioni i strategjisë është: *“Institucione publike që ushtrojnë funksionet në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime efikente ndaj qytetarëve”*, dhe ai konkretizohet nëpërmjet tre qëllimeve kryesore: **parandalimit, ndëshkimit dhe ndërgjegjësimit.**

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024, përfaqëson vijimësinë dhe njëkohësisht qasje të qendrueshme e të drejtpërdrejtë të angazhimeve të Shtetit Shqiptar në drejtim të politikave antikorrupsion. E bazuar në një analizë të kujdesshme të progresit të arritur, në vlerësimin e sfidave të hasura dhe në domosdoshmërinë për të harmonizuar më tej politikatat qeveritare me prioritetet e procesit të integritetit evropian, strategjia e re është konsoliduar si një dokument gjithëpërfshirës, i mbështetur në evidenca, konsulta të gjera dhe standarde ndërkombëtare. Ajo përfaqëson një hap cilësor drejt rritjes së efektivitetit institucional, përmes një qasjeje kombëtare të koordinuar dhe mekanizmave të matshëm për monitorim dhe vlerësim.

Strategjia dhe Plani i Veprimit 2024 - 2026 janë hartuar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke reflektuar angazhimet e Shqipërisë si shtet palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, rekomandimet e GRECO-s në kuadër të Këshillit të Evropës, si dhe me PKIE-në & *acquis* të BE-së. Konkretisht, Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, një kapitull thelbësor në procesin e negociatave për anëtarësim. Strategjia përmban 16 objektiva specifike, të shoqëruar nga një plan veprimi me 53 masa të bazuara në rezultate dhe 24 tregues performance. Në veçanti, ajo mbështetet mbi parimet e transparencës, integritetit, llogaridhënies, mbrojtjes së sinjalizuesve, forcimit të mekanizmave antikorrupsion në sektorin publik dhe promovimit të edukimit dhe ndërgjegjësimit qytetar. Këto elementë përbëjnë boshtin tematik të strategjisë dhe janë në përputhje të plotë me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Procesi i zbatimit mbështetet gjithashtu nga partnerët ndërkombëtarë teknikë, të cilët kontribuojnë në forcimin e cilësisë së instrumenteve të politikave dhe në monitorimin e progresit të vendit.

Ky raport monitorimi pasqyron ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara *për periudhën janar - dhjetor 2025*, duke dhënë vlerësimin për vitin e dytë të zbatimit të strategjisë. Ai mbështetet në një proces të rregullt të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të administruara nga institucionet publike zbatuese në nivel qendror dhe vendor, si dhe nga aktorë të tjerë institucionalë. Vlerësimi

është kryer në përputhje me kuadrin e matjes së performancës dhe me metodologjinë e miratuar për monitorimin e strategjisë, duke u fokusuar në treguesit e performancës dhe vlerat e synuara për vitin në fjalë.

Zbatimi i strategjisë është mbështetur në një sistem të konsoliduar koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, i qendëruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, një strukturë teknike e dedikuar për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë.

Në raportin e monitorimit për vitin 2025 janë përfshirë zhvillimet e reja dhe të rëndësishme për të tre qëllimet e politikës së strategjisë, referuar iniciativave parandaluese me fokus mekanizmat rregullatore dhe instrumente zbatimi antikorrupsion, struktura institucionale dhe stafe teknike të angazhuar pranë autoriteteve publike, forcime dhe përmirësim kapacitetesh pranë organeve të drejtësisë dhe ato ligjzbatuese, konsolidimit të rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe edukimit qytetar përmes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes aktive dhe të ndërveprimit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit të nismave ligjore për kompozimin e paketës ligjore “antikorrupsion” mbështetur veçanërisht në aktet e reja ligjore të miratuara dhe ato në proces, strukturave dhe mekanizmave të integritetit (planet e integritetit, njësitë e sinjalizimit, kontrolli i deklaratave të pasurive, mekanizmat e transparencës dhe të informimit, bashkëpunimet me grupet e interesit (OSHC dhe sektori privat), strukturat e hetimit administrativ dhe ato të hetimit penal, pasuritë e sekuestruara pas hetimit dhe gjykimin të krimeve të korrupsionit, operacionet e përbashkëta hetimore ndërkombëtare, kapacitete tekniko-profesionale të autoriteteve ligjzbatuese si dhe komunikimi dhe edukimit kundër korrupsionit.

Në këtë kuadër, raporti i monitorimit për vitin 2025 përfaqëson një instrument kyç vlerësimi duke ofruar një panoramë të qartë mbi ecurinë dhe impaktin e masave të zbatuara dhe pritshmërinë e zbatimit të strategjisë përgjatë vitit të dytë të zbatimit të saj.

Procesi i monitorimit është udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe është zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, si struktura teknike përgjegjëse për përgatitjen e raportit të monitorimit. Përmes një rrjeti funksional të pikave të kontaktit antikorrupsion, kësaj here përfshirë edhe pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore (bashkitë) dhe prefekturat, monitorimi ka përfshirë dhe ka ofruar të dhëna për të gjitha hallkat e rëndësishme të administratës publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Ky raport paraqet gjithashtu një përmbledhje të progresit për secilin nga objektivat specifike, për çdo masë dhe aktivitet të planifikuar për zbatim, duke vlerësuar në mënyrë të qartë përmbushjen e tyre sipas treguesve përkatës të performances, të matur mbi baza gjashtëmujore. Në përfundim, raporti jep një analizë të arritjeve, sfidave të hasura dhe rekomandime të nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të strategjisë dhe të planit të veprimit për vitin në vijim.

Ky dokument është një instrument themelor për transparencën dhe llogaridhënien në procesin e zbatimit të politikave antikorrupsion dhe një dëshmi konkrete e vullnetit të institucioneve shqiptare për të ndërtuar një administratë publike më të drejtë, efikase dhe të besueshme për qytetarët e saj.

Për këtë *periudhë janar - dhjetor 2025*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 24¹ tregues performance, të shpërndarë përkatësisht në 15 tregues për objektivat specifike në qasjen parandaluese, 5 tregues për objektivat specifike në qasjen ndëshkuese dhe 4 tregues për objektivat specifike në qasjen ndërgjegjësuese.

Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektiveve të strategjisë sipas shkallës së realizimit të treguesve të performancës²:

Objektivët specifikë		Shkalla e realizimit sipas treguesve të performancës
Parandalimi	1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit	95%
	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	100%
	1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)	25%
	1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore	100%
	1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik	Nuk matet ³
	1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit	100%
	1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike	100%
	1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni	100%
	1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat	100%
Ndëshkimi	2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe i kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit	100%
	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit	54.3%
	2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit	65%
Ndërgjegjësi	3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin	100%

¹ Për dy tregues (1.5.1 dhe 1.5.2) ka rezultuar të jenë në pamundësi matjeje për këtë raport monitorimi.

² Mbështetur në matjen e vlerave të synuara për treguesit e performancës, sipas aneks 2 i SNKK.

³ Të dhënat për treguesin e performancës mund të merren, administrohen dhe vlerësohen në muajin Maj 2026, dhe do të bëhen pjesë e raportit të monitorimit të 6M1 2026.

3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit	50%
3.3 Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit	100%
3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm	100%

Për këtë periudhë janar - dhjetor 2025, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 47 masash dhe 138 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në: 27 masa dhe 86 aktivitete për qasjen parandaluese, 10 masa dhe 31 aktivitete për qasjen ndëshkuese dhe 10 masa dhe 21 aktivitete për qasjen ndërgjegjëse.

Në vijim, paraqitet realizueshmëria e planit të veprimit për secilin objektiv të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave⁴.

Objektivët specifikë	Shkalla e realizimit sipas masave të Planit të Veprimit
1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	51 në 85 për qind e masave të realizuara
1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)	31 në 50 për qind e masave të realizuara
1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore	51 në 85 për qind e masave të realizuara
1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik	0 në 30 për qind e masave të realizuara
1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit	31 në 50 për qind e masave të realizuara
1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike	86 në 110 për qind e masave të realizuara
1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni	86 në 110 për qind e masave të realizuara
1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat	31 në 50 për qind e masave të realizuara
2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të realizuara
2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimin ekonomik dhe pastrimit të parave	86 në 110 për qind e masave të realizuara

⁴ Mbështetur në metodologjinë e vlerësimit M&V, të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit, referuar në aneksin 1 e këtij raporti monitorimi.

3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin	86 në 110 për qind e masave të realizuara
3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit	86 në 110 për qind e masave të realizuara
3.3 Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit	51 në 85 për qind e masave të realizuara
3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm	51 në 85 për qind e masave të realizuara

Përsa më sipër, nga analiza e kryer rezulton se progresi i arritur për secilin prej qëllimeve të politikave⁵, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim, paraqitet:

Politika Parandaluese (I)	90 ⁶ %
Politika Ndëshkuese (II)	73.1 %
Politika Ndërgjegjësuere (III)	87.5 %

Për këtë periudhë janar - dhjetor 2025, janë shënuar arritje të mira në politikat parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuere të zbatimit të strategjisë, përmendim:

Parandalim:

- Gjatë vitit 2025, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi akte të paketës ligjore “Antikorrupsioni”, përfshirë ligjin “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve”, ligjin “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, si dhe akte të tjera të parashikuara në kuadër të Planit Analitik të Akteve. Këto zhvillime kontribuan drejtpërdrejt në përafrimin e kuadrit ligjor të vendit me *acquis* të BE dhe në forcimin e instrumenteve të integritetit dhe transparencës në administratën publike. Paralelisht, gjatë vitit 2025 janë përgatitur dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave projektligji “Për Lobimin në Republikën e Shqipërisë” si dhe kryer analiza të thelluara ligjore dhe vlerësime për nisma të tjera ligjore në proces, si kuadri për parandalimin e konfliktit të interesit, donacionet dhe sponsorizimet, dhe financimin e partive politike.
- Gjatë vitit 2025, është konsoliduar zbatimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në shërbimet e Kuvendit, e cila u përfshi në Rregulloren e Kuvendit. Procesi i vlerësimit është zgjeruar ndjeshëm, duke u aplikuar për një numër më të madh aktesh ligjore (8 akte ligjore), ndërkohë që në nivel të administratës qendrore janë kryer vlerësime të hapësirave për korrupsion për rreth 1050 projektakte, duke reflektuar një qasje më të sistematizuar të “*corruption proofing of legislation*”.

⁵ Mbështetur në metodologjinë e vlerësimit M&V, të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit.

⁶ Nuk është bërë pjesë e matjes objektivi 1.5. për arsye të pamundësisë së pasjes së të dhënave të treguesve të performancës së tij, deri para muajit maj 2026.

- Gjatë vitit 2025, është konsoliduar Rrjeti i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion dhe mekanizmat e integritetit në institucionet publike, ku në 367 autoritete janë caktuar koordinatorët për të drejtën e informimit, funksionojnë 185 njësi përgjegjëse për sinjalizimin në sektorin publik dhe 526 në sektorin privat, ndërsa 78 institucione kanë miratuar dhe publikuar planet e integritetit. Në funksion të forcimit të kapaciteteve, janë zhvilluar trajnime të dedikuara për koordinimin dhe zbatimin e masave antikorrupsion, përfshirë trajnime të realizuara nga ASPA për rrjetin e pikave të kontaktit antikorrupsion.
- Gjatë vitit 2025, në drejtim të rritjes së transparencës dhe aksesit në informacion është zgjeruar përdorimi i Regjistrit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve, me 25 AP të tjera, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 272.
- Gjatë vitit 2025, është vijuar zbatimi i qasjes së bazuar në risk përmes miratimit dhe aplikimit të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik, si dhe zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e saj në nivel qendror dhe vendor. Paralelisht, janë ndërmarrë procese konkrete të vlerësimit të riskut të integritetit në institucione kyçe, si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, dhe miratuar Planin e Integritetit, 2025-2027.
- Gjatë vitit 2025, është vijuar integrimi i tematikave të integritetit dhe sjelljes qytetare në kurrikulën e arsimit parauniversitar, përmes rishikimit të programit të lëndës “Qytetaria” për klasat e 1, 6 dhe 10, duke kontribuar në ndërtimin afatgjatë të kulturës së integritetit në shoqëri. Kurrikula pritet të nisë zbatimin (mësimdhënia në shkolla) në vitin akademik 2026-2027.
- Gjatë vitit 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar një rol aktiv në identifikimin dhe adresimin e risqeve të korrupsionit përmes veprimtarisë audituese, duke realizuar gjithsej 55 misione auditimi në fusha të ndryshme institucionale. Nga këto auditime janë dhënë 1034 rekomandime, prej të cilave 919 janë pranuar, duke reflektuar një nivel të lartë reagimi institucional dhe ndjekjeje të gjetjeve audituese.

Ndëshkim:

- Gjatë vitit 2025, DPAK ka trajtuar 439 raste verifikimi dhe hetimi administrativ, duke finalizuar 71 raporte përfundimtare, në të cilat janë propozuar 207 masa administrative dhe 234 rekomandime, si dhe duke depozituar 2 kallëzime penale. Këto rezultate reflektojnë forcimin e kapaciteteve hetimore dhe një qasje të konsoliduar në adresimin e shkeljeve administrative dhe penale në sektorin publik. DPAK ka një rregullore të re për organizimi dhe funksionimin e saj.
- Gjatë vitit 2025, janë forcuar ndjeshëm kapacitetet institucionale për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, përmes konsolidimit të strukturave të specializuara në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe të rritjes së ekspertizës profesionale në Prokurorinë e Posaçme.
- Gjatë vitit 2025, janë zgjeruar mjetet analitike dhe hetimore, përfshirë rritjen me 31% të akteve të ekspertimit në laboratorët e BKH dhe zgjerimin e aksesit të SPAK në 22 baza të dhënash shtetërore, duke përmirësuar eficiencën dhe cilësinë e hetimeve, veçanërisht për

rastet komplekse financiare dhe pasurore. Paralelisht, janë ndërmarrë masa për zhvillimin e mëtejshëm institucional, përfshirë ngritjen e seksionit të përgjimit parandalues në BKH dhe avancimin e strukturave të reja për vlerësimin e riskut dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

- Gjatë vitit 2025, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar 294 procedime penale të reja, nga të cilat 109 të iniciuara kryesisht, duke reflektuar një rritje të qasjes proaktive në hetimin e korrupsionit. Pjesa tjetër e procedimeve penale për korrupsion ka ardhur nga referimet e policisë gjyqësore, institucionet dhe subjektet e tjera, me një rritje të ndjeshme të referimeve nga Policia e Shtetit (rreth 70%) dhe autoritetet publike (rreth 15%), duke treguar forcim të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të mekanizmave të raportimit.
- Gjatë vitit 2025, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka intensifikuar veprimtarinë hetimore në bashkëpunim me prokuroritë, duke referuar 336 çështje penale për 444 subjekte dhe duke zbatuar 133 masa sigurimi, përfshirë ndalime dhe arrestime në flagrancë, kryesisht ndaj punonjësve të strukturave policore. Analiza e rasteve tregon se shpërdorimi i detyrës dhe korrupsioni pasiv mbeten format më të përhapura të paligjshmërisë (rreth 30%), ndërsa veprimtaria e AMP reflekton një qasje aktive dhe proaktive në ndjekjen dhe goditjen e shkeljeve ligjore në radhët e policisë.
- Gjatë vitit 2025, është forcuar bashkëpunimi operacional ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përmes realizimit të 11 operacioneve të përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë, nga të cilat 5 nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Interpol dhe Europol dhe 6 nga Prokuroria e Posaçme me autoritete të huaja. Paralelisht, është intensifikuar shkëmbimi i informacionit, me një total prej 36,632 komunikimesh ndërkombëtare përmes kanaleve Interpol, Europol dhe oficerëve të kontaktit, si dhe janë krijuar 6 Skuadra të Përbashkëta Hetimore, të shoqëruara me 16 takime koordinuese. Këto zhvillime kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të hetimeve ndërkufitare dhe adresimin e formave të avancuara të kriminalitetit.
- Gjatë vitit 2025, janë konsoliduar më tej mekanizmat e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes nënshkrimit të 25 akteve ndërkombëtare nga Policia e Shtetit, si dhe një sërë memorandumesh bashkëpunimi nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi është zgjeruar edhe në aspektin e ndihmës juridike ndërkombëtare, ku janë trajtuar 86 kërkesa hyrëse dhe janë dërguar 151 kërkesa drejt autoriteteve të huaja, si dhe janë transmetuar 43 kërkesa për ekstradim.

Ndërgjegjësim:

- Gjatë vitit 2025, është forcuar ndjeshëm komunikimi publik dhe ndërgjegjësimi në luftën kundër korrupsionit, përmes zhvillimit dhe diversifikimit të mjeteve të informimit dhe ndërveprimit me qytetarët. Është ngritur dhe bërë funksionale faqja zyrtare e internetit e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, e cila ofron informacion të detajuar mbi aktivitetin institucional, dokumentet strategjike, si dhe mekanizmat për raportimin e

rasteve të korrupsionit. Paralelisht, është hartuar dhe zbatuar Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit 2025, i cili përfshin 8 aktivitete ndërgjegjësuere të shpërndara gjatë gjithë vitit, me fokus rritjen e informimit publik dhe edukimin qytetar mbi pasojat e korrupsionit dhe mënyrat e raportimit të tij.

- Gjatë vitit 2025, është zhvilluar edicioni i 7-të i “Javës së Integritetit”, një platformë gjithëpërfshirëse ndërgjegjësimi dhe dialogu ndërinstytucional, që përfshiu aktivitete edukative, debate me të rinjtë, ekspozita dhe konferenca me pjesëmarrje të institucioneve publike, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë. Aktivitetet u fokusuan në promovimin e kulturës së integritetit, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe në përfshirjen aktive të të rinjve përmes nismave si “Zëri i të Rinjve për Integritet” dhe aktiviteteve artistike.
- Gjatë vitit 2025, në drejtim të përfshirjes së të rinjve në arsimin e lartë, janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe universitete, përfshirë tre sesione të hapura në universitete në Durrës, Shkodër dhe Tiranë, si dhe forume dhe leksione me studentë të shkencave juridike dhe politike.

1.2 Metodologjia e monitorimit

Raporti i monitorimit për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, dhe të Planit të Veprimit, për vitin 2025, është përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për ndjekjen dhe koordinimin ndërinstytucional të politikave në këtë fushë. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr.436, datë 26.6.2024, dhe urdhrit të Kryeministrit Nr.146, datë 1.8.2024, është strukturuar Sektori i Monitorimit dhe Koordinimit të Politikave Prioritare, i cili ka ndjekur të gjithë ciklin teknik dhe instytucional të hartimit të raportit *për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025*.

Procesi është zhvilluar në përputhje me manualin e raportimit në sistemin IPSIS, duke garantuar koherencë me strukturën logjike të strategjisë, përfshirë vlerësim për qëllimet e politikës, objektivet specifike, masat konkrete dhe treguesit e performancës për secilin insttucion përgjegjës. Raporti ndërtohet mbi bazën e një metodologjie të qartë për mbledhjen, analizimin dhe klasifikimin e të dhënave sipas tri shtyllave kryesore: (1) realizimi i masave të planit të veprimit, (2) arritja e vlerave të synuara për treguesit e performancës dhe (3) përputhshmëria me parimet e mirëqeverisjes dhe efektiviteti i burimeve.

Në përputhje me qasjen e re të integruar ndërsektoriale, monitorimi është ndërlidhur me Mekanizmin e Integruar të Politikave, përmes funksionimit të Ekipit Tematik Antikorrupsion dhe dialogut të rregullt me aktorët publikë, partnerët për zhvillim dhe shoqërinë civile.

Analiza është shtrirë edhe në komponentët financiarë, duke evidentuar lidhjen midis programeve buxhetore dhe realizimit të masave të strategjisë dhe ka përfshirë vlerësime të riskut sipas standardeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Raporti është ndërtuar mbi baza analitike dhe me të dhëna të krahasueshme përmes grafikëve, tabelave, treguesve SMART dhe kategorizimeve të performancës në pesë shkallë (i dobët, i mjaftueshëm, i mirë, shumë i mirë, i tejkaluar).

Ky dokument do të shërbejë jo vetëm për të matur progresin vjetor, por edhe për të udhëhequr vendimmarrjen, planifikimin buxhetor dhe përmirësimin e mëtejshëm të politikave antikorrupsion, në funksion të rritjes së integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike dhe në shërbim të qytetarëve. Gjenerali të detajuar metodologjinë e monitorimit të ndjekur, në aneks 1 të këtij raporti monitorimi.

1.3 Konsultimi publik i raportit të monitorimit

Në përputhje me kriteret për konsultimin publik, në kuadër të hartimit të raportit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, konsultoi të dhënat e para për përgatitjen e draftit të parë të raportit në periudhën e 29 janar-4 shkurt 2026. Drafti i parë i raportit të monitorimit u nda për mendim dhe plotësim me institucionet zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 nëpërmjet pikave të kontaktit antikorrupsion, në datat e 11-27 shkurt 2026. Në vijim, me marrjen e informacionit të shtuar për masat dhe aktivitetet e planit të veprimit, vlerat e synuara vjetore për treguesit e performancës, u plotësua informacioni statistikor dhe ri-vlerësimi i progresit të arritur.

Drafti i dytë i raportit u dërgua për vlerësim dhe konsultim pranë institucioneve të zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 në datë 24 mars 2026, si dhe pranë SASPAC, që shërben si njësi përgjegjëse për koordinimin qendror të Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave.

Në datë 26 mars 2026 u zhvillua takimi i Ekipit Tematik Teknik Antikorrupsioni, me pjesëmarrjen e pikave të kontaktit antikorrupsion pranë institucioneve zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, në të cilin u prezantua raporti, u diskutua dhe dakordësua përmbajtja e tij.

Në datë 1 prill 2026, ky raport u paraqit zyrtarisht pranë Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit që drejton njëkohësisht edhe Ekipin Tematik Antikorrupsion.

Në vijim, Ekipi Tematik Antikorrupsion mori në diskutim raportin e përgatitur dhe e miratoi atë në takimin e datës 16 prill 2026.

II. PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT, 2024-2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT, 2024-2026

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfutur rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2024 - 2030, është hartuar raporti i monitorimit, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2024 - 2026, i cili mbulon *periudhën 1 janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025*.

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

Zbatimi i SNKK kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qendrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritetit evropian.

SNKK ka identifikuar tre qëllime kryesore politikash përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 16 objektiva specifike, si më poshtë:

Politika Parandaluese ka për qëllim forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike dhe të gjithë segmenteve shtetërore. Fokus i veçantë i dedikohet institucioneve që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Kjo politikë përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- 1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.
- 1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.
- 1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni).
- 1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- 1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.
- 1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.
- 1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.
- 1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni.
- 1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat.

Politika Ndëshkuese ka për qëllim të forcojë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, të ndëshkojë aktet korruptive në të cilat zyrtarët publikë mund të përfshihen dhe të garantojë integritetin e organeve shtetërore.

Kjo politikë përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- 2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit.
- 2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.
- 2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.

Politika Ndërgjegjësuere ka për qëllim përfshirjen e publikut në luftën kundër korrupsionit, duke e informuar mbi veprimtarinë shtetërore kundër korrupsionit dhe nxitur atë për të përdorur në mënyra aktive mënyra dhe kanalet për ta denoncuar atë.

Kjo politikë përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- 3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.
- 3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.

3.3 Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit.

3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.

Realizueshmëria e objektivave specifike të të tre qëllimeve të politikave të SNKK në nivel objektiv, paraqitet si vijon:

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave, duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të qëllimeve të politikës dhe pjestuar me numrin e tyre, realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstitucional kundër korrupsionit, për vitin 2025 është **83.5%**.

Politika I	Realizueshmëria
1.1	95%
1.2	100%
1.3	25%
1.4	100%
1.5	Nuk matet ⁷
1.6	100%
1.7	100%
1.8	100%
1.9	100%

Politika II	Realizueshmëria
2.1	100%
2.2	54.3%
2.3	65%

Politika III	Realizueshmëria
3.1	100%
3.2	50%
3.3	100%
3.4	100%

Numri i institucioneve të përfshira në zbatimin të Planit të Veprimit, 2024-2026, *periudhën e zbatimit janar-dhjetor 2025*, është 112, si përkatësisht: të gjitha Ministrinë e Linjës dhe ministrat e shtetit; institucionet në nivel qendror me kompetenca administrative si: ADB, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Policia e Shtetit, Agjencia e Mbikqyrjes Policore dhe, institucionet e pavarura: Kuvendi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Posaçme, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Akademia e Sigurisë, ATRAKO, Agjencia e Inteligjencës Financiare. Të gjitha bashkitë (61) dhe qarqet (12).

Zbatimi i SNKK realizohet përmes Planit të Veprimit 2024 - 2026, dhe për periudhën raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2025, konsiston në 47 masash dhe 138 aktivitete, të ndara përkatësisht në: 27

⁷ Nuk matet (*ibid* footnote 1).

masa dhe 86 aktivitete për qasjen parandaluese, 10 masa dhe 31 aktivitete për qasjen ndëshkuese, dhe 10 masa dhe 21 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuese.

Statusi i realizueshmërisë së tyre paraqitet si vijon:


Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2025			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ⁸	Masa dhe aktivitete të parealizuara ⁹
Parandaluese (I)	Masa	27	11	11	5
	Aktivitete	86	53	15	18
Ndëshkuese (II)	Masa	10	7	3	0
	Aktivitete	31	25	2	4
Ndërgjegjësuese (III)	Masa	10	6	2	2
	Aktivitete	21	13	3	5
Total	Masa	47	24	16	7
	Aktivitete	138	91	20	27

Rezulton se nga totali prej 47 masash dhe 138 aktiviteteve të parashikuara për zbatim në planin e veprimtimit për periudhën *janar - dhjetor 2025*, statusi i tyre për të tre qëllimet e politikave rezulton të jetë si më poshtë:

- 24 masa dhe 91 aktivitete të realizuara;
- 16 masa dhe 20 aktivitete pjesërisht të realizuara (ende në proces zbatimi);
- 7 masa dhe 27 aktivitete të porealizuara.

⁸ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁹ Aktivitet "i porealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.



Përsa më sipër, nga **24 masa dhe 91 aktivitete të realizuara**, për *janar-dhjetor 2025*, konkretisht 11 masa dhe 53 aktivitete i përkasin politikës parandaluese (I), 7 masa dhe 25 aktivitete i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 6 masa dhe 13 aktivitete i përkasin politikës ndërgjegjësuere (III).

Nga **16 masa dhe 20 aktivitete pjesërisht të realizuara**, për *janar- dhjetor 2025*, konkretisht 11 masa dhe 15 aktivitete i përkasin politikës parandaluese (I), 3 masa dhe 2 aktivitetet i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 2 masa dhe 3 aktivitete i përkasin politikës ndërgjegjësuere (III).

Nga **7 masa dhe 27 aktivitete të porealizuara**, për *janar- dhjetor 2025*, konkretisht 5 masa dhe 18 aktivitete i përkasin politikës parandaluese (I), vetëm 7 aktivitete i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 2 masa dhe 5 aktivitete i përkasin politikës ndërgjegjësuere (III).

Për *këtë periudhë janar- dhjetor 2025*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 24 tregues performance, të shpërndarë përkatësisht në 15 tregues për objektivat specifike në politikën parandaluese, 5 tregues për objektivat specifike në politikën ndëshkuese dhe 4 tregues për objektivat specifike në politikën ndërgjegjësuere. Gjatë vitit 2025¹⁰, janë arritur vlerat e synuara për 16 tregues performance, pjesërisht për 4 tregues performance dhe nuk janë arritur për 2 tregues performance.

Statusi i arritjes së vlerave të synuara të tyre paraqitet si vijon:


Qëllimet e Politikës		Realizimi i Treguesve të Performancës
----------------------	--	--

¹⁰ Janë marrë në konsideratë vlerat e synuara për periudhën e monitorimit, sipas pasaportës së treguesve, aneks 2 i SNKK.

	Treguesit e performancës	Vlera e synuar është arritur plotësisht ¹¹	Vlera e synuar është arritur pjesërisht ¹²	Vlera e synuar nuk është arritur ¹³
Parandaluese (I)	15 ¹⁴	11	1	1
Ndëshkuese (II)	5	2	2	1
Ndërgjegjësuere (III)	4	3	1	0
Total	24¹⁵	16	4	2

Rezultoni se nga totali prej 24¹⁶ tregues performance, me vlera të synuara vjetore për arritje, për periudhën *janar - dhjetor 2025*, statusi i tyre për të tre qëllimet e politikave, rezultoni të jetë si më poshtë:

- 16 tregues performance të realizuar;
- 4 tregues performance pjesërisht i realizuar;
- 2 tregues performance i përealizuar.



Përsa më sipër, për **16 tregues performance me vlera të synuara të realizuara**, për vitin 2025, konkretisht 11 i përkasin politikës parandaluese (I), 2 i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 3 i përkasin politikës ndërgjegjësuere (III).

¹¹ Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

¹² Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹³ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna.

¹⁴ Nuk janë matur treguesit 1.5.1 dhe 1.5.2 për pamundësi objektive.

¹⁵ Ibid footnote 13.

¹⁶ Janë përjashtuar nga matja treguesit 1.5.1 dhe 1.5.2.

Për 4 tregues performance me vlera të synuara të realizuara pjesërisht, për vitin 2025, konkretisht 1 i përkasin politikës parandaluese (I), 2 i përkasin politikës ndëshkuese (II), si dhe 1 i përkasin politikës ndërgjegjësuese (III).

Për 2 tregues performance me vlera të synuara të parealizuara, për vitin 2025, konkretisht 1 i përkasin politikës parandaluese (I) dhe 1 i përket politikës ndëshkuese (II).

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritetit evropian

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 dhe konkretisht i Planit të Veprimit gjatë periudhës janar - dhjetor 2025 ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian, me fokus të veçantë në forcimin e shtetit të së drejtës dhe përmbushjen e kritereve të kapitujve 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria).

Masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë kanë mbështetur rekomandimet e përsëritura të Komisionit Evropian dhe të aktorëve të tjerë ndërkombëtarë në lidhje me nevojën për të përmirësuar dhe përditësuar me mekanizma të reja kuadrin ligjor, integritetin institucional, për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë në administratën publike, si dhe për të luftuar korrupsionin në mënyrë efektive në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Gjatë vitit 2025, përmendet ecuria e kënaqshme dhe në kohë sipas afateve e hartimit të kuadrit ligjor të brendshëm dhe miratime të tij nga Kuvendi dhe progresi me miratimet në Këshillin e Ministrave; vendosja e *baseline-s* për ngritjen e mekanizmave për vlerësimin e riskut të korrupsionit kryesisht për sektorët vulnerabël, forcimi dhe konfirmimi i instrumenteve të integritetit në sektorë prioritarë si kadastra, rritja e kapaciteteve të koordinimit ndër-institucional dhe fuqizimi i rolit të koordinatorëve antikorrupsion në institucionet publike nëpërmjet forcimit të kapaciteteve organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, të dhëna të hetimit dhe ndjekjes penale kundër korrupsionit përbëjnë rezultate konkrete por që duhen thelluar dhe që angazhimi ndaj tyre premtion arritje të prioriteteve të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit. Këto ndërhyrje lidhen ngushtë me përmbushjen e standardeve të kërkuara për ecurinë e kapitujve negociues (Kapitulli 23 dhe 24) kryesisht, dhe me progresin e kërkuar nëpërmjet rekomandimeve të dhëna në raportet e progresit të Komisionit Evropian.

Për më tepër, vijueshmëria e harmonizimit të masave të parashikuara në strategji me mekanizmat e parandalimit të korrupsionit të përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, si dhe në Direktivën e BE-së për sinjalizuesit, dëshmon për orientimin e strategjisë drejt përafrimit me *acquis* në fushën e sundimit të ligjit, antikorrupsionit dhe të qeverisjes së mirë.

Nga zbatimi dhe monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2026, për vitin 2025, ka rezultuar se kanë vijuar zbatimi i masave dhe nismave të planifikuara për zbatim në disa fusha të cilat prekin politikën parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese antikorrupsion.

Në fushën e parandalimit, një ndër arritjet më të rëndësishme të vitit 2025, është konsoliduar qasja parandaluese në përputhje me standardet e BE-së për integritetin në administratën publike.

Është avancuar kuadri ligjor për sinjalizimin, lobimin, si dhe përgatitja për rregullimin e donacioneve dhe sponsorizimeve, ndërkohë që janë forcuar instrumentet e analizës parandaluese përmes vlerësimit të kuadrit institucional dhe aplikimit të qasjes së Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion (*Corruption Proofing of Legislation*). Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit shënon një hap të rëndësishëm drejt një qasjeje të strukturuar dhe proaktive në menaxhimin e riskut të integritetit, duke kontribuar në përafrimin me *acquis* dhe praktikatat më të mira të BE-së.

Në fushën e ndëshkimit, një ndër arritjet më të rëndësishme të vitit 2025, janë konsoliduar më tej përpjekjet për forcimin e koordinimit ndërinstucional ndërmjet strukturave hetimore dhe organeve administrative, duke përmirësuar mekanizmat e referimit dhe ndjekjes së rasteve të dyshuara të korrupsionit. Është shënuar progres në rritjen e kapaciteteve teknike dhe ekspertizës profesionale të organeve ligjzbatuese dhe institucioneve të drejtësisë, si dhe në rolin koordinues të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në ndjekjen e rekomandimeve dhe masave. Kjo qasje e integruar ndërmjet mekanizmave parandaluese dhe ndëshkuese kontribuon në rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale dhe është në përputhje me kërkesat e BE-së për forcimin e zbatimit të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit dhe të ndjekjes penale.

Në fushën e ndërgjegjësimit, gjatë vitit 2025, është konsoliduar qasja e komunikimit publik përmes formateve ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, me fokus në edukimin qytetar dhe rritjen e transparencës institucionale. Iniciativa si vijueshmëria e publikimit të rregullt të e-buletinit “Antikorrupsioni”, zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse në universitete dhe integrimi i tematikave antikorrupsion në kurrikulën parauniversitare kontribuojnë në ndërtimin e një kulture të qendrueshme integriteti dhe në rritjen e ndërgjegjësimit publik. Këto masa janë në përputhje me qasjen e BE-së për promovimin e integritetit dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në parandalimin e korrupsionit.

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Gjatë vitit 2025, që i korrespondon vitit të dytë të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, janë evidentuar disa aspekte që kërkojnë përmirësim për të rritur efektivitetin dhe koherencën e zbatimit të saj dhe për këtë mbeten ende disa komponentë që kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme për të garantuar një zbatim më efektiv dhe të balancuar të objektivave strategjikë.

Së pari, duhet të bëhet progres dhe miratohen në afate projektligji “Për Lobimin”; hartimi dhe konsolidimi i projektligjit “Për Donacionet dhe Sponsorizimet”, dhe ecuria e procesit për projektligjin “Për Partitë Politike”. Këto akte njihen si pjesë e paketës së ligjeve “Antikorrupsioni”.

Së dyti, duhet të bëhet progres me zbatimin nëpërmjet hartimit dhe vënies në zbatim të metodologjive sektoriale të vlerësimit të riskut të korrupsionit në të gjithë sektorët vulnerabël të përmendur në objektivin 1.3.

Së treti, përfshirja e sektorit privat dhe shoqërisë civile në zbatimin dhe monitorimin e strategjisë kërkon një rritje të mëtejshme, përmes krijimit të mekanizmave të qendrueshëm të bashkëpunimit dhe transparencës.

Së fundi, përmirësim i thelluar i ndërgjegjësimit publik për raportimin e korrupsionit nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit, takime, forume, aktivitete publike.

Përmirësimi i këtyre komponentëve do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe impaktit real të strategjisë përgjatë viteve të zbatimit të saj.

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Financimi i Planit të Veprimit mbështetet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe asistenca financiare e partnerëve ndërkombëtarë (donatorëve).

Në kuadër të procesit të monitorimit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit për këtë periudhë zbatimi, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e planifikuar për vitin përkatës, si dhe mbi fondet e përdorura për realizimin e objektivave specifike të strategjisë, sipas masave e aktiviteteve të zhvilluara.

Nga monitorim vihet re se plani veprimit për zbatim në vitin 2025, fondet e përdorura raportohen në kryesisht mënyrë të përgjithshme “kosto administrative” dhe pjesë e PBA të institucioneve zbatuese të SNKK dhe PV, siç përmenden ato nga KLSH, SHM dhe ILDKPKI.

III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVËT SPECIFIKË, TREGUESIT E PERFORMANCËS DHE MASAT

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së tre politikave të SNKK, në drejtim të secilit qëllim politik¹⁷, objektivit dhe masave (dhe aktiviteteve) të Planit të Veprimit 2024-2026, për periudhën e monitorimit *1 janar – 31 dhjetor 2025*.

Qëllimet e politikave dhe objektivat specifike bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve në funksion të zbatimit të masave, të parashikuara për zbatim nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të strategjisë dhe Planit të Veprimit.

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës

Në përputhje me SNKK, janë kryer aktivitete dhe realizuar dhe masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 – 2026 për periudhën raportuese të lidhura me të tre qëllimet e politikës, përkatësisht parandalimin (I), ndëshkimin (II) dhe, ndërgjegjësimin (III).

Politika Parandaluese (I) - Përmbledhje për arritjet në parandalimin e korrupsionit


Përmes **qëllimit të politikës parandaluese**, SNKK synon parandalimin dhe çrënjosjen e korrupsionit në administratën publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore dhe me fokus të dedikuar nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët. Kjo qasje përmban numrin më të madh të objektivave specifike dhe për rrjedhojë dhe të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar nga institucionet e përfshira në këtë dokument strategjik të luftës kundër korrupsionit.

¹⁷Aneksi nr. 1, Plani i Veprimit, i Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024, Fletore Zyrtare 255, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/12/26/859>.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet (veprimet) sipas tabelës më poshtë.

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara ¹⁸	Masa dhe aktivitete të porealizuara ¹⁹
Parandaluese (I)	Masa	27	11	11	5
	Aktivitete	86	53	15	18

Rezulton se nga 27 masa dhe 86 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 - 2026, për vitin 2025, për Politikën Parandaluese (I) janë zbatuar plotësisht 11 masa dhe 53 aktivitete, pjesërisht 11 masa dhe 15 aktivitete si dhe pazbatuar 5 masa dhe 18 aktivitete (masa: 1.3.5, 1.5.1, 1.5.3, 1.6.3, 1.6.4, dhe aktivitetet: 1.1.4.2, 1.2.5.1, 1.3.2.3, 1.3.2.5, 1.3.4.1, 1.3.5.3, 1.4.3.1, 1.4.3.3, 1.5.1.1, 1.5.1.2, 1.5.3.1, 1.5.3.2, 1.5.3.3, 1.6.3.1, 1.6.3.2, 1.6.3.3, 1.6.4.1 dhe 1.9.1.4).




¹⁸ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹⁹ Aktivitet "i porealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.

Nga 15²⁰ treguesit e performancës për Politikën Parandaluese (I), është arritur vlera e synuar për 11 tregues performance, për 1 është realizuar vetëm pjesërisht dhe për 1 tjetër (treguesi 1.3.2) nuk është arritur.

Parandaluese (I)	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ²¹	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ²²	Vlera e synuar nuk është e realizuar ²³
	15 ²⁴	11	1	1



1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

²⁰ Dy prej tyre (1.5.1 dhe 1.5.2) nuk do të mund të maten pasi të dhënat e tyre për vitin e plotë 2025, mund të raportohen nga institucionet përgjegjëse, MF dhe KLSH vetëm në muajin maj 2026, pasi të administrohen prej tyre. Të dhënat për këta tregues performance do të adresohen në raportin e ardhshëm të monitorimit të SNKK, për 6M1 2026.

²¹ Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

²² Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

²³ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna.

²⁴ *Ibid* footnote 17 (treguesit 1.5.1 dhe 1.5.2).

1.1.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore (akte te brendshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare) të miratuara nga ato të planifikuara për t'u miratuar.

1.1.2: Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë ngritur dhe vënë në funksion strukturat antikorrupsion.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 16 aktivitete dhe 4 masa.

1.1.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore (akte te brendshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare) të miratuara nga ato të planifikuara për t'u miratuar.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.1.1 për vitin 2025 është: Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar përkatësisht aktivitetet (5) dhe masat (2), si më poshtë.

1.1.1	Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin e korrupsionit
1.1.1.2	Miratimi i ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore (të parashikuara) për parandalimin e korrupsionit, duke përmendur: - Ligji për Zyrën e Rekuperimit të Aseteve - Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve - Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, si dhe çdo akt tjetër (ligjor dhe nënligjor) lidhur me fushën antikorrupsion.
1.1.1.3	Kryerja e një analize dhe hartimi i draftit fillestar mbështetur mbi modelet e vendeve të BE të legjislacionit për transparencën e financimit të partive politike, si dhe paraqitja e propozimeve komisioneve të Kuvendit
1.1.2	Përmirësimi i procedurave administrative në përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit të parandalimit të korrupsionit
1.1.2.1	Metodologji (Manual) për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në ligje (<i>Corruption Proofing of Legislation</i>), për shërbimet e Kuvendit (miratimi i Manualit)
1.1.2.2	Kryerje e vlerësimit sipas Metodologjisë së hartuar në aktivitetin 1.1.2.1, të ligjeve dhe opinione /analiza të hartuara
1.1.2.3	Kryerje e procesit të Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion gjatë hartimit të akteve nga strukturat e përfshira në proces (në zbatim të Manualit të Hartimit të Legjislacionit)
1.1.2.4	Forcimi i kapaciteteve të stafeve teknike të drejtorive juridike dhe të politikave pranë ministrive dhe të shërbimeve të Kuvendit, për procesin e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të akteve të miratuara dhe për të cilat është kryer vlerësimi i kërkuar, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, ka pasur progres konkret në drejtim të miratimit të akteve ligjore në fushën antikorrupsion. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve” në seancën plenare të 26 qershor 2025. Ligji nr.44/2025²⁵ “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” përmbush një detyrim të Shqipërisë dhe do të lehtësojë procesin e gjurmimit e të identifikimit, dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, në kuadër të rikuperimit të asetëve. Ligji përcakton rregullat për krijimin, organizimin, funksionimin, përcaktimin e përgjegjësive dhe të procedurave të bashkëpunimit të ZRA-së. Në vijim në kuadër të zbatimit të këtij ligji, Ministri i Punëve të Brendshme ka miratuar udhëzimin nr. 203, datë 27.11.2025, për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të Zyrës së Rikuperimit të Asetëve. Miratimi i këtij udhëzimi kontribuon në standardizimin dhe transparencën e procedurave për përzgjedhjen e drejtuesit të Zyrës së Rikuperimit të Asetëve, duke forcuar parimet e meritokracisë dhe integritetit në emërimet.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 96/2025 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” në seancën plenare të datës 18 dhjetor 2025. Ligji përafuron kuadrin e brendshëm ligjor të vendit me Direktivën nr. 2019/1937/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 13 tetor 2019 “Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit”. Numri CELEX 32019L1937, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 305, dt. 26.11. 2019, faqe 17–56. Ky ligj vendos një kuadër të plotë dhe të unifikuar për raportimin e shkeljeve dhe rasteve të dyshuara për korrupsion, në sektorin publik dhe atë privat, duke garantuar mbrojtje efektive për sinjalizuesit, ruajtjen e konfidencialitetit dhe funksionimin e qartë të kanaleve të brendshme dhe të jashtme të raportimit. Qasja e re ligjore synon të forcojë besimin e individëve për të raportuar në mirëbesim dhe të rrisë ndjeshëm kapacitetin institucional për identifikimin dhe adresimin e shkeljeve. Aktet nënligjore në zbatim të ligjit janë në proces hartimi dhe miratimi dhe do të përfundojnë brenda 6 muajve të parë nga hyrja në fuqi e ligjit.

Projektligji “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” prej tetorit 2025 ka nisur procedurat parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë. Komisioni i Posaçëm Parlamentar, “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, konsolidoi draftin dhe propozoi Kuvendit shqyrtimin e tij dhe miratimin. Për aktin janë zhvilluar tryeza të konsultimit publik²⁶ dhe dhënë mendime nga Këshilli i Ministrave. Deri në fund të dhjetor 2025, projektligji iu nënshtua shqyrtimit në të gjitha komisionet parlamentare dhe u kalua për miratim në muajin janar 2026 me fillimin e sesionit të ri parlamentar²⁷.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka përfunduar së kryeri një analizë dhe hartimin e draftit fillestar të ligjit për financimin e partive politike, mbështetur mbi modelet e vendeve të BE të legjislacionit për transparencën e financimit të partive politike, është hartuar dokumenti analizë, i përmendur, përfshirë gjithashtu në programin e dokumentit analitik të Komisionit të Posaçëm

²⁵ <https://parlament.al/dokumentacioni/aktet/82512743-08b7-4891-99d1-5837e8cdd38a> dhe <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202507031335093415ligji%20nr.%2044%2C%20dt.%2026.6..2025.pdf>.

²⁶ <https://www.parlament.al/lajme/ee7167e1-8e42-4701-89c5-71bd5aec4533> dhe <https://masl.al/ligji-te-ri-per-parandalimin-e-konfliktit-te-interesave-ekspertet-mblidhen-ne-kuvend-per-tryezen-e-pare-te-konsultimit-publik/>.

²⁷ Ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” në seancën plenare të datës 3 shkurt 2026.

Parlamentar²⁸. Analiza është fokusuar në praktikat e deklarimit të burimeve të financimit, kufizimet mbi donacionet, mekanizmat e raportimit dhe rolin e institucioneve mbikëqyrëse dhe audituese. Ky dokument është ndarë me ekspertë të nivelit të lartë të atashuar pranë këtij Komisioni, dhe me përfaqësues të institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe partnerëve ndërkombëtarë, dhe filluar punën përgatitore për hartimin e një drafti ligjor “Për financimin e partive politike”. Dokumenti raport u shpërnda dhe për të u organizua i pari takim konsultimi publik²⁹, gjithashtu.

Në vitin 2025, është miratuar dokumenti Metodologji për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në Ligje (CPL). Me vendim të Konferencës së Kryetarëve, nr.1, datë 20.1.2025, është miratuar “Metodologjia për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në ligje” për shërbimet e Kuvendit³⁰. Metodologjia është bërë pjesë e përmbajtjes së Rregullores së Kuvendit, me vendimin nr. 6, datë 30.1.2025, dhe miratuar disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ku është reflektuar dhe zbatimi i Metodologjisë për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në Ligje. Referuar kryerjes së këtij vlerësimi, sipas dhe në përputhje me Metodologjinë, është kryer konkretisht nga shërbimet e Kuvendit procesi për 8 akte (projektligje) si përkatësisht: projektligji “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, projektligji “Për Paketën e Maleve”, projektligji “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, projektligji “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, projektligji për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.95/2015, “Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik”, të ndryshuar”, projektligji “Për përgjegjësitë e zgjeruara të subjekteve prodhuese të produkteve që gjenerojnë mbetje”, dhe projektligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Tre aktet e para janë kryer së bashku me asistencën teknike të ekspertëve të jashtëm, nga shoqëria civile si përkatësisht nga organizata Fondi Perëndimor për Demokraci.

Sa i takon kryerjes së procesit të vlerësimit për aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që miratohen nga Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe e Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e hapësirës për korrupsion në legjislacion (CPL) për gjithsej 1050 projektakte, nga të cilat 140 janë projektligje dhe 1010 janë vendime të Këshillit të Ministrave, për vitin 2025. Pjesë e këtij procesi i është nënshtruar edhe ligjit “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” nga Ministria e Brendshme, në zbatim të Manualit të Hartimit të Legjislacionit.

Referuar forcimit të kapaciteteve teknike të institucioneve me kompetenca hartimi dhe vlerësimi, stafi pranë Shërbimeve të Kuvendit është asistuar dhe ka ndarë eksperiencën e fushës me partnerë si organizata Fondi Perëndimor për Demokraci³¹. Gjatë muajit tetor 2025, janë organizuar dy aktivitete për forcimin e kapaciteteve të deputetëve të sapo zgjedhur dhe me stafin teknik të Kuvendit. Gjithashtu, në vitin 2025 (dhjetor 2025) u organizuan dy sesione trajnimi dy ditore, në bashkëpunim me Iniciativën Rajonale Antikorrupsion (RAI), me fokus forcimin e kapaciteteve të

²⁸ <https://masl.al/tre-panele-diskutimi-prezantohet-drafti-i-planit-kombetar-te-veprimit-per-mireqeverisjen-antikorrupsionin-dhe-sundimin-e-ligjit/>

²⁹ <https://www.parlament.al/lajme/6bd2aa69-45ca-458d-80b2-0ae8ccbd9a9c>

³⁰ <https://www.parlament.al/kalendar/2025-01-20T11:00:00+01:00>

³¹ Eng: *Western Fund for Democracy*.

stafeve teknike të drejtorive juridike dhe të politikave pranë Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mjedisit, lidhur me procesin e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion. Trajnimet u përqendruan në rritjen e njohurive dhe aftësive praktike për identifikimin, analizimin dhe menaxhimin e rrezeve të korrupsionit, si dhe në zbatimin e metodologjive dhe standardeve më të mira ndërkombëtare në hartimin dhe vlerësimin e legjislacionit. Më 4 dhe 5 dhjetor 2025 ekspertë dhe stafe teknike të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mjedisit u ofuan praktika pune dhe diskutim rastesh për analizimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe vlerësimin e përputhshmërisë së tij me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.1.1. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2025, është vijuar me hartimin dhe konsolidimin procesit për miratimin e akteve ligjore parashikuara në raportin e vlerësimit të vitit 2024 përmendur në raportin e monitorimit të SNKK 2024, dhe gjithashtu pjesë e listës së akteve ligjore në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës për kapitujt 23 dhe 24, si dhe parashikuara në Planin të Përgjithshëm Analitik të Akteve për vitin 2025. Më konkretisht, është miratuar ligji nr. 44/2025 “Për krijimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve” dhe akti nënligjor në zbatim të tij, udhëzimi nr. 203, datë 27.11.2025, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”; ligji nr. 27/2025 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 7.5.2025, “Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, i ndryshuar dhe ligji nr. 96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Gjatë muajit dhjetor 2025 ka vijuar shqyrtimi i procedurave parlamentare të projektligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”. Përgjatë muajit maj 2025 (13 maj 2025) hyri në fuqi ligji nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, që garanton një qasje parandaluese dhe edukuese në reduktimin e korrupsionit në sistemin e inspektimeve. Gjatë këtij viti janë miratuar gjithashtu 5 akte nënligjore në zbatim të këtij ligji. Referuar formulës së matjes së treguesit për këtë periudhë monitorimi, ky tregues performance është realizuar në masën 90%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit dhe vendosja e vlerës bazë për monitorimin
	2025	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	2026	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	2027	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	2028	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara

	2029	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) duhet të miratohen para vitit 2029, përveç nëse ka të tjera shtesë në vlerësim
	2030	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) duhet të miratohen para vitit 2029, përveç nëse ka të tjera shtesë në vlerësim
Vlera synuar/ Targeti	Viti 2025 (targeti i synuar)	Të gjitha ligjet (aktet e tjera) e parashikuara për miratim nga Udhërrëfyesi dhe në listën e akteve (Plani Analitik i Akteve), të miratuara
	Viti 2025 (targeti i arritur)	90%

1.1.2: *Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë ngritur dhe vënë në funksion strukturat antikorrupsion.*

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.1.2* për vitin 2025 është: 80% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (11) dhe masat (2) si më poshtë.

1.1.3	Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit
1.1.3.1	Vlerësim i kuadrit institucional dhe organizativ të institucioneve me kompetenca në luftën kundër korrupsionit (raport/analizë vlerësimi)
1.1.3.2	Identifikimi i nevojave për përmirësimin e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit
1.1.3.5	Emërimi i koordinatorëve antikorrupsion, të pikave të kontaktit antikorrupsion, të koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim
1.1.3.6	Udhëzime dhe takime informuese (2 takime/vit) me Pikat e Kontaktit Antikorrupsion mbi analizat antikorrupsion
1.1.3.7	Identifikimi i nevojave për trajnime të koordinatorëve antikorrupsion, pikave të kontaktit antikorrupsion, koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim, bashkëpunim dhe koordinim
1.1.3.8	Rritje kapacitetesh dhe kualifikim të vazhdueshëm për koordinatorët antikorrupsion, pikave të kontaktit antikorrupsion, koordinatorëve të integritetit dhe koordinatorëve të së drejtës për informim (trajnime dhe sesione informimi të kryera)
1.1.4	Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit
1.1.4.1	Identifikimi i fushave dhe procedurave për bashkëpunim, koordinim dhe shkëmbim informacioni, ndërmjet të gjitha institucioneve parandaluese të korrupsionit të përmendura në strategji
1.1.4.2	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit (dy-palëshe dhe shumë-palëshe) mes institucioneve me kompetenca parandalimi kundër korrupsionit

1.1.4.3	Fuqizim i Ekipit Tematik Antikorrupsioni (anëtar të institucioneve zbatuese të SNKK) për koordinimin të informacioneve dhe të dhënave të raportit të monitorimit
1.1.4.4	Takime dhe forume teknike diskutimi të anëtarëve të Ekipit Tematik Antikorrupsioni (anëtar të institucioneve zbatuese të SNKK) në pararendje të finalizimit të raporteve dhe të dhënave

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të raportit të analizës së kryer, vlerësimit dhe organikave strukturore të ngritura dhe si dhe kapaciteteve profesionale të forcuara dhe të përmirësuara, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Referuar produktit të kryerjes së një vlerësimi të kuadrit institucional dhe organizativ të institucioneve me kompetenca në luftën kundër korrupsionit është kryer në pararendje të afatit dhe mund të gjendet edhe në raportin e monitorimit të SNKK për vitin 2024 (faqe 29-30)³².

Gjatë janar – dhjetor 2025, ka vijuar identifikimi i nevojave dhe adresuar nevoja për plotësim të stafëve me kompetenca parandalimi antikorrupsioni në autoritetet publike. Përgatitja e një raporti analizë për to, është kryer dhe dokumenti ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të strukturave antikorrupsion dhe të kërkesës për përmirësim dhe përditësim të tyre, për të synuar mirëorganizimin e tyre dhe rritur eficensën³³.

Punonjësit me kompetenca parandalimi të korrupsionit (koordinatorë antikorrupsion, të pikave të kontaktit antikorrupsion, të koordinatoreve të integritetit dhe koordinatoreve të së drejtës për informim) vijon në mënyrë të rregullt. Deri në fund të vitit 2025 janë në detyrë me kompetenca të plota 20 koordinatorë antikorrupsion, 78 koordinatorë integriteti (nivel qendror dhe varësi të tyre) dhe 44 në nivel vendor, si dhe 367 autoritete publike kanë të caktuar koordinator për të drejtën e Informimit.

Referuar zhvillimit të trajnimeve dhe kualifikimit të vazhdueshëm për koordinatorët antikorrupsion, pikave të kontaktit antikorrupsion, koordinatoreve të integritetit dhe koordinatoreve të së drejtës për informim, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 2 seanca të dedikuara, gjatë muajve shkurt³⁴ dhe qershor³⁵ nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, me temë “Zbatimi i politikave të antikorrupsionit dhe konfliktit të interesit” dhe “Forcimi i kulturës së integritetit dhe mekanizmave të antikorrupsionit”, me audiencë të dedikuar koordinatorët dhe pikat e kontaktit antikorrupsion, 41 pjesëmarrës gjithsej, nga të gjitha ministritë e linjës dhe drejtoritë e agjencitë qendrore.

Në dhjetor 2025 u finalizua edhe hartimi i manualit teknik nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, i cili do të shërbejë si një instrument mbështetës shtesë për zbatimin dhe

³² Për më shumë referohu në link: www.masl.al dhe në link: <https://masl.al/antikorrupsioni/>, gjithashtu edhe pjesë e dokumentit analitik, publikuar në link: https://masl.al/wp-content/uploads/2025/04/SHTYLLA-I_MIREQEVERISJA_ANALIZA-FINALE_JANAR-2025.pdf.

³³ Referohu të dhënave të përfshira në raportin vjetor të monitorimit 2024, të SNKK (faqe 30).

³⁴ 17 shkurt 2025.

³⁵ 10 qershor 2025.

monitorimin e Strategjisë Antikorrupsion, i cili pas miratimit nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin do të vijë në ndihmë Pikave të Kontaktit Antikorrupsion për lehtësimin e zbatimit të SNKK dhe monitorim e saj.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka kryer edhe për vitin 2025, vlerësimin e nevojave për trajnim për të gjithë punonjësit e administratës publike, duke u bazuar në kuadrin strategjik, kuadrin ligjor, vlerësimet periodike dhe nevojat specifike të institucioneve. Ky raport nevojash për trajnim kryhet në bashkëpunim me ekspertët dhe drejtues të strukturave teknike të autoriteteve me kompetenca parandalimi, sikurse përmendet Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Në vitin 2025, ASPA ka organizuar 3 trajnime për pikat e kontaktit antikorrupsion, me temat: *“Zbatimi i politikave të antikorrupsionit dhe konfliktit të interesit”* dhe *“Forcimi i kulturës së integritetit dhe mekanizmave të antikorrupsionit”* dhe *“Forcimi i llogaridhënies institucionale: Etika, informimi, mekanizmat e antikorrupsionit”*, në të cilat kanë marrë pjesë 61 pjesëmarrës nga ministri të linjës dhe varësi të tyre. Gjithashtu, janë zhvilluar 5 trajnime të posaçme për koordinatorët e së drejtës për informim, me temë: *“Forcimi i Transparencës Publike: Zbatimi i Ligjit nr. 119/2014 dhe Standardet e Konventës së Tromsos”* për koordinatorët e së drejtës për informim ku morën pjesë 139 pjesëmarrës.

Në vitin 2025, ka vijuar bashkëpunimi institucional ndërmjet institucioneve me kompetenca parandaluese ndaj korrupsionit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka rritur transparencën me numrin e publikimeve të dokumentave që kanë të bëjnë me buxhetin, projektet si dhe aktivitete të tjera inicuar prej saj. Ka përmirësuar procesin e auditimit të brendshëm (rritja e numrit të kontrolleve dhe cilësinë e kontrollit), si dhe ka filluar puna për ngritjen e një platforme online të dedikuar për statistikën e turizmit dhe mjedisit.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka ndërmarrë hapa në forcimin e funksioneve të auditimit, rritjen e kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e masave parandaluese ndaj korrupsionit. Janë forcuar kontaktet me institucione të tjera mbikëqyrëse dhe janë ndjekur praktika bashkëpunimi në rastet e ndjeshme të inspektimit dhe hetimit administrativ. Janë zhvilluar kontrole të fokusuara në verifikimin e çështjeve të konsideruara me risk të lartë (për disa importe) ku janë konstatuar mangësi, por gjithashtu janë marrë masa korrigjuese dhe janë përgatitur relacione për menaxhmentin e lartë. Fusha të identifikuar si të nevojshme për rritjen e bashkëpunimit janë: Inspektoriati i Mjedisit, bashkitë, të cilat përfshihen si aktor në procesin e asgjësimit të produkteve, si dhe AKSHI për implementimin e sistemeve digjitale në Pikat e Kalimit Kufitar për të shmangur riskun e gabimeve.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në kuadër të forcimit të funksioneve të auditimit ka plotësuar vendet vakante me auditues me eksperiencë dhe rritur kontrollin e brendshëm dhe zbatimin e masave parandaluese ndaj korrupsionit. Janë forcuar kontaktet me institucione të tjera dhe janë ndjekur praktika bashkëpunimi në rastet e ndjeshme të auditimit, sinjalizimeve të brendshme dhe të jashtme si dhe hetimit administrativ e financiar. Institucionet që identifikohen si të nevojshme për rritjen e bashkëpunimit janë bashkitë, të cilat përfshihen si aktor në procesin e dhënies së lejeve për aplikantët e AZHBR, AKSHI, për implementimin e sistemeve digjitale të aplikimeve e njëkohësisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, AKU, etj, në rolin e trupave teknike certifikues.

Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale pranë DPD, ka trajtuar 45 raste denoncime/ankesa, kërkesa për informacion mbi procedurat doganore, të mbërritura nëpërmjet Numrit Jeshil dhe në adresë antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al, si dhe raste të deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm.

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe të kreut të Ekipit Tematik Antikorrupsion ka ofruar të dhëna dhe informuar anëtarët e këtij grupi, zëvendësministrat e linjës dhe përfaqësues të lartë të KLSH, ILDKPKI, KDIMDP dhe APP mbi nismat e fushës, raporte vlerësimi, monitorime dhe të tjera për politikën antikorrupsion.

Përgjatë muajve mars-maj dhe tetor 2025 janë ofruar informacione në rrugë elektronike dhe takime³⁶ për trajtimin paraprak dhe konsultativ të të dhënave antikorrupsion në referencë me planifikimin në SNKK për vitin 2025.

Ndërkohë për vitin 2025, nuk janë shënuar marrëveshje apo të jenë inicuar marrëveshje të reja bashkëpunimi midis institucioneve (aktiviteti 1.1.4.1).

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.1.2. Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitin 2025, institucionet publike kanë ngritur dhe evidentuar strukturat antikorrupsion dhe kryejnë detyra dhe funksione me kompetenca parandalimi të korrupsionit.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 49, datë 26.03.2025, “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional dhe grupeve teknike ndërinstytucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projektakteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve ‘e-Inspektimi’”, Inspektorati i Përgjithshëm po udhëheq reformën në fushën e inspektimeve, si dhe kryeson grupet e punës për hartimin e projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, në funksion të zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Është konsoliduar Rrjeti i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion për zbatimin e SNKK, në 367 autoritete publike janë caktuar koordinator për të drejtën e Informimit, janë funksionale 185 Njësi Përgjegjëse për sinjalizimin në sektorin publik dhe 526 Njësi Përgjegjëse në sektorin privat, 78 institucione kanë miratuar dhe publikuar Planet e tyre të Integritetit dhe kanë caktuar koordinatorë integritetit si dhe filluar caktimi i koordinatorëve të etikës. Referuar vlerës së synuar për këtë tregues performance rezulton se është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit dhe vendosja e vlerës bazë për monitorimin
	2025	80% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion
	2026	90% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)

³⁶ 6 maj 2025.

	2027	100% e institucioneve publike kanë antikorrupsion (kumulative)
	2028	100% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)
	2029	100% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)
	2030	100% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion (kumulative)
	vitin 2025 (targeti i synuar)	80% e institucioneve publike kanë strukturat antikorrupsion
Vlera synuar/ Targeti	Vitin 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.1

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.1 "Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit"* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për vitin 2025 është **95%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.1 = \frac{TP\ 1.1.1\ (90\%) + TP\ 1.1.2\ (100\%)}{2\ TP} \times 100\% = 95\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2025 dhe të vlerave të treguesve të performancës.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.1

Për vitin 2025, ka një risk të moderuar sic përmendet vonesa në ecurinë e procedurave parlamentare për aktet ligjore të planifikuara sic përmendet ligji për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Gjithashtu, përmendet që duhet të vijojmë caktimi i koordinatorëve të etikës në autoritetet publike.

1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

1.2.1: Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë në përdorim regjistër elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve (trend rritës).

1.2.2: Përqindja e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, të dorëzuara dhe të audituara, nga numri total që duhet të dorëzohen.

1.2.3: Përçindja e institucioneve publike, qendrore, vendore) që kanë hartuar Plane Integriteti (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.2, në periudhën janar-dhjetor 2025 parashikon 19 aktivitete dhe 5 masa.

1.2.1: Përçindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë në përdorim regjistër elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve (trend rritës).

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.2.1 për vitin 2025 është: Të paktën 70% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masa (1) si më poshtë.

1.2.1	Forcimi i transparencës së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.1.2	Statistika përdorimi të platformës e-Albania për shërbimet publike nga qytetarët mbi baza 6-mujore
1.2.1.3	Instalimi i Regjistrimit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit në autoritetet publike përcaktuar sipas vlerësimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit, për të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.1.4	Përgatitja dhe publikimi i një Udhëzuesi (Manuali) për përdoruesit për të drejtën e informimit (shpjegimi i të drejtave të qytetarëve dhe procedurën për qasje të lirë në informacion)
1.2.1.5	Hartimi i një përmbledhjeje të vendimmarrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit për çështje me interes publik dhe rastet e kufizimit të informacionit, konceptet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (vjetore)
1.2.1.6	Trajnime të vazhdueshme/sesione informimi mbi të drejtën e informimit ndaj organeve të administratës dhe publikut

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të indentifikimit të institucioneve, lidhur me përdorimin e shërbimeve në e-albania, vendosjes së Regjistrimit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit, hartim materiale, të dhëna mbi të drejtën e informimit, etj, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, portali e-Albania ka shënuar 3.43 milionë përdorues, qytetarë dhe biznese, një numër në rritje krahasuar me vitin 2024 (3,166,983 përdorues). Gjatë vitit 2025, janë marrë nëpërmjet e-Albania 62 milionë shërbime publike dhe gjeneruar në total 51 milionë dokumente me vulë elektronike, duke reflektuar një rritje të qëndrueshme të përdorimit të shërbimeve digjitale publike. Nga këto, 8.7 milionë shërbime publike janë marrë në 6 mujorin e parë të vitit 2025, krahasuar me 7.3 milionë shërbime publike të marra në të njëjtën periudhë të vitit 2024 (rreth 20% më shumë). Ndërkohë, gjatë 6 muajve të dytë të vitit 2025 janë marrë 8.6 milionë shërbime publike, krahasuar me 7.9 milionë shërbime publike të marra në të njëjtën periudhë të vitit 2024 (rreth 10% më shumë). Mesatarja mujore e shërbimeve publike për vitin 2025 rezulton 1.45 milionë shërbime, në rritje krahasuar me mesataren mujore të vitit 2024, e cila

ishite rreth 1.2-1.3 milionë shërbime publike në muaj, duke reflektuar një rritje të ndjeshme të përdorimit të platformës nga qytetarët dhe bizneset.

Sa i përket dokumenteve dhe akteve me vulë elektronike, në vitin 2025 janë gjeneruar 12.1 milionë (6M1 2025 janë gjeneruar 6.1 milionë dokumente me vulë elektronike 6M2 2025 janë gjeneruar 6 milionë dokumente me vulë elektronike). Referuar shërbimeve publike online në portalin e-Albania janë ofruar 1,266 shërbime publike online, që përfaqësojnë rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike, duke konfirmuar konsolidimin e e-Albania si kanali kryesor për ofrimin e shërbimeve publike digjitale dhe kontributin e tij në rritjen e transparencës, eficiencës dhe aksesit të qytetarëve në shërbimet publike.

Në vitin 2025, u realizua instalimi i Regjistrimit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve (REKPD) për të drejtën e informimit në 25 autoritete të reja publike, sipas planifikimit, dhe duke e çuar gjithsej në 272 numrin e tyre. Ky proces ka vijuar njëkohësisht me zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve të rregullta me koordinatorët e të drejtës së informimit dhe mbi mënyrën e përdorimit të tij. Autoritete që përmenden janë: Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-up-ve dhe Lehtësuesve, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat, IdentiTek Sha, Illyrian Guard Sha, Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Ndërtimit, Komiteti për Pakicat Kombëtare, Korporata e Investimeve Shqiptare sha., Këshilli i Qarkut Dibër, Qendra e Pritjes për Azil, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT), Qendra Kombëtare Teknike Bio-Mjekësore, Qendra Ndërinstitucionale Rrjeti Akademik Shqiptar – RASH, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, Teatri Kombëtar i Operas Baletit dhe Ansambli Popullor dhe Qendra e Botimeve të Diasporës. Në këtë vit nëpërmjet REKPD janë dërguar nga qytetarët dhe grupet e interesit 426 kërkesa për informacion, ndërsa janë paraqitur 28 ankesa pranë Zyrës së Komisionerit.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit ka hartuar “Manualin shpjegues të së drejtës për informim”, i konceptuar në format pyetje-përgjigje, me qëllim ofrimin e informacionit të qartë dhe të thjeshtuar mbi procedurat dhe të drejtën e aksesit në informacion. Manuali është publikuar në faqen zyrtare³⁷ të institucionit dhe është prezantuar për herë të parë gjatë Konferencës VII Kombëtare për të Drejtën për Informim.

Zyra e Komisionerit ka identifikuar dhe përzgjedhur rastet e vendimmarrjes me qëllim përgatitjen e një përmbledhjeje të vendimmarrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit për çështje me interes publik dhe rastet e kufizimit të informacionit, konceptet e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (vjetore) me interes publik. Dokumenti përmbledhje mbetet ende në proces deri në fund të muajit dhjetor 2025.

Gjatë vitit 2025, janë zhvilluar 2 trajnime me koordinatorët për të drejtën e informimit, me fokus në ndryshimet e ligjit për të drejtën e informimit dhe risitë që këto ndryshime kanë sjellë, si dhe zbatimin në praktikë të rasteve konkrete. Koordinatorët e rinj të të drejtës së informimit, u njohën me detyrimet specifike mbi publikimin dhe përditësimin e regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve,

³⁷ <https://idp.al/wp-content/uploads/2025/10/Manual-DDI-Light-2025.html>

si dhe përdorimin e Regjistrimit Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Zyra e Komisionerit ka zhvilluar 2 trajnime me koordinatoret e së drejtës për informim të emëruar rishtazi (të rinj) dhe në bashkëpunim me ASPA, janë zhvilluar 5 cikle trajnimesh me certifikatë, të dedikuara për koordinatoret e së drejtës për informim, me fokus ndryshimet ligjore në fushën e së drejtës për informim, si dhe standardet e Konventës nr. 205 të Këshillit të Evropës “Mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare” (Konventa Tromsø). Në total, 139 koordinatore janë trajnuar dhe certifikuar nga ASPA.

Sa më sipër, masa dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.2.1. Gjatë vitit 2025, KDIMDP ka vijuar dhe instaluar sipas parashikimit regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve. 25 autoritete të reja (si më lart përmendur) janë pajisur me regjistër, duke e çuar në 272 numrin e AP-ve krahasuar me 247 që ishte në fund të vitit 2024. Gjithashtu, janë zhvilluar paralelisht trajnime të rregullta me koordinatoret për mënyrën e përdorimit të tij. Referuar vlerës së synuar për këtë tregues performance rezulton se është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit dhe vendosja e bazës për monitorimin
	2025	Të paktën 70% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2026	Të paktën 75% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2027	Të paktën 80% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2028	Të paktën 85% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2029	Të paktën 90% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	2030	Të paktën 95% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	Të paktën 70% e institucioneve publike të parashikuara, të kenë instaluar dhe në përdorim regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve
	Viti 2025 (targeti i arritur)	100%

1.2.2: *Përqindja e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, të dorëzuara dhe të audituara, nga numri total që duhet të dorëzohen.*

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.2.2* për vitin 2025 është: 100% të deklaratave të paraqitura dhe të audituara sipas detyrimeve ligjore për dorëzim dhe auditim.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masa (1) si më poshtë.

1.2.2	Forcimi i llogaridhënies së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.2.1	Monitorimi i vazhdueshëm i dorëzimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave private për të gjithë subjektet deklarues nëpërmjet sistemit EACIDS
1.2.2.2	Përmirësimi i metodologjise së verifikimit dhe kontrollit të plotë të deklaratave të pasurisë dhe interesave private
1.2.2.3	Ngritja e regjistrave të dhuratave dhe favoreve që u jepen nëpunësve dhe zyrtarëve publikë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (hartimi i një modeli regjistri dhe dërgimi i tij për zbatim tek institucionet)
1.2.2.4	Forcimi i rolit të auditimit të brendshëm të institucioneve nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për antikorrupsion (1) dhe aksesit në informacion (2)
1.2.2.5	Kualifikimi i stafit të burimeve njerëzore në forcimin e llogaridhënies institucionale për çështje të etikës, informimi, dhe mekanizmat e antikorrupsionit nëpërmjet trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme
1.2.2.6	Sesione informimi për konfliktin e interesit dhe deklarimin e pasurisë për të gjitha nivelet e qeverisjes dhe nëpunësit që kanë detyrimin ligjor për to

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht sic janë monitorimi i vazhdueshëm i dorëzimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave private për të gjithë subjektet deklarues nëpërmjet sistemit EACIDS që administrohet nga ILDKPKI, rritjes së rolit të auditimit të brendshëm në institucione dhe kapacitete të rritura të stafëve dhe për njohuri për korrupsionin dhe mekanizma të tij, të ngjitjes dhe vendosjes së mekanizmave të tillë si regjistrat e dhuratave, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, ILDKPKI ka vijuar rregullisht procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, funksionalitetin e plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Pasurisë dhe Interesave Privatë (EACIDS). ILDKPKI, ka realizuar në kohë dhe sipas parashikimit mirëmbajtjen e sistemit elektronik EACIDS, veprimtari që është mundësuar me buxhetin e institucionit, përkatësisht prej 19.207.642 lekë (kosto vjetore).

Për vitin 2025 kanë pasur detyrimin për deklarim 4,554 subjekte dhe nga këta rezulton se vetëm 34 subjekte nuk e kanë përmbushur këtë detyrim në afatet e parashikuara në ligj. Për rrjedhojë, nga këto të dhëna rezulton se 99.3% e subjekteve deklaruese e kanë përmbushur detyrimin për të deklaruar në afat. Sa i përket subjekteve të kontrolluar gjatë këtij periudhe, janar-dhjetor 2025, në përmbushje të skemës së kontrollit të parashikuar në nenin 25/1 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, rezulton se duhet të kalonin në kontroll të plotë 655 subjekte, për të cilët janë nxjerrë urdhrat përkatës të kontrollit të plotë. Për rrjedhojë, janë nxjerrë urdhrat e kontrollit për 100% të subjekteve, në përputhje me skemën e parashikuar në ligj.

Sa i takon dokumentit Metodologji e Verifikimit dhe Kontrollit të Deklaratave të Pasurisë ka nisur procesi për rishikim, së bashku me asistencën teknike nga projekti EU4GG, përgjatë muajve Maj-Qershor 2025 për rakordimin e ecurisë së punës. Prosesi ka vijuar deri në muajt e fundit të vitit 2025.

Referuar hartimit të një modeli regjistri për ngritjen e regjistrave të dhuratave dhe favoreve që u jepen nëpunësve dhe zyrtarëve publikë, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka draftuar një model regjistri dhe mbetet ende për t'u shpërndarë institucioneve për zbatim nga autoritetet publike. Ky proces mbetet për tu finalizuar me vijimin e miratimit të ligjit të ri për parandalimin e konfliktit të interesave.

Sa i takon, Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm profesional për audituesit e brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave, nr.17608, datë 24.12.2024 “Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik për vitin 2025”, janë ofruar trajnim për 21 auditues të brendshëm të institucioneve qendrore dhe të ministrive të linjës, trajnim i vazhdueshëm profesional i audituesve të brendshëm, i kryer në datat 26 - 30 Maj 2025.

Referuar ofrimit dhe organizimit të trajnimeve për tematika lidhur me parandalimin e korrupsionit Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe së bashku me organizatën e shoqërisë civile, IDM, dhe me mbështetjen e SIDA-s, në kuadër të projektit “Forcimi i integritetit publik përmes përmirësimit të shërbimeve publike”, hartoi kurrikulën “Manuali i Rregullave të Etikës për Punonjësit e Administratës Publike”, miratuar nga drejtori i përgjithshëm i DAP, me urdhër Nr.70, datë 21.01.2025. Në vijim të këtij bashkëpunimi, ASPA zhvilloi 5 trajnime në klasë për njësitë e burimeve njerëzore të ministrive dhe institucioneve vartëse, me synim forcimin e njohurive dhe aftësive mbi etikën dhe integritetin në administratën publike, duke theksuar zbatimin praktik të rregullave etike në punën e përditshme, me pjesëmarrjen, me certifikim, prej 53 personash. ASPA ka zhvilluar gjithashtu edhe 8 kurse online me certifikim për nëpunësit e pushtetit qendror, vendor dhe institucioneve të pavarura me 276 pjesëmarrës.

Përgjatë vitit 2025, 325 pjesëmarrës, nëpunës të pushtetit qendror, vendor dhe institucioneve të pavarura, kanë marrë pjesë në sesione me tematikë “Deklarimi i pasurive, llojet dhe afatet e deklaramit të pasurisë” dhe 266 pjesëmarrës të tjere kanë marrë pjesë në sesionin me tematikë “Si të trajtojmë në praktikë raste të konfliktit të interesit?”.

Sa më sipër, masa dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025 dhe në analizim të të dhënave të marra rezulton se ILDKPKI ka mbledhur e administruar të dhëna për 4,554 subjekte deklarues. Rezulton se vetëm 34 subjekte nuk e kanë përmbushur këtë detyrim në afatet e parashikuara në ligj. Për rrjedhojë, nga këto të dhëna rezulton se detyrimi për dorëzim të deklaratave është përmbushur nga 99.3% e subjekteve deklaruese në afat. Sa i përket subjekteve të kontrolluar gjatë vitit 2025, në përmbushje të skemës së kontrollit të parashikuar në nenin 25/1 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, rezulton se planifikuar për të plotë ishin 655 subjekte, për të cilët janë nxjerrë urdhrat përkatës të kontrollit të plotë. Për rrjedhojë, është vijuar me lëshimin e urdhrave të

kontrollit për 100% të subjekteve, në përputhje me skemën e parashikuar në ligj. Referuar vlerës së synuar për këtë tregues performance rezulton se është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Për shkak të natyrës së treguesit, koha e zbatimit të aktivitetit nuk mund të ndërpritet dhe vlerësimi do të bëhet sipas kohës së dorëzimit dhe kontrollit sipas detyrimeve ligjore.
	2026	Vlera e treguesve është vendosur në një konstante 100% të deklaratave të paraqitura dhe të audituara sipas detyrimeve ligjore për dorëzim dhe auditim.
	2027	Për shkak të natyrës së treguesit, koha e zbatimit të aktivitetit nuk mund të ndërpritet dhe vlerësimi do të bëhet sipas kohës së dorëzimit dhe kontrollit sipas detyrimeve ligjore.
	2028	Vlera e treguesve është vendosur në një konstante 100% të deklaratave të paraqitura dhe të audituara sipas detyrimeve ligjore për dorëzim dhe auditim.
	2029	Për shkak të natyrës së treguesit, koha e zbatimit të aktivitetit nuk mund të ndërpritet dhe vlerësimi do të bëhet sipas kohës së dorëzimit dhe kontrollit sipas detyrimeve ligjore.
	2030	Vlera e treguesve është vendosur në një konstante 100% të deklaratave të paraqitura dhe të audituara sipas detyrimeve ligjore për dorëzim dhe auditim.
Vlera synuar/ Targeti	Viti 2025 (targeti i synuar)	Vlerësim i deklaratave të dorëzuara
	Viti 2025 (targeti i arritur)	100%

1.2.3: Përqindja e institucioneve publike, (qendrore, vendore) - që kanë hartuar Plane Integriteti.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.2.3 për vitin 2025 është: Të paktën 80% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative).

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (8) dhe masat (3) si më poshtë.

1.2.3	Forcimi i integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.3.1	Vlerësimi i detajuar i numrit të institucioneve që kanë përgatitur vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe kanë miratuar Plane Integriteti, në të gjitha nivelet e qeverisjes
1.2.3.2	Përgatitja e ndryshimeve në Kodin Etik Ministror, për plotësimin e rregullave për kuadrin etik dhe të integritetit, lobimin dhe organizimin e tij

1.2.4	Përmirësimi i bashkëpunimit midis AMP dhe Policisë Ushtarake, Drejtorisë së Tatimeve dhe struktura të tjera policore me fokus numrin e sanksioneve (masave) të dhëna për zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit për shpërdorim detyre dhe korrupsion
1.2.4.1	Trajnime të përbashkëta (vjetore) me pjesëmarrës nga AMP, Policia e Shtetit, Policia Ushtarake, Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Tatimeve dhe struktura të tjera policore për integritetin dhe informimin në luftën kundër korrupsionit
1.2.5	Hartimi i një kuadri të harmonizuar dhe në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë dhe funksionarëve politikë (duke reflektuar rekomandimin “iii” të Raundit V të GRECO për Shqipërinë)
1.2.5.1	Manual (rulebook) për konfliktin e interesit, etikën dhe parandalimin e korrupsionit për të gjithë funksionarët e administratës publike, në përputhje me kërkesat e rekomandimit iii) të GRECO, i miratuar dhe i informuar
1.2.5.2	Përcaktimi i rregullave të pas-punësimit për funksionarët politikë (përgatitje për ndryshimin e rregullave)
1.2.5.6	Kryerja e analizës mbi kuadrin ligjor për donacionet dhe sponsorizimet në Policinë e Shtetit (raport vlerësimi)
1.2.5.7	Përgatitja e ndërhyrjeve në ligj për donacionet dhe sponsorizimet dhe konsolidimi i një kuadri ligjor
1.2.5.8	Ngritja e Këshillave Konfidencialë në Policinë e Shtetit për të ofruar këshillim konfidencial për punonjësit e policisë mbi çështjet e etikës, integritetit, korrupsionit, konfliktit të interesit, konfidencialitetit dhe çështje të tjera të lidhura me to.

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikuat siç janë monitorimi i vazhdueshëm i informacionit për vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe miratimin e Planeve të Integritetit, në të gjitha nivelet e qeverisjes, në vijim të kuadrit ligjor për konfliktin e interesave përgatitjen e manualëve për zbatim, dhe angazhimi i autoriteteteve si AMP, dogana e tatime në çështje të integritetit nëpërmjet trajnimeve dhe kapacitetve të rritura.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është kryer një dokument (analizë) vlerësimi të riskut të korrupsionit dhe për të parë situatën me Plane Integriteti në autoritetet publike. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka hartuar këtë analizë nga e cila rezulton se në të gjitha ministrinë ka plane integriteti. Ato ministri që u prekën nga ndryshimi i fushës së përgjegjësisë pas kompozimit të kabinetit të ri qeveritar në shtator 2025³⁸, u është kërkuar të rishikojnë ato. Në nivelin e institucioneve të varësisë dhe agjencive qendrore, nga 177 institucione gjithsej, 78 institucione kanë miratuar dhe publikuar Plane Integriteti pas përfundimit të vlerësimit të riskut, 10 institucione ndodhen në proces hartimi ose përditësimi të Planeve të Integritetit, 81 institucione nuk kanë ende Plane Integriteti të miratuara. Në nivelin e qeverisjes vendore, 44 bashki kanë miratuar dhe publikuar Plane Integriteti, 2 bashki ndodhen në proces hartimi ose përditësimi të Planeve të Integritetit, 15 bashki nuk kanë Plane Integriteti të miratuara.

³⁸ Arsimi, ekonomia, turizmi, kultura.

Gjithashtu në vitin 2025, u krye vlerësimi i riskut të integritetit dhe u hartua plani i ri i integritetit³⁹ të Ministrisë së Brendshme, nëpërmjet urdhrit nr.114, datë 18.07.2025, për periudhën 2025 - 2028.

Të gjitha varësitë (agjenci dhe drejtori) pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kanë miratuar kryer vlerësim risku të integritetit dhe kanë miratuar Plane Integriteti. Këto institucione janë: Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, 2025-2027, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, 2024-2027, Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve, 2025-2027, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, 2025-2027, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë, 2025-2027, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Lushnje, 2025-2027, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë, 2025-2027, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë, 2025-2027, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkodër, 2025-2027, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, 2025-2028, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Durrës, 2025-2027, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë, 2025-2027, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Fier, 2025-2027, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Korçë, 2025-2027, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Tiranë, 2025-2027, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Lushnje, 2025-2027, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Korçë, 2025-2027, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Shkodër, 2025-2027, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, 2025-2027, Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Tiranë, 2025-2027, Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Elbasan, 2025-2027, Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Vlorë, 2025-2027, Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Shkodër, 2025-2027 dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, 2025-2027. Gjithashtu, ndër varësitë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si: Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Agjencia Kombëtare për Punësim e Aftësim dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kanë miratuar gjithashtu plane integriteti. Ndër varësitë e Ministrisë së Drejtësisë, ka nisur procesi i rivlerësimit të integritetit për hartimin e Planit të Integritetit në Agjencinë e Trajtimit të Pronës. Me urdhër të drejtorit të Agjencisë, nr. 59, datë 24.2.2025, grupi institucional i punës, po kryen procesin dhe në pritje të miratimit të tij në shtator 2025.

Referuar ndryshimeve në Kodin Etik Ministror, vijojnë të mbeten në proces miratimi pasi ndërhyrja në to pritet të adresohet pasi të miratohet plotësisht aktet ligjore në fushën e konfliktit të interesave dhe të lobimit.

Në vitin 2025, administrata doganore ka përfituar trajnime të përbashkëta për punonjëset femra të institucioneve ligjzbatuese në zbatim të Programit “*We Women*”, të mbështetur nga Ambasada e Britanisë së Madhe. Tematika e trajnimeve ka synuar ndarjen e eksperiencës për menaxhimin e konflikteve gjatë ushtrimit të detyrës⁴⁰, reagimin ndaj ngacmimeve sensual, etj, përfitues kanë qen stafet pranë administratës doganore në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër.

Në kuadër të zbatimit të masave për forcimin e kapaciteteve të brendshme institucionale, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka ndërmarrë gjatë vitit 2025 aktivitete të vazhdueshme trajnime bazë dhe të avancuar për gjithsej 72 punonjës të rinj dhe ekzistues. Këto aktivitete janë zhvilluar në

³⁹ <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Plani-i-Integritetit-i-MB-2025-2028.pdf>

⁴⁰ Ndërlidhur me veprën e shpërdorimit të detyrës.

bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë ICITAP Albania, EU4LEA, Akademinë e Sigurisë, OSBE, ILEA, FBI/SHBA, si dhe institucione partnere nga Bullgaria dhe Kosova, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit. Stafi i AMP ka marrë pjesë në trajnime të specializuara që lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe hetimin e kësaj vepre penale. Konkretisht, dy punonjës të Agjencisë kanë marrë pjesë në trajnimin e zhvilluar më 4-5 dhjetor 2025 në Tiranë, të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, me fokus vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe vlerësimin e hapësirave për korrupsion në legjislacion, në të cilin kanë qenë të përfshirë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera me kompetenca në këtë fushë. Gjithashtu, 4 punonjës të Agjencisë kanë marrë pjesë në një trajnim një-ditor të zhvilluar në nëntor 2025 pranë Akademisë së Sigurisë, me temë hetimin dhe goditjen e korrupsionit, duke u njohur me format dhe metodat e përdorura nga Policia e Shtetit në trajtimin e kësaj veprimtarie kriminale.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përmes strukturave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, ka vijuar zbatimin e një qasjeje të qëndrueshme për forcimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve, seminareve të specializuara. Strukturat përgjegjëse kanë marrë pjesë në 32 trajnime, nga të cilat kanë përfituar 458 punonjës policie. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, dinamika e trajnimeve gjatë vitit 2025 paraqet një rritje të ndjeshme, konkretisht janë zhvilluar 25 trajnime më shumë dhe kanë përfituar 398 punonjës policie më shumë, duke reflektuar një angazhim të shtuar institucional për rritjen e cilësisë së hetimit, analizës dhe parandalimit të krimeve ekonomike dhe financiare, si dhe për forcimin e integritetit ekonomik të vendit.

Paralelisht, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Agjencinë e Inteligjencës Financiare, ka zhvilluar gjatë vitit 2025 një trajnim të specializuar me temë *“Parandalimi i Pastrimit të Parave”*. Trajnimi është fokusuar në aspekte konkrete të riskut financiar, duke përfshirë fshehjen e të ardhurave, krijimin e skemave mashtruese me TVSH, huadhëniet ndërmjet shoqërive dhe ortakëve, si dhe transferimin dhe tjetërsimin e kapitalit. Aktiviteti është realizuar nga trajnerë të Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe është zhvilluar më 6.10.2025, me pjesëmarrjen e 40 pjesëmarrësve, duke kontribuar në rritjen e njohurive praktike dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

Sa i takon rregullave të pas-punësimit për funksionarët politikë nuk ka pasur zhvillime të reja dhe mbeten ende në proces, parashikuar për tu bërë pjesë e ligjit nr. 9131 datë 8.9.2003 *“Për rregullat e etikës në administratën publike”*.

Një dokument analizë për kuadrin ligjor për donacionet, tashmë për sektorin publik është kryer dhe vënë në dispozicion të përgatitjes së kuadrit ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, i cili mbetet në proces hartimi dhe konsultimi.

Ngritja dhe funksionalizimi i Këshillave Konfidencialë në Policinë e Shtetit, Ministri i Brendshëm, nëpërmjet Urdhrit nr. 26, datë 06.02.2025, ka miratuar rregullimin e organizimit, funksionimit dhe përbërjes së Këshillave Konfidencialë në Policinë e Shtetit, duke krijuar bazën ligjore për ofrimin e këshillimit konfidencial për punonjësit e policisë në çështje që lidhen me etikën, integritetin, korrupsionin, konfliktin e interesit, konfidencialitetin dhe procedurat disiplinore. Në zbatim të këtij

urdhri dhe në përputhje me Ligjin nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, Kodin e Etikës dhe Sjelljes, legjislacionin për etikën në administratën publike dhe rekomandimet e GRECO-s, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka miratuar Urdhrin nr. 272, datë 13.02.2025, për ngritjen dhe funksionimin e Këshillave Konfidencialë, si dhe Procedurën Standarde të Punës, miratuar me Urdhrin nr. 293, datë 18.02.2025. Këshillat Konfidencialë janë ngritur pranë strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe pranë strukturave të veçanta, Akademisë së Sigurisë dhe drejtorive vendore të Policisë së Shtetit. Anëtarët e këtyre këshillave caktohen çdo vit kalendarik me urdhër të titullarëve përkatës, sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator në fuqi.

Në vitin 2025 nuk është kryer ende një draft manual (*rulebook*) për konfliktin e interesit, etikën dhe parandalimin e korrupsionit për të gjithë funksionarët e administratës publike, pasi pritet miratimi i ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, të lidhur direkt me treguesin e performancës 1.2.3, vlerësohet se gjatë vitit ka pasur një trend rritës për hartimin e planeve të integritetit në institucionet publike. Janë 122 institucione, në nivel qendror dhe vendor që kanë plane integriteti në zbatim, përgjatë kësaj periudhe. Nga këto, 78 janë autoritete në nivel qendror (autoritete qendrore dhe varësi të tyre) dhe 44 autoritete në nivel vendor (bashki). Referuar vlerës së synuar për këtë tregues performance rezulton se është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	11 ministri, 23 bashki
	2025	Të paktën 80% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2026	Të paktën 85% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2027	Të paktën 90% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2028	Të paktën 95% e institucioneve publike të parashikuara kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2029	Të gjitha institucionet publike kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	2030	Të gjitha institucionet publike kanë miratuar Plane të Integritetit (kumulative)
	Vlera synuar/ Targeti	Viti 2025 (targeti i synuar)
Viti 2025 (targeti i arritur)		100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.2.

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.2. Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për vitin 2025 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.2 = \frac{TP\ 1.2.1\ (100\%)+TP\ 1.2.2\ (100\%)+TP\ 1.2.3\ (100\%)}{3\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KDIMDP, ILDKPKI, dhe nga analiza e vlerësimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2025.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.2

Për vitin 2025, nuk janë evidentuar risqe frekvente në realizimin e objektivit specifik. Ecuria e zbatimit të masave, specifikisht të lidhura me forcimin e transparencës, kontrollin e pasurive, instrumentet e integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes, mund të ketë një risk të ulët nëse administrata e këtyre institucioneve do të ulë mekanizmat e kontrollit.

1.3 Zhvillimi i një qasje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit).

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

1.3.1: Raporti i numrit të vlerësimeve të riskut të korrupsionit të kryera me numrin e sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).

1.3.2: Raporti i numrit të Planeve të Veprimit të hartuara për parandalimin e korrupsionit, nga numri i sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.3, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 24 aktivitete dhe 5 masa.

Vlera e synuar për *treguesit e performancës 1.3.1 dhe 1.3.2* për vitin 2025, janë: 40% e institucioneve me rrezik të lartë/prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit për 1.3.1 dhe 40% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë përgatitur Plane Veprimi për 1.3.2.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (14) dhe masa (5), si më poshtë.

Analiza dhe vlerësimi i tyre për këtë raport monitorimi do të bëhet në mënyrë kumulative për shkak të lidhjes organike dhe relevante që kanë kryerja dhe zbatimi i aktiviteteve, përkatësisht.

1.3.1	Parandalimi i korrupsionit në sektorin publik
1.3.1.1	Rishikimi i metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik
1.3.1.2	Organizimi i trajnimeve me koordinatorët kundër korrupsionit dhe punonjësit/stafin e DPAK për zbatimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik
1.3.2	Parandalimi i korrupsionit në menaxhimin e sektorit të pronave
1.3.2.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit mbi baza funksionesh/veprimtarie në fushën e pronave, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik
1.3.2.2	Regjistri i riskut të sektorit të pronës, i publikuar dhe informuar, për publikun (vjetore)
1.3.2.3	Vlerësim i thelluar i riskut të korrupsionit në fushën e pronave (faktorët e riskut)
1.3.2.4	Vlerësimi i riskut të integritetit dhe Plani i Integritetit i ASHK, i miratuar dhe i publikuar
1.3.2.5	Miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në sektorin e pronave, pas kryerjes së vlerësimit të riskut të korrupsionit, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK
1.3.2.6	Hartimi i programeve të trajnimit të dedikuara për personelin e kadastrës
1.3.3	Parandalimi i korrupsionit në sistemin shëndetësor dhe kujdesit social
1.3.3.1	Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e risqeve të korrupsionit mbi baza funksionesh/veprimtarie në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik
1.3.4	Parandalimi i korrupsionit në fushën e arsimit
1.3.4.1	Hartimi i metodologjisë të vlerësimit të riskut të korrupsionit për funksionimin e sistemit arsimor, si seksion i Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në Sektorin Publik
1.3.4.4	Vlerësim i kurrikulës arsimore për rishikimin e programit për përfshirjen e tematikave antikorrupsioni
1.3.5	Parandalimi i korrupsionit në fushën e prokurimeve publike
1.3.5.2	Vlerësim i riskut të korrupsionit për fushën e prokurimeve publike (faktorët e riskut)
1.3.5.3	Hartimi dhe miratimi i një Plani Veprimi për parandalimin e korrupsionit në sektorin e prokurimit publik, si pjesë përbërëse e Planit të Veprimit të SNKK
1.3.5.4	Përfshirja në kurrikulën e trajnimit të një moduli për integritetin në prokurimin publik si dhe zhvillimi i programeve të trajnimeve për administratën publike ku të adresohen çështjet e integritetit në prokurimet publike

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht siç janë kryerja e vlerësimit të riskut të korrupsionit për sektorë vulnerabël dhe marrja e masave për to, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është miratuar dokumenti Metodologji e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik (Metodologjia) me urdhrin Nr. 2, datë 22.04.2025, të Ministrit të

Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin⁴¹. Metodologjia është i pari dokument në vend, që ofron përmbledhje të detajuar të procesit për vlerësimin e riskut të korrupsionit, duke e strukturuar në disa faza dhe duke shpjeguar në detaje secilën prej tyre. Metodologjia pritet të ofrojë një prezantim të llojeve të ndryshme të faktorëve të riskut të korrupsionit, si dhe përkufizimin e disa termave të rëndësishëm që janë të lidhura me këtë fushë. Metodologjia trajton dilemat etike për sektorët publikë në risk korrupsioni dhe vjen si një ndërthurje e vlerësimit të riskut të integritetit dhe riskut të korrupsionit. Sektorët vulnerabël dhe në risk korrupsioni si: pronësia, kujdesi shëndetësor dhe social, arsimi, prokurimet publike dhe koncesionet, tatimet dhe doganat, të cilat kanë një ndikim të madh në qeverisje dhe besimin e publikut ndaj institucioneve, do ti nënshtrohen vlerësimit të riskut të korrupsionit sektorial mbështetur tek të dhënat dhe procesin që parashikon për kryerje kjo Metodologji. Dokumenti është hartuar ngushtësisht me asistencën teknike të projektit të EU4GG dhe të organizatës ALTRI.

Me miratimin e Metodologjisë, janë zhvilluar seancat e trajnimit dhe transmetimi i njohurive për zbatimin e saj tek stafet teknike të institucioneve të fushës, në nivel qendror dhe vendor, gjithashtu. Për këtë qëllim është ngritur një grup trajnerësh (ToT) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit nga gjithsej 12 persona, që fillimisht janë trajnuar dhe marrë informacion të detajuar nga asistenca teknike e hartimit dhe e përfshirë në hartimin e Metodologjisë. Në datë 28.04.2025, është zhvilluar trajnimi për ToT, të cilët do të lehtësojnë më tej vlerësimin e riskut të korrupsionit në nivel institucional. Në vijim, në datë 6.05.2025 u zhvillua seanca e trajnimit për Koordinatorët Antikorrupsion (21 persona), ku u informuan dhe u ndanë praktikatat e vlerësimit të riskut të korrupsionit ndër ta. Trajnimi u ofrua nga dy prej trajnerëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, së bashku me ekspertët e mbështetjes teknike. Trajnimi i dytë u organizua në datë 20.05.2025 me pjesëmarrjen e 36 personave, stafe të ministrive të linjës, autoritete përgjegjëse me fusha veprimtarie sektorët me risk (prona, tatime, dogana e prokurim publik), varësi të tyre dhe institucione të pavarura. Trajnimi u ofrua nga tre trajnerë të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, së bashku me ekspertët e mbështetjes teknike. Në datë 13.06.2025 u zhvillua seanca e trajnimit për stafe të 28 bashkive, të përzgjedhura ndër bashkitë⁴² që kanë plane integriteti në zbatim. Edhe ky trajnim u ofrua për 5 trajnerë të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, të mbështetur nga ekspertët e mbështetjes teknike.

Në vitin 2025, ka nisur procesi i përgatitjes së metodologjisë sektoriale për riskun e korrupsionit në fushën e pronave, mbështetur tek një proces i strukturuar dhe i bashkërenduar në nivel ndërinstitutional, në funksion të forcimit të standardeve të transparencës, llogaridhënies dhe parandalimit të korrupsionit. MAPA ka koordinuar fazat e procesit, i cili do të ketë edhe mbështetjen teknike të projektit EU4GG të Delegacionit të BE në Tiranë. Me konsolidimin e këtij dokumenti pritet të nisë edhe vlerësimi i riskut të korrupsionit (aktiviteti 1.3.2.3) dhe për rrjedhim edhe të planit të veprimit sektorial (aktiviteti 1.3.2.5).

Me udhëzimin nr.16, datë 31.12.2024, “Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit”, si dhe në bazë të

⁴¹ <https://antikorrupsioni.gov.al/kreu/lista-dokumenteve/>.

⁴² Belsh, Berat, Bulqizë, Durrës, Has, Himarë, Kavajë, Kukës, Lezhë, Maliq, Përmet, Pogradec, Pukë, Roskovec, Shijak, Librazhd, Lushnjë, Shkodër, Prenjas, Libohovë, Vlorë, Kavajë, Fushë-Arrëz, Elbasan, Mallakastër, Tiranë, Patos dhe Mat.

Urdhrit nr. 834, datë 15.07.2025 dhe Urdhrit nr. 835, datë 15.07.2025, nga Drejtori i Përgjithshëm i ASHK, janë ngritur: (1) Grupin i Punës “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Risqeve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” (GMR) dhe (2) Grupin i Punës “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”. Drejtoritë e brendshme të ASHK-së pritet të kryejnë identifikimin dhe analizën e risqeve që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara mbështetur në një analizë të thelluar të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që mund të përbëjnë kërcënime ose pasiguri për funksionimin efektiv të drejtorive përkatëse. Çdo drejtori do të hartojë masa konkrete për parandalimin, minimizimin ose menaxhimin e risqeve të identifikuar (regjistri i riskut të pronës). Këto masa do të përfshijnë: përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin, afatet kohore, burimet e nevojshme dhe mekanizmat e ndjekjes.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka miratuar Planin e Integritetit me urdhër nr.1219, datë 25.11.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK. Në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, përgjatë mars-nëntor 2025, është kryer vlerësimi i riskut të integritetit dhe Plani i Integritetit. Plani i Integritetit 2025-2027⁴³ të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, u krye me një proces të hapur bashkërendimi dhe konsultimi me pjesëmarrjen e stafit drejtues dhe specialistëve të ASHK-së, si dhe të grupeve të interesit, përfshirë noterë, përmbaues, inxhinierë, gjeodetë dhe juristë të Avokaturës së Shtetit. Këto diskutime kontribuan në identifikimin e rreziqeve kryesore të integritetit dhe në përcaktimin e masave parandaluese kundër ekspozimit ndaj korrupsionit, përmes miratimit të akteve të brendshme rregullore, dokumenteve të punës (manuale), forcimit të kapaciteteve teknike-profesionale të drejtorive teknike dhe përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Plani i Integritetit 2025-2027 adreson objektiva të qarta, përfshirë forcimin e kontrollit të brendshëm, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe përmirësimin e kulturës së integritetit në vendimmarrje, rritjen e transparencës institucionale, si dhe shtimin e besimit të qytetarëve dhe bizneseve në shërbimet publike të ofruara nga kadastra.

Ky ndërveprim konsiderohet thelbësor për të garantuar që Plani i Integritetit të mos mbetet një dokument thjesht formal, por të shndërrohet në një instrument funksional për forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë institucionale në ASHK.

Në vitin 2025, referuar programeve të trajnimit për punonjësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka kryer vlerësimin e nevojave të brendshme dhe të jashtme për trajnim. Me Urdhrit nr. 1858, datë 31.12.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, është miratuar Programi dhe Kalendari Vjetor i Trajnimeve për vitin 2026, i cili parashikon zhvillimin e trajnimeve të dedikuara përgjatë gjithë vitit për punonjësit e drejtorive qendrore dhe zyra vendore të ASHK-së. Njëkohësisht, ASHK vijon bashkëpunimin me ASPA-n, e cila siguron materiale informuese dhe programe trajnimi për zhvillimin profesional të punonjësve të administratës publike. Në këtë kuadër, Sektori i Performancës përzgjedh dhe shpërndan materialet përkatëse pranë strukturave përgjegjëse, duke garantuar informimin në kohë të stafit dhe akses të barabartë në mundësitë e trajnimit. Ky mekanizëm kontribuon në sigurimin e një qasjeje të unifikuar dhe të qëndrueshme për zhvillimin profesional të punonjësve të ASHK-së.

⁴³ <https://www.ashk.gov.al/wpcontent/uploads/2025/09/Draft-Plani-i-Integritetit-te-Agjencise-Shteterore-te-Kadastres.pdf>

Në vitin 2025, ka nisur procesi i përgatitjes së metodologjisë sektoriale për riskun e korrupsionit në fushën e shëndetësisë dhe kujdesit social, mbështetur tek një proces i strukturuar dhe i bashkërenduar në nivel ndërinstitucional, në funksion të forcimit të standardeve të transparencës, llogaridhënies dhe parandalimit të korrupsionit. MAPA ka koordinuar fazat e procesit, i cili do të ketë edhe mbështetjen teknike të Instituti për Qeverisjen e Mirë të Bazelit, në Zvicër. Ky proces do të asistohet gjithashtu nga projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim në një bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë.

Në vitin 2025, kanë filluar negociatat për gjetjet e mbështetjes teknike për përgatitjen e metodologjisë sektoriale për riskun e korrupsionit në fushën e arsimit, mbështetur tek një proces i strukturuar dhe i bashkërenduar në nivel ndërinstitucional, në funksion të forcimit të standardeve të transparencës, llogaridhënies dhe parandalimit të korrupsionit. Ky proces mbetet për tu zhvilluar në vitin 2026. Ndërkohë në vitin 2025, Ministria e Arsimit ka përfunduar hartimin e përmbajtjes së kurrikulës së lëndës “Qytetaria”, përmes analizimit të linjave përmbajtësore dhe tematikave konkrete sipas niveleve arsimore nga klasa I-IX, me fokus të posaçëm përfshirjen e tematikave të antikorrupsionit. Miratimi i programeve mësimore që përfshijnë këto tematika është realizuar në muajin tetor 2025, ndërsa zbatimi i tyre, së bashku me miratimin e teksteve të reja të bazuara në këto programe, parashikohet të nisë në vitin shkollor 2026-2027. Ndryshimet në programet mësimore të kurrikulës janë miratuar përmes Urdhri nr. 555, datë 28.10.2025, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë, të disa klasave të arsimit bazë” dhe Urdhri nr. 556, datë 28.10.2025, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe të kurrikulës me zgjedhje, të arsimit të mesëm të lartë”. Këto ndërhyrje përbëjnë një hap të rëndësishëm në integrimin sistematik të edukimit antikorrupsion në kurrikulën arsimore dhe në forcimin e kulturës së integritetit që në arsimin parauniversitar.

Në vitin 2025, Agjencia e Prokurimit Publik me mbështetjen e ekspertëve të mundësuar nga OSBE, ka finalizuar dhe publikuar dokumentin “Metodologjia e riskut në prokurimet publike”⁴⁴, i cili përcakton në mënyrë të qartë faktorët e riskut të korrupsionit dhe mënyrën e matjes së tyre në nivele të ndryshme. Metodologjia orienton institucionet publike në identifikimin e fushave të prirura ndaj korrupsionit dhe në zbatimin e masave specifike parandaluese, duke reflektuar si kuadrin ligjor kombëtar ashtu edhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Dokumenti parashikon dy nivele të vlerësimit të riskut (i) Qasjen në nivel makro, ku APP kryen vlerësimin e riskut për të gjitha autoritetet kontraktore dhe procedurat e prokurimit; dhe (ii) Qasjen në nivel mikro, ku vlerësimi realizohet për sektorë, autoritete apo procedura specifike. Gjatë vitit 2026 parashikohet vijimi i procesit të mbledhjes dhe analizës së informacionit mbi faktorët e riskut, duke marrë në konsideratë se risqet e korrupsionit mund të shfaqen në faza të ndryshme të procesit të prokurimit publik (aktiviteti 1.3.5.2).

Ndërkohë, në vitin 2025, APP ka vijuar bashkëpunimin me ASPA-n për zhvillimin dhe organizimin e trajnimeve ku një nga temat e dedikuara është edhe integriteti i administratës publike sa i takon fushës së prokurimeve publike dhe trajtimit të parimeve si: parimi i konfliktit të interesave, etika dhe respektimi i parimeve të prokurimit publik. Ky bashkëpunim synon institucionalizimin e përfshirjes së integritetit dhe etikës si pjesë e detyrueshme e formimit profesional të autoriteteve kontraktore, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Prokurimin Publik.

⁴⁴ <https://www.app.gov.al/legjislacioni/prokurimi-publik/udherrefyes/>

Në këtë kuadër, ASPA ka zhvilluar sesione informuese dhe trajnime me certifikim në fushën e “Prokurimit Publik”, ku si pjesë përbërëse e kurrikulës janë trajtuar edhe temat e konfliktit të interesit dhe integritetit. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 493 nëpunës nga pushteti qendror, vendor dhe institucionet e pavarura.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesve të performancës 1.3.1 dhe 1.3.2. Në përfundim, me miratimin e dokumentit Metodologji e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik, ka nisur edhe përgatitja e metodologjive sektoriale të vlerësimit të riskut të korrupsionit. Si rezultat, është kryer, konsoliduar dhe miratur Metodologjia sektoriale e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në fushën e prokurimeve publike. Ndërkohë, është kryer procesi për hartëzimin e faktorëve të riskut me qëllim përgatitjen e metodologjisë së vlerësimit të riskut në sektorin e pronave. Po ashtu gjatë vitit 2025, është rakorduar bashkëpunimi teknik për hartimin e metodologjisë për vlerësimin sektorial në sektorin e shëndetësisë dhe kujdesit social. Në referencë me përgatitjen e këtyre dokumenteve të vlerësimit (metodologjive) ka nisur vlerësimi i riskut në sektorin e prokurimit publik dhe në sektorin e pronës dhe për ti hapur udhë gjithashtu, matjes së treguesit të dytë, sic është hartimi i planeve të veprimit. Si përfundim, në lidhje me matjen e treguesve të performancës 1.3.1 dhe 1.3.2 gjatë vitit 2025, rezulton se treguesi i performancës 1.3.1 mbetet në vlerën 50% të arritjes mbështetur vetëm tek dy fushat për të cilat ka nisur (pronat dhe prokurimi publik). Treguesi i performancës 1.3.2 mbetet në varësi të përfundimit të treguesit 1.3.1, ndaj mbetet i paarritur.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.3.1 dhe 1.3.2, sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit (metodologjia e vlerësimit)
	2025	40% e institucioneve me rrezik të lartë/prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2026	70% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2027	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2028	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2029	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	2030	100% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit
	Viti 2025 (targeti i synuar)	1.3.1 40% e institucioneve me rrezik të lartë/prevalencë të korrupsionit kanë kryer vlerësimin e rrezikut të korrupsionit

Vlera synuar/ Targeti		1.3.2 40% e institucioneve me rrezik të lartë/ prevalencë të korrupsionit kanë përgatitur Plane Veprimi
	Viti 2025 (targeti i arritur)	1.3.1 është 50% 1.3.2 është 0%

Niveli i realizimit të objektivit 1.3.

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.3. Zhvillimi i një qasje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit)*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 është **25%**.

Përlllogaritja është në pamundësi për tu matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.3 = \frac{TP\ 1.3.1\ (50\%) + TP\ 1.3.2\ (0\%)}{2\ TP} \times 100\% = 25\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2025.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.3

Për vitin 2025, realizimi i objektivit është vënë në risk si rezultat i finalizimit dhe miratimit për të nisur nga zbatimi metodologjitë e vlerësimit dhe me qëllim hartimin e planeve të veprimit për ndërhyrje në sektorët e pronave dhe të prokurimit publik.

1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Për këtë objektiv është përcaktuar 2 tregues performance:

1.4.1: Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë kryer vlerësime të riskut të integritetit nga numri i atyre që ende nuk e kanë kryer (trend rritës).

1.4.2: Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë përgatitur Plane Integriteti nga numri i atyre që ende nuk e kanë përgatitur (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.4, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 11 aktivitete dhe 3 masa.

Vlera e synuar për treguesit e performancës *1.4.1* dhe *1.4.2* për vitin 2025, janë: 40% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit për *1.4.1* dhe, 40% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit, për *1.4.2*.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitete (11) dhe masa (3) si më

poshtë. Analiza dhe vlerësimi i tyre për këtë raport monitorimi do të bëhet në mënyrë kumulative për shkak të lidhjes organike dhe relevante që kanë kryerja dhe zbatimimi i aktiviteteve, përkatësisht.

1.4.1	Identifikimi i mënyrave për të përmirësuar parandalimin e korrupsionit në njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
1.4.1.1	Vlerësim për zbatimin e instrumenteve në parandalimin e korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore dhe në administratat e qarqeve (raport vlerësimi).
1.4.1.2	Raport vlerësimi për identifikimin e njësive të vetëqeverisjes vendore që nuk kanë ende plane integriteti
1.4.1.3	Përgatitja e Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit dhe Planit model të Integritetit për qarqet dhe bashkitë
1.4.2	Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin efektiv të korrupsionit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
1.4.2.1	Tryezë vjetore ndërgjegjësimi për angazhimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në parandalimin e korrupsionit në ushtrimin e detyrave publike
1.4.2.2	Identifikimi i qarqeve dhe bashkive ku nuk janë caktuar pika kontakti për integritetin dhe kundër korrupsionit
1.4.2.3	Caktimi i pikave të kontaktit për integritetin dhe kundër korrupsionit, dhe koordinatorëve të së drejtës për informim në qarqet dhe bashkitë ku ato nuk ekzistojnë
1.4.2.4	Marrëveshje bashkëpunimi mes DPAK dhe AMVV për bashkërendimin dhe koordinimin e punës në drejtim të zbatimit të masave kundër korrupsionit
1.4.3	Zbatimimi i mekanizmave parandalues të përshtatur me specifikat e Vetëqeverisjes Vendore
1.4.3.1	Vlerësimi i nevojave për trajnime për zbatimin e masave antikorrupsion dhe përgatitja e kurrikulave për trajnime
1.4.3.2	Aktivitete informuese me fokus parandalimin e mekanizmave antikorrupsion, në qarqe dhe bashki
1.4.3.3	Organizimi i trajnimeve për zbatimin e masave dhe aktiviteteve parandaluese antikorrupsion në qarqe dhe bashki (trajnime periodike dhe të vazhdueshme)
1.4.3.4	Përmirësimi i aksesit në informacion, transparenca aktive dhe konsultimi me qytetarët e qarqeve dhe bashkive (faqe interneti funksionale, zyra për qytetarët, botime informuese)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktivitetit që vijon përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht siç përmendet vijimi i hartimit të instrumenteve të integritetit (plane integriteti), zhvillimi i tryezave për diskutim, aksesit në informacion, transparenca aktive dhe konsultimi me qytetarët e qarqeve dhe bashkive (faqe interneti funksionale, zyra për qytetarët, botime informuese).

Gjatë janar – dhjetor 2025, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka përgatitur informacionin mbi situatën e vlerësimit të riskut të integritetit dhe të hartimit të planeve të integritetit në bashki dhe qarqe, dhe për nivelin e zbatimit të tyre. 44 bashki kanë Plane Integriteti në zbatim, ndër të cilat: 35 bashki kanë një plan të vlefshëm deri brenda vitit 2025, 5 bashki i ka përfunduar vlefshëria para vitit 2025 dhe për 4 bashki pritet që Plani i Integritetit të zbatohet pas vitit 2025. Në raportin analizë të kryer evidentohet se mbeten 17 bashki që nuk kanë të miratuar Planin Vendor të Integritetit, përmenden: Cërrik, Devoll, Dimal, Fier, Këlcyrë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Memaliaj, Mirditë, Pustec, Rrogozhinë, Selenicë, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Vau-Dejë⁴⁵.

Ka nisur procesi i hartimit të një dokumenti Metodologji për Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit dhe Planit model të Integritetit, një proces pune që do të mundësohet në bashkëpunim me projektin EU4GG. MAPA dhe DPAK kanë përgatitur një draft paraprak, i cili do të konsolidohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të një dokumenti metodologji, në bashkëpunim me bashkitë për gjatjen e faktorëve të riskut dhe treguesit e matjes.

Referuar zhvillimit të një tryeze vjetore, kombëtare për parandalimin e korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore, është krijuar dhe ngritur infrastruktura dhe koordinuar organizimi i saj. Në korrik 2025 u mbajt tryeza “Vlerësimi i Riskut të Integritetit në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë dhe Metodologjitë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe Korrupsionit”, në bashkëpunim me projektin EU4GG dhe me pjesmarrjen e të gjithë përfaqësuesve dhe stafëve të 61 bashkive të vendit. Tematika të diskutimit të saj ishin: Granti i Bazuar në Performancë; Asistenca për bashkitë, si dhe Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit: qasja, hapat dhe strukturat e nevojshme; Cikli i menaxhimit të riskut të integritetit dhe cikli i menaxhimit të riskut të korrupsionit dhe ushtrime praktike.

Në të gjitha bashkitë e vendit dhe prefektura, janë caktuar dhe në komunikim të rregullt pikat e kontaktit antikorrupsion. Koordinatorë integriteti janë caktuar vetëm në ato bashki që kanë të miratuar plane integriteti (44 bashki) dhe koordinatorët për të drejtën e informimit ato janë caktuar tek të gjitha autoritetet publike (bashki dhe qarqe). Komisioneri miratoi Urdhri nr. 281/2025 “Për miratimin e Modelit të Programit të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” <https://idp.al/wp-content/uploads/2026/01/Urdher-nr.-281-miratimi-Programi-model-i-transparences-per-Njesite-e-Veteqeverisjes-Vendore.pdf> publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 6, datë 08.01.2026. Programi model i Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikon përfshirjen e një fushe të re të dedikuar për veprimtarinë e Këshillave Bashkiak si një nga organet më të rëndësishme të NJVV-ve, si dhe zbatimin e këtij modeli edhe nga këshillat e qarqeve, me qëllim forcimin e transparencës së procesit të vendimmarrjes në nivel vendor.

Në vitin 2025, nuk është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi AMVV-DPAK, por komunikimi institucional është rritur dhe ka lehtësuar ecurinë e zbatimit të masave. Dy përfaqësues të DPAK janë gjithashtu anëtarë në komisionin e vlerësimit të Grantit të Bazuar në Performancë.

Referuar vlerësimit të nevojave për trajnime, mbetet i parealizuar (aktiviteti 1.4.3.1) pasi mbetet i kushtëzuar nga hartimi dhe miratimi i Metodologjisë për Hartimin dhe Monitorimin e Planeve të

⁴⁵ <https://qeverisjavendore.gov.al/decentralizimi/planet-e-integritetit/>.

Integritetit. Gjithashtu nuk janë zhvilluar trajnime për punonjës të bashkive dhe prefekturave (aktiviteti 1.4.3.3).

Referuar informacionit mbi komunikimin, vizibilitetin dhe të drejtën e informimit për bashkitë dhe qarqet (prefektura) rezulton se përgjatë kësaj periudhe të vitit 2025, është rritur dhe përmirësuar cilësia e komunikimit dhe informimit për qytetarët. Në të gjitha bashkitë dhe qarqet e vendit janë caktuar koordinatorët e të drejtës së informimit. 61 bashki kanë faqe aktive interneti ku pasqyrohen të dhënat dhe informacionet për qytetarët, si dhe zyra për komunikim me qytetarët. Ndërkohë, sa i takon qarqeve edhe ato kanë faqe interneti.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesve të performancës 1.4.1 dhe 1.4.2. Në vitin 2025, rezulton se 44 njësi të vetëqeverisjes vendore (bashki) kanë kryer vlerësim të plotë të riskut të integritetit dhe kanë hartuar dhe kanë në zbatim plane integriteti. Referuar vlerës së synuar për këtë tregues performance rezulton se është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.4.1 dhe 1.4.2, sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	1.4.1 Përgatitja e Vlerësimit dhe metodologjia e përgatitur 1.4.2 Përgatitja e vlerësimit
	2025	1.4.1 40% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 40% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2026	1.4.1 70% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 70% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2027	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2028	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	2029	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit

	2030	1.4.1 100% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 100% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
Vlera synuar/ Targeti	Viti 2025 (targeti i synuar)	1.4.1 40% e bashkive dhe qarqeve kanë kryer vlerësimin e rrezikut të integritetit 1.4.2 40% e bashkive dhe qarqeve kanë përgatitur (miratuar) Plane të Integritetit
	Viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.4

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.4 = \frac{TP\ 1.4.1\ (100\%) + TP\ 1.4.2\ (100\%)}{2\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KDIMDP dhe AMVV për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar – dhjetor 2025, dhe në bazë të raportimit direkt të bashkive të vendit (pikat e kontaktit antikorrupsion).

Risqet për realizimin e Objektivit 1.4

Për vitin 2025, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk mesatar, ka pasur trend rritës, por duhet marrë në konsideratë që në vijim trendi të jetë në progres dhe me qëllim arritjen e vlerës së synuar vjetor të treguesit.

1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

1.5.1: *Rritja e auditimeve në fushat me ndjeshmëri publike për të nxitur përdorimin efektiv të fondeve publike, forcimin e llogaridhënies dhe integritetit të administratës.*

1.5.2: *Përçindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet publike nga numri total i rekomandimeve të dhëna (trend rritës).*

Plani i veprimit për Objektivin 1.5, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 9 aktivitete dhe 3 masa.

Vlera e synuar për *treguesit e performancës 1.5.1 dhe 1.5.2* për vitin 2025, janë: 5% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera për 1.5.1 dhe, 80% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar për 1.5.2.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (9) dhe masa (3) si më poshtë. Analiza dhe vlerësimi i tyre për këtë raport monitorimi do të bëhet në mënyrë kumulative për shkak të lidhjes organike dhe relevante që kanë kryerja dhe zbatimi i aktiviteteve, përkatësisht.

1.5.1	Forcimi i rolit të inspektimeve në parandalimin e korrupsionit
1.5.1.1	Bashkëpunime ndërmjet DPAK dhe Inspektoratit Qendror te Pergjithshem për përfshirjen e aspektit antikorrupsion në aktivitetin kontrollues të inspektorateve në ministritë e linjës
1.5.1.2	Manual për kontrollet dhe inspektimet antikorrupsion në punën e inspektorateve në ministritë e linjës me fokus çështje lidhur me komunikimin, koordinimin dhe raportimin e rasteve të korrupsionit
1.5.2	Forcimi i rolit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme në parandalimin e korrupsionit
1.5.2.2	Rishikimi i detajuar i kompetencave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe identifikimi i mundësive për forcimin e mëtejshëm të njohurive dhe përgatitjes së tyre për çështje të korrupsionit
1.5.2.3	Rishikim i procedurave të kontrolleve të kryera nga KLSH
1.5.2.4	Identifikimi i nevojës për trajnimin e audituesve (të brendshëm dhe të jashtëm) për forcimin e aspektit antikorrupsion në punën e tyre
1.5.2.5	Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për forcimin e aspektit antikorrupsion në punën e audituesve të brendshëm dhe të jashtëm, mënyrën e komunikimit, koordinimit dhe raportimit
1.5.3	Forcimi i rolit të enteve rregullatore në parandalimin e korrupsionit
1.5.3.1	Identifikimi i ekspertizës dhe aftësive shtesë të nevojshme për forcimin e parandalimit të korrupsionit në punën e enteve përkatëse rregullatorë
1.5.3.2	Manual për forcimin e kontrolleve për raste korrupsioni, në stafet e enteve rregullatorë
1.5.3.3	Identifikimi i nevojës për trajnimin e enteve rregullatorë për forcimin e aspektit antikorrupsion në punën e tyre

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme dhe specifikisht siç përmendet forcimi i rolit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, kontrolleve të KLSH si dhe sa i takon ekspertizës dhe aftësive shtesë të nevojshme për parandalimin e korrupsionit pranë njësive të enteve rregullatore.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur rishikim të kompetencave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe nuk është realizuar identifikimi i mundësive për forcimin e mëtejshëm të njohurive dhe përgatitjes së tyre për çështjet e korrupsionit. Por, janë vënë re përmirësime e dokumenteve të punës audituese në mbështetje të gjetjeve të auditimit, në përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, nëpërmjet rishikimit të Rregullores së Procedurave të Auditimit, e akteve shoqëruese, pjesë e kësaj rregulloreje. Janë vënë re përmirësim të cilësisë së auditimeve duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të Standarteve Profesionale të Auditimit të Jashtëm Publik dhe rregulloreve të auditimit për të ndikuar në forcimin e sistemit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, si dhe në ndihmë të zhvillimit profesional dhe forcimit të institucioneve publike, si edhe orientim të punës audituese në lidhje me programin buxhetor vjetor dhe afatmesëm, në funksion të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2023 dhe përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike.

Ministria e Financave me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 134, datë 17.10.2025, ka miratuar Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, ku janë rishikuar kompetencat e auditimit të brendshëm dhe komunikimi me auditimin e jashtëm, në përputhje me standardet globale.

Ministria e Financave ka realizuar një raport vlerësimi ku janë identifikuar nevojat për trajnimin e audituesve të brendshëm për forcimin e aspektit antikorrupsion në veprimtarinë e tyre. Këto nevoja janë analizuar dhe janë parashikuar të adresohen gjatë trajnimit të vazhdueshëm për vitin 2026, në bazë të Programit të TVP 2026, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financës, nr. 165, datë 31.12.2025.

Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton se nuk ka pasur zhvillime në drejtim të organizimit të trajnimeve të përbashkëta për forcimin e aspektit antikorrupsion në punën e audituesve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mënyrën e komunikimit, koordinimit dhe raportimit. Por, përgjatë 2025, stafi i KLSH ka marrë pjesë në 116 tema trajnimesh, nga të cilat 29 organizuar nga ASPA dhe 5 nga KLSH & partnerë si EUROSAT, IDI, CEF, SAI-e homologe, etj. Janë trajnuar 154 staf auditues, duke realizuar mesatarisht 24 dite trajnimi / staf auditues për periudhën 8 mujore (nga mesatarisht 13 - 17 ditë trajnimi që është objektivi 8 mujor). Gjatë kësaj periudhe rreth 24% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 76% e tyre online. Nga ana tjetër, ASPA ka zhvilluar një sesion informues dhe një trajnim në klasë me certifikim me temë “Vlerësimi, kontrolli dhe auditimi”, me 363 pjesëmarrës si dhe gjithashtu janë zhvilluar trajnime nga staf i brendshëm i KLSH-së, të mbuluara financiarisht nga buxheti i institucionit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 218, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH, duke kryer dhe evaduar 55 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, performancës, IT dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në 108 subjekte, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: 54 institucione të qeverisjes qendrore dhe të varësisë; 41 institucione të vetëqeverisjes vendore dhe ente të tjera lokale; 4 institucione të pavarura; 5 shoqëri publike dhe projekte me financim të huaj dhe 4 institucione të mbrojtjes së mjedisit. Gjithsej janë realizuar: 11 auditime të kombinuara; 4 auditime me natyrë financiare 8 me natyrë përputhshmërie; 8 auditime IT; 17 për zbatimin e rekomandimeve; 2 auditime performance dhe 5 auditime tematike.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përfunduar kryerjen e 55 misionëve të auditimit, duke konkluduar në: 64 opinione, mesazhe dhe konkluzione auditimi ku përmenden:

- 16 opinione për auditimin e përputhshmërisë,
- 14 opinione financiare,
- 2 mesazhe në auditim performance,
- 32 konkluzione nga të cilat: 17 konkluzione mbi zbatimin e rekomandimeve, 2 në auditime përputhshmërie, 5 në auditim tematike dhe 8 në auditim IT.

Referuar numrit të rekomandimeve, për vitin 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dhënë 1034 rekomandime, dhe nga këto: 114 masa nuk kanë përmbushur afatin ligjor prej 20 ditësh dhe kanë përmbushur afatin ligjor prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes mbi pranueshmërinë e rekomandimeve, 920 masa nga të cilat: janë pranuar 919, ose 99% dhe nuk është pranuar 1 masë. Kontrolli i Lartë i Shtetit në shqyrtimin e zbatimit të rekomandimeve, ka rikërkuar nga të gjithë subjektet zbatimin e masave të pazbatuara, si dhe ka inkurajuar zbatimin e masave që kanë rezultuar në proces ose të zbatuara pjesërisht. Për 55 auditime të përfunduara, ka adresuar rekomandime 4 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situates. Janë dhënë 148 rekomandime mbi gjetje me efekt negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 2,404,623 mijë lekë, nga të cilat: dëm ekonomik vlerësuar 112,257 mijë lekë, menaxhim jo efektiv i fondeve në vlerën 2,292,366 mijë lekë.

KLSH, bazuar në ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 214 rekomandime për masat administrative dhe disiplinore, nga të cilat 3 masa administrative dhe 211 masa disiplinore.

Këtij raporti i mungon informacioni nga entet rregullatore (aktivitetet 1.5.3.1, 1.5.3.2 dhe 1.5.3.2). Gjithashtu, rezultojnë të pazbatuara aktivitetet (1.5.1.1 dhe 1.5.1.2) nga Inspektorati i Përgjithshëm, për shkak të ndryshimeve ligjore dhe ristrukturimit të inspektorateve shtetërore.

Sa më sipër, masa dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, japin disa të dhëna parësore për matjen e vlerës së synuar të treguesve të performancës 1.5.1 dhe 1.5.2, por sikurse rezulton nga informacioni i marrë nga MF, si konkretisht:

- Referuar treguesit 1.5.1: të dhënat numrin e *auditimeve në fushat me ndjeshmëri publike për të nxitur përdorimin efektiv të fondeve publike, forcimin e llogaridhënies dhe integritetit të administratës*, për vitin 2025 do të raportohen në Maj 2026, periudhë kur është percaktuar në akte ligjore finalizimi i “Raportit Vjetor për auditimin e brendshëm në sektorin publik për vitin 2025”.
- Referuar treguesit 1.5.2: e njëjta si më sipër, në relevancë me përgatitjen e “Raportit Vjetor për auditimin e brendshëm në sektorin publik për vitin 2025”.

KLSH, ka kryer 55 misione auditimi në fusha veprimtarie të ndryshme institucionale (si më lart cituar) dhe nga 1034 rekomandime janë pranuar 919 (99%).

Sa më sipër, në pamundësi për të pasur të dhëna nga të dy institucionet përgjegjëse për treguesit, pamundësohet matja konform metodologjisë së matjes së këtij treguesi (në mungesë të pasjes së të dhënave) nga MF, por duke rezervuar të drejtën për marrjen dhe vlerësimin e tyre në vijim dhe për të bërë ato pjesë të raportit të ardhshëm të monitorimit të SNKK (6M1 2026).

Si konkluzion, në pamundësi të pasjes së informacionit të plotë për vlerësimin e të dy treguesve për këtë objektiv, vlerësojmë mospërfshirjen në matjen e statusit të objektivit dhe kryerjen e tij dhe bërjen pjesë e raportit të ardhshëm të monitorimit të SNKK, atë të 6M1 2026.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.5.1 dhe 1.5.2, sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	1.5.1 Përgatitja e vlerësimit 1.5.2 Përgatitja e vlerësimit
	2025	1.5.1 5% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera 1.5.2 80% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2026	1.5.1 10% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 90% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2027	1.5.1 15% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 95% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2028	1.5.1 20% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 100% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2029	1.5.1 25% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 100% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	2030	1.5.1 30% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera (kumulative) 1.5.2 100% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	1.5.1 5% rritje e numrit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme të kryera 1.5.2 80% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm zbatuar
	viti 2025 (targeti i arritur)	Nuk matet⁴⁶

⁴⁶ Të dhënat për treguesin e performancës mund të merren, administrohen dhe vlerësohen në muajin Maj 2026, dhe do të bëhen pjesë e raportit të monitorimit të 6M1 2026.

Niveli i realizimit të objektivit 1.5

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 **nuk matet**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.5 = \frac{TP\ 1.5.1\ (-\%) + TP\ 1.5.2\ (-\%)}{2\ TP} \times 100\% = -47\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Në pamundësi matjeje objektivit referuar treguesve të performancës.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.5

Për vitin 2025, realizimi i objektivit është ka rezultuar në risk të lartë edhe për shkak të pamundësisë së matjes së objektivit referuar treguesve të performancës.

1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

1.6.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të miratuara, nga ato që janë planifikuar të miratohen (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.6, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 10 aktivitete dhe 4 masa.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.6.1* për vitin 2025, është: Përgatitja dhe miratimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Për të arritur vlerën e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (10) dhe masa (4) si më poshtë.

1.6.1	Forcimi i kuadrit institucional për sinjalizimin
1.6.1.1	Raport vlerësimi mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve
1.6.1.2	Përgatitja e ndryshimeve në kuadrin ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, në kuadër të harmonizimit me Direktivën e BE

⁴⁷ Ibid footnote 39.

1.6.1.3	Miratimi i ndryshimeve në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, në kuadër të harmonizimit me Direktivën e BE
1.6.2	Forcimi i kuadrit institucional për sinjalizimin
1.6.2.1	Vlerësimi i funksionimit të njësive përgjegjëse për sinjalizimin, mënyrën e komunikimit, bashkëpunimin dhe raportimin e rasteve (raporte, vlerësimi e të dhëna, vjetore)
1.6.2.2	Ngritja e njësive të sinjalizimit (aty ku mungojnë) dhe plotësimi i stafit të tyre
1.6.2.3	Organizimi i trajnimeve për rritjen e ekspertizës dhe aftësive të personave të ngarkuar me sinjalizimin
1.6.3	Përmirësimi i mjeteve për raportimin e korrupsionit dhe inkurajimi për raportimin e korrupsionit
1.6.3.1	Vlerësimi i mjeteve dhe mënyrave ekzistuese për sinjalizimin në institucionet e të gjitha niveleve, në nivel qendror dhe vendor dhe sektorin privat (identifikimi i mundësive për përmirësim)
1.6.3.2	Krijimi i mjeteve dhe mënyrave për sinjalizimin në institucionet ku mungojnë (online, telefon, postë të rregullt, raportim personal)
1.6.3.3	Fushata edukuese dhe promovuese për sinjalizimin në sektorin publik e privat dhe në shoqëri
1.6.4	Përmirësimi i mbrojtjes për individët që raportojnë korrupsionin (sinjalizimi)
1.6.4.1	Broshura informative dhe edukuese për shpjegimin e rëndësisë së sinjalizimit, të drejtat e sinjalizuesve dhe detyrimin e institucioneve për mbrojtjen e tyre (botime të përvitshme)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijon përgjatë gjithë vitit siç përmendet fillimi i procesit të hartimit të kuadrit të ri ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, operacionaliteti i njësive të sinjalizimit dhe informimi i shtuar për to.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është zhvilluar analiza ligjore dhe procesi i rishikimit të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, me qëllim transpozimin e Direktivës (BE) 2019/1937. Është konsoliduar një proces i detajuar vlerësimi nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 65, datë 28.05.2025 “Për vlerësimin, analizën dhe hartimin e ndryshimeve ligjore” të drejtuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Projektligji është finalizuar me 28 nene, duke siguruar transpozimin e plotë të Direktivës (BE) 2019/1937 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 13 tetor 2019 “Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit”, në kuadrin e brendshëm ligjor. Ligji është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në dhjetor 2025, së bashku me Tabelën e Përputhshmërisë. Proces i hartimit të ligjit është ndjekur dhe mbështetur nga asistenca teknike e projektit EU4GG pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe ka ndjekur një proces të kënaqshëm të konsultimit publik, me pjesëmarrjen e institucioneve publike qendrore dhe të varësisë, komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe akademisë, ku janë diskutuar mekanizmat e mbrojtjes së sinjalizuesve, garantimi i konfidencialitetit dhe funksionimi i kanaleve të raportimit. Më 26 nëntor 2025, Këshilli i Ministrave⁴⁸ miratoi projektligjin dhe ia përcolli Kuvendit të

⁴⁸ <https://www.kryeministria.al/newsroom/projektligje-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-teministrave-date-26-nentor-2025/>

Republikës së Shqipërisë për shqyrtim parlamentar. Në vijim, më 18 dhjetor 2025, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e miratoi ligjin e ri “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, duke përmbyllur procesin legjislativ për një nga aktet kryesore të paketës ligjore “Antikorrupsioni”. Ligji i miratuar vendos një kuadër të plotë dhe të unifikuar për raportimin e shkeljeve dhe rasteve të dyshuara për korrupsion në sektorin publik dhe privat, duke garantuar mbrojtje efektive për sinjalizuesit, ruajtjen e konfidencialitetit dhe funksionimin e qartë të kanaleve të brendshme dhe të jashtme të raportimit. Qasja e re ligjore synon të forcojë besimin e individëve për të raportuar në mirëbesim dhe të rrisë kapacitetet institucionale për identifikimin dhe adresimin e shkeljeve. Miratimi i ligjit është rezultat i punës së përbashkët të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e ministrit përgjegjës dhe propozues të aktit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, si autoritet teknik hartues, dhe të ILDKPKI, si autoritet përgjegjës për zbatimin e ligjit.

Në Janar 2025, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, ILDKPKI ka kryer analizën mbi raportimet e Njësisë Përgjegjëse në sektorin publik e privat për vitin 2024, ku rezultoi se janë marrë dhe administruar 182 raporte vjetore nga Njësitë Përgjegjëse pranë autoriteteve publike. Në analizë të raporteve të paraqitura të sektorit publik, konstatohet se, në 2 Njësi Përgjegjëse janë sinjalizuar dhe trajtuar 2 raste. Në lidhje me Njësitë Përgjegjëse pranë sektorit privat, janë marrë dhe administruar 258 raporte sinjalizimi. Në analizë të raporteve të paraqitura, konstatohet se në 1 Njësi Përgjegjëse janë sinjalizuar dhe trajtuar 10 raste sinjalizimi.

Në vitin 2025, janë ngritur dhe plotësuar me staf 52 Njësi Përgjegjëse të reja nga sektori privat. Në total rezultojnë të ngritura 185 Njësi Përgjegjëse në sektorin publik dhe 526 Njësi Përgjegjëse në sektorin privat Njësitë Përgjegjëse kanë marrë masat për plotësimin e stafit të tyre nga ku rezultojnë në total 361 të punësuar në njësitë e sektorit publik dhe 960 të punësuar në njësitë e sektorit privat.

Sa i takon informimit dhe ndërgjegjësimin për sinjalizimin, ASPA ka zhvilluar trajnimin për nëpunësit e pushtetit qendror, vendor dhe institucioneve të pavarura me temë: “Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve” me pjesëmarrjen e 94 persona, stafe të administratës publike. Ndërkohë përgjatë kësaj periudhe nuk janë ofruar të tjera masa informative dhe ndërgjegjësimi.

Në referencë me aktivitetet 1.6.3.1, 1.6.3.2, 1.6.3.3 dhe 1.6.4.1, nuk ka pasur zbatim të tyre përgjatë vitit 2025. Ligji i ri “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” është publikuar në Fletoren Zyrtare më datë 21.01.2026, dhe zbatimi i këtyre aktiviteteve do të vijojë në përputhje me dispozitat dhe afatet e parashikuara në këtë kuadër të ri ligjor.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.6.1. Procesi i përmbyllur me sukses i miratimit të ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” nga Kuvendi i Shqipërisë⁴⁹ në dhjetor 2025, adreson arritjen e treguesit dhe të rezultatit të pritshëm për këtë objektiv për këtë vit të SNKK. Ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

⁴⁹ Ligji nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.6.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Përgatitja dhe miratimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2026	Përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore lidhur me ndryshimet në Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve
	2027	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2028	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2029	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
	2030	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	Përgatitja dhe miratimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve
	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.6

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.6 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.6

Për vitin 2025, nuk ka paraqitur risk.

1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

1.7.1: Hartimi i draftit të Ligjit për Financimin e Partive Politike

Plani i veprimit për Objektivin 1.7, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 3 aktivitete dhe 2 masa.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.7.1* për vitin 2025, është: Përgatitja e vlerësimit (analizë e kryer) për ligjin për Financimin e Partive Politike.

Për të arritur vlerën e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (3) dhe masa (2) si më poshtë.

1.7.1	Forcimi i transparencës financiare të partive politike
1.7.1.1	Analizë për Rishikimin e kuadrit ligjor për transparencën e financimit të partive politike
1.7.1.2	Rishikimi i formatit të raportimit financiar të partive politike, duke përfshirë donacionet në natyrë dhe kontrollin e shtuar mbi mundësitë për pastrim parash në financimin e tyre
1.7.2	Promovimi i rëndësisë së transparencës financiare dhe integritetit të partive politike
1.7.2.1	Përmirësimi i transparencës dhe aksesit në raportet financiare të partive politike dhe auditime të aktivitetit financiar të partive politike (publikime të shtuara)

Realizimi i masave të parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijon përgjatë gjithë vitit siç përmenden rishikimi me qëllim përmirësimin e kontroleve mbi financat e partive politike dhe rritje të transparencës së tyre.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është përfunduar analiza e vlerësimit për të forcuar kontrollin e financave të partive politike, të kandidatëve për funksione politike që marrin pjesë në fushata zgjedhore. Analiza është kryer nga grupi i ekspertëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, në Kuvend⁵⁰. Dokumenti analizë ka marrë në shqyrtim kuadrin ligjor në fuqi të vendit për këtë çështje, rekomandimet dhe propozimet e lëna Shqipërisë për adresimin sa më efikas të fushës dhe propozimet konkrete. Analiza e orienton ndërhyrjen e kuadrit ligjor në variante konkrete për ndërhyrje, të cilat priten të sigurojnë mbulim ligjor për: Burimet e financimit: të lejuara dhe të ndaluara, përfshirë rregullimin e financimeve në natyrë dhe huave; Transparenca: publikim i detyrueshëm dhe në kohë reale i donacioneve mbi një prag të caktuar (p.sh. 50,000 lekë); Raportimi: detyrim për raportim paraprak, gjatë dhe pas fushatës; Mbikëqyrja: krijimi i një njësie të specializuar pranë KQZ ose të një organi të pavarur për kontrollin financiar; Palët e treta: ndalim dhe rregullim i reklamave politike dhe ndërhyrjeve nga subjekte që nuk janë pjesë të garës zgjedhore; Sanksione: sanksione efektive, proporcionale dhe të zbatueshme për shkelje të dispozitave, dhe Raportim dhe auditim online: zhvillimi i një platforme të dedikuar për raportim elektronik dhe gjurmim publik.

Në vitin 2025, është kryer monitorimi dhe janë hartuar raporte për aktivitetin e partive politike, mbi financat e tyre. Këto raporte janë lehtësisht të aksesueshëm pranë faqen së internetit të KQZ, në link: www.fpp.kqz.gov.al/kreu/reports. Janë 1610 raporte monitorimi për parti politike dhe kandidatë për tu zgjedhur për funksione politike të publikuar në këtë faqe internet. Raportet përmbajnë të dhëna për aktivitetin politik e pjesëmarrës të subjekteve të monitoruara, mbi

⁵⁰ <https://masl.al/financimi-i-partive-politike-ekspertet-mblidhen-ne-kuvend-per-hartimin-e-nje-drafti-te-ri-ligjor/>.

organizimin e tyre dhe njësi të përdorura prej tyre. Në portalin hyrës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i është dhënë hapësirë promovimit të transparencës financiare dhe integritetit të subjekteve politike, pasi gjen në mënyrë të strukturuar informacione mbi to⁵¹. KQZ ka siguruar publikimin dhe aksesin publik në raportet financiare për dy procese zgjedhore gjatë vitit 2025. Monitorimi i zgjeruar i fushatës zgjedhore ka mundësuar identifikimin e shkeljeve dhe marrjen e masave administrative përkatëse (81 masa), ndërkohë që për zgjedhjet e pjesshme vendore nuk janë konstatuar shkelje. Transparenca dhe llogaridhënia janë përmirësuar përmes publikimit të plotë të raporteve dhe zhvillimit të një formati më të aksesueshëm për publiku.

Gjithashtu, janë rishikuar dhe miratuar formatet e raportimit financiar për partitë dhe kandidatët, në përputhje me nenin 92/2, pika 3.1 të Kodit Zgjedhor (detyrimi që KQZ të miratojë modelet brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit). Me Vendimin e KR, nr. 11, datë 27.02.2025, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 18, datë 14.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”, u përditësuan udhëzuesit e raportimit (ndryshimet e vendimit nr. 18, datë 14.04.2021), duke saktësuar raportimin e dhurimeve në natyrë, ndarjen e shpenzimeve për reklamat në media sociale si zë i veçantë dhe kërkesat për dokumentim bankar mbi 50,000 lekë. Referuar këtyre ndërhyrjeve, është përgatitur edhe një paketë trajnimi për subjektet përdorues, siç përmenden financiarët e subjekteve politike. Kjo paketë trajnimi është hartuar me kapacitetet dhe mbështetjen financiare të KQZ nga buxheti i shtetit.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.7.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe në kuadër të procesit të reformës për kontrollin e partive politike në Kuvendin e Shqipërisë ka përgatitur një paketë të plotë propozimesh për rishikimin e formatit të raportimit financiar të partive politike. Procesi është shoqëruar me një proces konsultimi me grupin e ekspertëve pranë Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim adresimin e problematikave të evidentuara në praktikën e raportimit financiar. Si rezultat i këtij procesi, 100% e rekomandimeve të hartuara nga KQZ janë integruar në projektligjin “Për financimin e partive politike”, i cili ndodhet aktualisht në shqyrtim në Kuvend. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.7.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Përgatitja e vlerësimit (analizë e kryer) për ligjin për Financimin e Partive Politike
	2026	Hartimi i kuadrit të ri ligjor për Financimin e Partive Politike
	2027	Miratimi i kuadrit të ri ligjor për Financimin e Partive Politike
	2028	Miratimi i akteve nënligjore të nevojshme dhe zbatimi i ligjit

⁵¹ <https://kqz.gov.al/perf>.

	2029	zbatimi i ligjit
	2030	zbatimi i ligjit
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	Përgatitja e vlerësimit (analizë e kryer) për ligjin për Financimin e Partive Politike
	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.7

Niveli i realizimit të Objektivit 1.7 *Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.7 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KQZ dhe të dhëna të tjera që administrojnë dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.7

Për vitin 2025, nuk ka paraqitur risk.

1.8 Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument i parandalimit të korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performace:

1.8.1: Raporti i numrit të akteve ligjore dhe nënligjore për lobimin të hartuara nga numri i atyre të planifikuara për miratim (trendi rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 1.8, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 2 aktivitete dhe 1 masë.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 1.8.1 për vitin 2025, është: Përgatitja e Ligjit për lobim (fazat e vlerësimit dhe analizës paraprake).

Për të arritur vlerën e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (2) dhe masa (1) si më poshtë.

1.8.1	Krijimi i kornizës legislative dhe institucionale për lobim
-------	---

1.8.1.1	Analizë e detajuar e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira për lobimin
1.8.1.2	Tryezë diskutimi me palë të interesuara me fokus lobimin dhe konfliktin e interes

Realizimi i masës së parashikuar është kryer përmes aktiviteteve të planifikuara për këtë periudhë zbatimi, të fokusuara në përgatitjen e analizës ligjore dhe hartimin e kuadrit të ri ligjor për lobimin në Shqipëri.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është zhvilluar e plotë analiza ligjore e cila do të paraprijë hartimit të kuadrit ligjor të brendshëm për lobimin në Shqipëri. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e ministrit përgjegjës për fushën, ka autorizuar stafin teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në rolin e Sekretariatit Teknik, për përgatitjen e një dokumenti teknik analitik mbi rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe formulimin e rekomandimeve konkrete për hartimin e tij në përputhje me standardet ndërkombëtare. Dokumenti analizë është hartuar duke paraqitur edhe propozime konkrete për hartimin e një ligji të fushës dhe ideimin për legjislacionin dytësor përkatës.

Analiza evidenton që kuadri i ardhshëm ligjor lobimin duhet të zbatohet për të gjithë zyrtarët publikë, përfshirë nëpunësit civilë dhe individët brenda subjekteve private, të cilët ushtrojnë autoritet publik, duke specifikuar ato kategori subjektësh që nuk duhet të jenë pjesë e rregullimit të tij. Gjithashtu, analiza ofron përkufizime të qarta të termave kyç, si “lobim”, “vendimmarrje publike” dhe “lobist”, me qëllim sigurimin e një zbatimi të qëndrueshëm dhe uniform të ligjit, si dhe përcakton parimet e përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë e lobimit, përfshirë transparencën, integritetin e vendimmarrjes publike dhe njohjen e lobimit si një aktivitet legjitim i procesit demokratik.

Analiza përfshin gjithashtu shembuj dhe praktika të rregullimit të lobimit në vende të tjera, kryesisht të Bashkimit Evropian, si dhe trajton alternativat për organizimin e autoritetit përgjegjës dhe rregullator të fushës. Përgatitja e këtij dokumenti teknik është asistuar ngushtësisht nga zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë. Përgatitja e këtij dokumenti teknik është asistuar ngushtësisht nga zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë.

Në vijim, në 31 korrik 2025 DPAK në bashkëpunim me asistencën teknike të Këshillit të Evropës zhvilloi tryezën për prezatimin e analizës për hartimin e kuadrit ligjor. Në tryezë u prezantuan gjetjes dhe propozimet për strukturën e ligjit.

Në vijim të këtij procesi, është nisur hartimi i projektligjit “Për lobimin”, dhe përgjatë muajve shtator – dhjetor 2025, është hartuar, konsultuar dhe miratuar akti ligjor. Më datë 30.12.2025, Këshilli i Ministrave miratoi projektligjin “Për Lobimin në Republikën e Shqipërisë”, duke i dhënë nismës ligjore statusin e nisjes së procedurave parlamentare. Miratimi i projektligjit është rezultat i punës së përbashkët të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e ministrit përgjegjës dhe propozues të aktit, dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në rolin e autoritetit teknik përgjegjës për hartimin e kuadrit ligjor, në bashkëpunim me ekspertët e Këshillit të Evropës. Projektligji siguron përputhshmëri me Rekomandimin CM/Rec(2017)2 të Këshillit të Evropës dhe praktikat më të mira evropiane për

transparencën e lobimit, duke përforcuar më tej kuadrin kombëtar antikorrupsion dhe mbështetur procesin e integritetit evropian.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.8.1. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin ka udhëhequr procesin e vlerësimit, hartimit, konsultimit publik, propozimit të aktit ligjor në Këshillin e Ministrave deri në miratimin e tij në 30 dhjetor 2025. Në drejtim të Grupit Ndërinstitucional të Punës dhe së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit (sekretariat teknik) procesi është kryer i plotë dhe i rregullt duke mundësuar në avancë kundrejt planifikimit në SNKK, të miratimit të ligjit nga Këshilli i Ministrave. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.8.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Përgatitja e Ligjit për lobim (fazat e vlerësimit dhe analizës paraprake)
	2026	Përgatitja e Ligjit për lobim (fazat hartimit – konsultimit)
	2027	Miratimi i Ligjit për lobim
	2028	Miratimi i akteve nënligjore lidhur me Ligjin për lobim
	2029	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për lobimin
	2030	Zbatimi i ligjit dhe akteve nënligjore për lobimin
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	Përgatitja e Ligjit për lobim (fazat e vlerësimit dhe analizës paraprake)
	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.8

Niveli i realizimit të Objektivit 1.8 *Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 **është 100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.8 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administrojnë dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.8

Për vitin 2025, nuk ka paraqitur risk.

1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

1.9.1: Përqindja e subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë vendosur bashkëpunime për ngritjen dhe promovimin e integritetit në sektorin privat nga numri i bashkëpunimeve të vendosura vitin e kaluar (trend rritës)

Plani i veprimit për Objektivin 1.9, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 3 aktivitete dhe 1 masë.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 1.9.1* për vitin 2025, është: 5% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim.

Për të arritur vlerën e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (3) dhe masa (1) si më poshtë.

1.9.1	Promovimi i kërkesës për integritet në sektorin privat
1.9.1.1	Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi dhe formalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit midis autoritetit publik përgjegjës për politikën antikorrupsion dhe dhomat aktive të tregtisë dhe të biznesit (marrëveshje bashkëpunimi/klauzola antikorrupsion)
1.9.1.2	Bashkëpunim me dhomat e tregtisë dhe të biznesit (takime periodike dhe të rregullta), ndarje informacioni, koordinim dhe konsultim iniciativash nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit
1.9.1.4	Hartimi i modeleve të Kodeve të Etikës dhe Planeve të Integritetit për kompanitë private si instrumente kundër korrupsionit sipas standardeve ndërkombëtare

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuar për tu kryer përgjatë gjithë vitit për të krijuar hapësirat e bashkëpunimit dhe rritjes së informimit të sektorit privat për integritetin në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është synuar formalizimi i marrëdhënies së bashkëpunimit midis autoriteteve publike me kompetenca antikorrupsionit dhe përfaqësuesve të biznesit me qëllim ndarje dhe marrje mendimesh për iniciativa të luftës kundër korrupsionit si ngritje mekanizmash, marrje ankesash dhe denoncimesh, kuadri i integritetit dhe konsultime të politikave antikorrupsion, tashmë do të vijë si një bashkëpunim formalizuar me anë të një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Draft marrëveshja është hartuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, por mbetet ende në proces dakordësimi dhe miratimi. Marrëveshja do të japë jetë ngritjes së një koalicioni

bashkëpunimi që synon të sjellë në tryezë dialogu sektorin privat, publik dhe palë të shoqërisë civile (akademia) për të ndërtuar një agjendë diskutimi dhe ndërmarrë veprime mbi çështje që i përkasin integritetit të sektorit privat.

Ndër objektivat e draft marrëveshjes përmenden: (1) Të ndërtojë një agjende pune të qendrueshme në fushën e antikorrupsionit (integriteti i sektorit privat) me përfaqësues të sektorit privat, publik dhe akademisë; (2) Të aktivizojë dialogun mes aktorëve përmes kësaj platforme duke bërë të mundur që të jetë zëri gjithëpërfshirës në trajtimin e zgjidhjeve dhe problematikave të ndryshme; (3) Të organizojë aktivitete vjetore si konferenca, trajnime, forume, etj. në fushën e antikorrupsionit në formatin e javëve të ndërgjegjësimit publik, (4) Të zhvillojë instrumente në fushën e integritetit, në gjuhën shqipe, për përdorim nga subjekte të sektorit publik dhe privat (si psh: Kod Etike, manual/udhëzues mbi dhuratat dhe mikpritjen, udhëzues mbi konfliktin e interesit, etj.); (5) Të promovojë përdorimin e instrumenteve praktike të hartuara nga institucione ndërkombëtare si UN, OECD, ICC, etj. për sektorin publik dhe privat; (6) Të mundësojë prodhimin e instrumenteve ndërkombëtare të prodhuara nga institucionet ndërkombëtare në gjuhën shqipe për aktorët shqiptarë publikë dhe privat; (7) Të hartojë një vlerësim nevojash në mënyrë periodike dhe të identifikojë çështje prioritare për veprim nga koalicioni; (8) Të krijojë grupe pune mbi tematika specifike sipas përcaktimit të nevojave; (9) Të angazhohet në bashkëpunime për aktivitete të ndryshme në fushën e antikorrupsionit me qëllim zhvillimin e dialogut dhe promovimin e praktikave më të mira, dhe (10) Të zhvillojë çfarëdo aktivitete të tjera, si vendimmarrje e koalicionit.

Referuar zhvillimit të aktiviteteve konkrete për këtë periudhë monitorimi, përmendet programimi i pjesëmarrjes⁵² së përfaqësuesve të autoritetit përgjegjës për antikorrupsionin në takimin e Komisionit të ICC Albania për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Integritet. Çështje si: integrimi i lidershit etik, transparenca dhe advokimi i politikave në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe procesin e integritetit në BE, si komponentë me rëndësi në bashkëpunimin e luftës kundër korrupsionit mbeten në fokusin e diskutimit dhe ofrimit për bashkëpunim, përkatësisht.

Përgjatë qershor 2025, nga ministria e linjës për politikat ekonomike dhe bashkëpunim me sektorin privat janë organizuar 4 takime dhe aktivitete informuese në bashkëpunim edhe me Dhomat e Biznesit, dhe me të cilat janë trajtuar tematika lidhur me aspektet e integritetit në biznes ose në sektorë vulnerablë apo të rregulluar. Përmendim: aktiviteti “Ditë Informuese” për të prezantuar Udhëzuesin e Programeve Financiare të Bashkimit Evropian, një instrument praktik dhe gjithëpërfshirës për rritjen e aksesit në financimet evropiane, me qëllim ndihmën ndaj bizneseve, shoqatave, organizata, akademisë dhe institucionet publike shqiptare për të përfituar nga mundësitë që ofrojnë programet evropiane, veçanërisht në drejtim të: (a) Rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve në tregjet evropiane, (b) Bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përshejtimit të integritetit në BE, dhe (c) Mundësive të përfitimit nga skemat e granteve për të lehtësuar aksesin në financë të bizneseve. Tryezë për Kapitullin 3 “E Drejta e Vendosjes dhe Liria për të Ofruar Shërbime”, me pjesëmarrës 40 përfaqësues nga biznesi, institucionet shtetërore dhe shoqëria civile. Tematika e tryezës ishte “Informimi i sektorit privat mbi reformën e ligjit Nr. 66/2016 “Për shërbimet” dhe përafrimin me Direktivën e Shërbimeve të BE-së”. Tryezë për

⁵² E lançuar për tu zhvilluar në 3 korrik 2025.

Kapitullin 6 “Legjislacioni për Shoqëritë Tregtare” me pjesëmarrës 45 përfaqësues nga institucionet shtetërore, biznesi dhe dhomat e tregtisë. Tematika e tryezës ishte “Prezantimi i bazës ligjore për përafrim me Direktivat e BE-së në kuadër të integritimit evropian për Kapitullin 6”. Tryezë për Kapitullin 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”, me pjesëmarrës 50 përfaqësues nga institucionet shtetërore, biznesi dhe dhomat e tregtisë. Tematika e tryezës ishte “Prezantimi i raportit Draghi mbi konkurrueshmërinë në BE”.

Në muajin tetor 2025, me iniciativë Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit iu bashkua iniciativës për instalimin e integritetit në organizimin dhe veprimtarinë e sektorit privat (biznese dhe kompani). Tryeza “*Nga integriteti tek përputhshmëria*” bëri bashkë sektorin publik dhe sektorin privat duke adresuar planifikimin strategjik të luftës kundër korrupsionit, 2024-2030, për më shumë integritet, ligjshmëri, veprimtari korrekte dhe masa kundër korrupsionit. Dhoma Amerikane e Tregtisë në bashkëpunim me ekspertizën teknike të organizatës IDM Albania shpallëm nisjen e zhvillimit të aftësive praktike për menaxhimin e risqeve të korrupsionit dhe konfliktit të interesit në kompanitë private, përmes përdorimit të instrumenteve të vetë-rregullimit si kodet e etikës, planet e integritetit dhe njësitë e sinjalizimit.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 1.9.1. Aktivitetet e zhvilluara nga ministria e linjës dhe autoritete të tjera sic edhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka në ushtrimin e mandatit të saj, kanë ndikuar në rritjen e ndërveprimit me sektorin privat (organizime të tij) në relevancë me politikat antikorrupsion dhe mjete dhe përmirësim të instrumenteve për veprim, sic janë edhe instrumentet e integritetit. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 1.9.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	5% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2026	10% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2027	15% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2028	20% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2029	25% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	2030	30% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	5% rritje e numrit të subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë krijuar bashkëpunim
	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 1.9

Niveli i realizimit të Objektivit 1.9 *Promovimi i integritetit në sektorin privat*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.9 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.9

Për vitin 2025, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke evidentuar që bashkëpunimi do të finalizohet dhe zhvilluar bashkëpunimet konkrete me sektorin privat.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit (Politika Parandaluese - I)

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të ⁵³ objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit. Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave, mbledhur realizueshmërinë në përqindje të treguesve të performancës dhe pjestuar me numrin e treguesve, realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit është **90%**.

Objektivi Specifik	Realizueshmëria
1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit	95%
1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes	100%
1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)	25%
1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore	100%
1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik	- ⁵⁴ 0%

⁵³ 8 objektivëve duke përmendur pamundësinë e matjes për objektivin 1.3.

⁵⁴ Të dhënat për treguesin e performancës mund të merren, administrohen dhe vlerësohen në muajin Maj 2026, dhe do të bëhen pjesë e raportit të monitorimit të 6M1 2026.

1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit	100%
1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike	100%
1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni	100%
1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat	100%

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit arriti nivelin 90%, dhe sinjalizon vijueshmërinë e një trendi pozitiv në zbatimin e masave *gjatë periudhës janar - dhjetor 2025*.

Si rezultat, u shënuan përparime të rëndësishme në miratimin e akteve ligjore si ligji për recuperimin e aseteve, ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si edhe nisja e përgatitjes konkrete të kuadrit ligjor për lobimin (miratuar në KM), financimin e partive politike, dhe ligji për parandalimin e konfliktit të intereve në ushtrimin e funksioneve publike (si pjesë e paketës ligjore “antikorrupsioni”). Po ashtu, është miratuar Metodologjia e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion për Shërbimet e Kuvendit dhe është kryer procesi për 8 akte ligjore, nga të cilat 3 janë kryer me ekspertizë teknike të pavarur, jashtë administratës publike, si: projektligji për Paketën e Maleve; projektligji për Përgjegjësitë e Zgjeruara të Subjekteve Prodhuese që Gjenerojnë Mbetje, dhe projektligji për Rezervat Materiale të Shtetit dhe kryer vlerësimit të hapësirave për korrupsion të ligjeve që hartohen në konkretisht 1050 projektakte (projektligje dhe projektvendime të Këshillit të Ministrave). Janë zhvilluar takime të rregullta informimi dhe seanca trajnimi për Rrjetin e Pikave të Kontaktit Antikorrupsion, me fokus udhëzimin e raportimit dhe përgatitjen e analizave antikorrupsion, në kuadër të institucionalizimit dhe informimit të shtuar për Rrjetin e Pikave Antikorrupsion. DPAK dhe ASPA kanë koordinuar procesin dhe bashkërenduar tematikat e ofruara për këto subjekte dhe anëtare të këtij rrjeti. E-Albania ofron 1,266 shërbime publike online, dhe të gjitha autoritetet publike (367 autoritete) kanë caktuar koordinator për të drejtën e Informimit. Është instaluar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve në 25 autoritete të reja dhe në total janë 272 autoritete me këtë mekanizëm. Është hartuar “*Manuali shpjegues të së drejtës për informim*”, menduar në formën e pyetje-përgjigjeve ku jepet informacion lehtësisht i kuptueshëm dhe më gjuhë më të thjeshtë i procedurave dhe të drejtës për aksesin në informacion. Janë audituar deklaratat e pasurisë nga subjektet deklaruese (655 subjekte). Janë ngritur dhe funksionojnë 185 Njësi Përgjegjëse në sektorin publik dhe 526 Njësi Përgjegjëse në sektorin privat. Është kryer vlerësimi i riskut të integritetit dhe janë analizuar faktorët e riskut dhe hartuar Plani i Integritetit në ASHK. Ka përfunduar vlerësimi dhe është rishikuar programi i lëndës “Qytetaria” për klasën e 6 dhe të 10-të, duke përfshirë njohuri dhe tematika për sjelljen qytetare dhe njohuri për ligjin dhe është përmirësuar bashkëpunimi mes autoriteteve publike me sektorin privat.

Realizimi i mirë dhe i kënaqshëm i treguesve të performancës për objektivat 1.1-1.9⁵⁵, dëshmon një progres të mbajtur në përmbushjen e objektivit *gjatë periudhës janar - dhjetor 2025*, në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e qeverisjes së mire dhe të mekanizmave parandalues.


⁵⁵ Duke përjashtuar objektivin 1.3.

Politika Ndëshkuese (II) - Përmbledhje për arritjet në ndëshkimin e korrupsionit

Përmes **qëllimit të politikës ndëshkuese** SNKK, ka për qëllim që institucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qëllimet e Politikës	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ⁵⁶	Masa dhe aktivitete të parealizuara ⁵⁷
Ndëshkuese (II)	Masa	10	7	3	0
	Aktivitete	31	25	2	4

Rezulton se nga 10 masa dhe 31 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 – 2026, për vitin 2025, për Politikën Ndëshkuese janë zbatuar plotësisht 7 masa dhe 25 aktivitete, pjesërisht 3 masa dhe 2 aktivitete si dhe pazbatuar vetëm 4 aktivitete (aktivitetet: 2.1.2.1, 2.1.3.1, 2.2.1.1 dhe 2.2.3.2)




Nga 5 treguesit e performances për Politikën Ndëshkuese (II), është arritur vlera e synuar për 2 tregues performace, për 2 janë realizuar vetëm pjesërisht dhe për 1 tjetër (treguesi 2.2.3) nuk është arritur.

⁵⁶ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁵⁷ Aktivitet "i parealizuara" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.

Ndëshkuese (II)	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ⁵⁸	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ⁵⁹	Vlera e synuar nuk është e realizuar ⁶⁰
	5	2	2	1



2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

2.1.1: Përqindja e analizave në vijim të hetimeve administrative me qëllim marrjen e masave sistematike kundër korrupsionit (në rritje).

Plani i veprimit për Objektivin 2.1, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 7 aktivitete dhe 3 masa.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 2.1.1 për vitin 2025 është: Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera.

⁵⁸ Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

⁵⁹ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁶⁰ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna.

Për të arritur vlerën e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (7) dhe masa (3) si më poshtë.

2.1.1	Forcimi i kuadrit institucional dhe koordinimit për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit
2.1.1.2	Përgatitja e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit; rregullat për veprimtarinë operacionale të koordinatorëve të rrjetit kundër korrupsionit dhe vlerësimin e riskut të korrupsionit
2.1.1.3	Përmirësim i bashkëpunimit midis koordinatorëve kundër korrupsionit, pikave të kontaktit antikorrupsion dhe koordinatorëve të integritetit, në lidhje me marrjen dhe raportimin e rasteve të korrupsionit në administratën publike (takime periodike, shkëmbim informacioni)
2.1.2	Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin e verifikimin administrativ të korrupsionit
2.1.2.1	Identifikimi i nevojës (raport vlerësimi) për ekspertizë dhe aftësi të shtuara të koordinatorëve kundër korrupsionit dhe përgatitja e kurrikulave specifike për trajnime (vjetore)
2.1.2.2	Organizimi i trajnimeve për rritjen e ekspertizës dhe aftësive të koordinatorëve kundër korrupsionit
2.1.3	Rritja e performancës së strukturave përgjegjëse për hetimin e verifikimin administrativ të korrupsionit
2.1.3.1	Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit dhe koordinimit mes DPAK dhe ILDKPKI për denoncimet dhe raportimet e korrupsionit, veçanërisht për raste që vijnë nga njësitë e sinjalizimit
2.1.3.2	Zyrtarizimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese me qëllim hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit (marrëveshje bashkëpunimi)
2.1.3.3	Kryerja e analizës për zbatueshmërinë e rekomandimeve të dërguara nga DPAK tek institucionet ku janë konstatuar parregullsi

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit 2025 referuar përgatitja e akteve të brendshme rregullatore të saj (rregullore) dhe forcimit të kapaciteteve të drejtorisë dhe kryerjes së aktivitetit të saj.

Gjatë janar – dhjetor 2025, u hartua dhe finalizua rregullorja e brendshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, një akt i cili normon aktivitetin dhe funksionimin e strukturës teknike të saj. DPAK organizohet dhe funksionon sipas parimit të ligjshmërisë, unitetit dhe hierarkisë, llogaridhënies, integritetit, paanshmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit, pavarësisë profesionale si dhe bashkëpunimit të brendshëm institucional dhe ndërinstitucional. Rregullorja e Brendshme, u miratua me urdhër të Ministrit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, nr. 3, datë 4.06.2025, dhe gjendet në link: www.antikorrupsioni.gov.al/kreu/lista-dokumente/.

Rregullorja e Brendshme, është akti i parë zyrtar për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, që prej krijimit të saj si autoritet më vehte publik, buxhetor, dhe që parashikon me detaje veprimtarinë e dy drejtorive teknike të saj (Drejtoria e Zbatimit të Politikave në Fushën e Antikorrupsionit dhe Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimit Administrativ) dhe të Sektorit i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Rregullorja parashikon edhe mënyrat e veprimtarisë së DPAK me mekanizmin e Koordinatorit Kundër Korrupsionit, me të cilin ushtrohet kompetenca e verifikimit dhe hetimit administrativ. Kreu IV (neni 27 – neni 52) dhe kreu V (neni 53 – 68) parashikojnë specifikisht këtë pjesë të veprimtarisë së DPAK.

Në vitin 2025 janë zhvilluar takime të rregullta pune në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit me koordinatorët dhe strukturat me kompetenca antikorrupsioni në autoritetet ku është i vendosur Koordinatori Antikorrupsion. Takime dhe shkëmbim problematikash janë adresuar ndaj të gjitha institucioneve ku shërbimi ndaj qytetarëve mbetet shqetësim dhe bërë të njohura në buletinët mujorë “Antikorrupsioni” të DPAK.

Stafi teknik i DPAK që merret me hetimin dhe verifikimin administrativ si dhe Koordinatorët Antikorrupsion kanë qenë pjesë e sesionit të trajnimit dhe marrjes së njohurive për metodologjinë e vlerësimit të riskut të korrupsionit dhe pjesë e kurrikulës “Hapat e vlerësimit të riskut të korrupsionit”, zhvilluar në 6 maj 2025. Gjithashtu, janë kryer vlerësime për sigurimin e sesioneve për forcimin e kapaciteteve profesionale të koordinatorëve dhe pikave të kontaktit antikorrupsion. ASPA ka zhvilluar në vitin 2025, dy trajnime tematike, të fokusuara në zbatimin e politikave të antikorrupsionit dhe të konfliktit të interesit, si dhe në forcimin e kulturës së integritetit dhe mekanizmave të antikorrupsionit. Trajnimet janë organizuar me audiencë koordinatorët dhe pikat e kontaktit antikorrupsion dhe kanë synuar rritjen e njohurive praktike dhe aftësive të tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse. Në këto aktivitete trajnuese kanë marrë pjesë gjithsej 41 pjesëmarrës.

Por, mbetet për tu evidentuar që nuk ka ende një raport vlerësimi për ekspertizë dhe aftësi të shtuara të koordinatorëve kundër korrupsionit dhe përgatitja e kurrikulave specifike për trajnime (vjetore) (aktiviteti 2.1.2.1).

Në vitin 2025, janë ndërmarrë masa për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe koordinimi ndërinstytucional midis autoriteteve me kompetenca të luftës kundër korrupsionit dhe që kanë kontakte me qytetarët. DPAK ka kryer ndëveprime aktiv kryesisht me ato institucione ku ndodhen koordinatorët antikorrupsion për raste për të cilat janë proceduar kërkesa për verifikim dhe hetime administrative.

Gjithashtu, në shkurt 2025, Prokuroria e Posaçme ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim garantimin e integritetit të procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025. Marrëveshja synon koordinimin e masave për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen penale të veprave që lidhen me procesin zgjedhor, duke kontribuar në forcimin e integritetit dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor dhe në luftën kundër korrupsionit.

DPAK ka finalizuar në një Raport Vlerësimi për vitin 2025, në të cilin evidentohen të gjitha masat dhe rekomandimet dhe statusi i zbatimit të tyre. Pjesë thelbësore e këtij raporti rekomandimesh janë masat dhe kërkesa për ndërhyrje në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, një analize dhe përmbledhje e të gjitha problematikave të cilat janë konstatuar gjatë hetimeve administrative me qëllim përmirësimin e procedurave konkrete, përditësimin e akteve rregullatore dhe përmirësimin e bashkëpunimit institucional apo ndërinstytucional.

DPAK ka adresuar rekomandime për Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në total 60 raporte i referohen gjetjeve të verifikimeve dhe hetimeve administrative ndaj këtij institucioni nisur nga numri i madh i ankesave marrë për çështje të pronësisë). Drejtorinë e

Përgjithshme të Doganave, Agjencinë Kombëtare për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, kryesisht, mbështetur në analizën e plotë të fakteve dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e shkeljes së konstatuar, ndikimin që ajo ka sjellë në mirëfunksionimin e institucionit përkatës, si dhe shkallën e përgjegjësisë individuale të punonjësve. DPAK ka përfunduar për vitin 2025, 71 raporte përfundimtare vlerësimi, dhe anë propozuar 207 masa administrative dhe 234 rekomandime. 32 raste janë përcjellë për kompetencë, si dhe 336 raste janë përgatitur memo arkivimi dhe/apo kthim përgjigje për të cilat nuk gjendet raste të procedimit administrative. Janë depozituar 2 kallëzime penale.

Në vitin 2025, nuk janë shënuar raste shkëmbimi informacioni midis DPAK dhe ILDKPKI për denoncimet dhe raportimet e korrupsionit, veçanërisht për raste që vijnë nga njësitë e sinjalizimit (aktiviteti 2.1.3.1).

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.1.1. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka kryer dhe përfunduar së verifikuari dhe hetuari 439 raste, për të cilat referohen: 71 raporte përfundimtare ku janë propozuar 207 masa administrative dhe 234 rekomandime; 32 raste janë përcjellë për kompetencë, si dhe 336 raste janë përgatitur memo arkivimi dhe/apo kthim përgjigje për të cilat nuk gjendet raste të procedimit administrative. Janë 2 rastet për të cilat janë depozituar kallëzim penale pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i Detyrës”. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve 2.1.1 sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2026	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2027	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2028	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2029	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	2030	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
	viti 2025 (targeti i synuar)	Koordinim dhe verifikime të plota të denoncimeve të marra për korrupsionit, analiza të kryera
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 4 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 2.1

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.1. Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 **është 100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat dhe informacionet e përfshira në këtë raport, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 2.1 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.1

Për vitin 2025, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar kryerjen e analizës që do të udhëheqë edhe masat për veprim dhe bashkëpunim në vitet në vijim të zbatimit të planit të veprimit antikorrupsion.

2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

2.2.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për hetimin penal të korrupsionit nga ato të planifikuara për tu miratuar.

2.2.2: Raporti i hetimeve penale të përfunduara për korrupsion nga hetimet ende në vijim (zvogëlimi i backlogut) (trend rritës).

2.2.3: Përqindja e vlerës së pasurive të sekuestruara si rezultat i hetimit të rasteve të korrupsionit nga vlera mesatare e pasurive të sekuestruara në tre vitet e fundit (trend rritës).

Plani i veprimit për Objektivin 2.2, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 20 aktivitete dhe 4 masa.

2.2.1: Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për hetimin penal të korrupsionit nga ato të planifikuara për tu miratuar.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 2.2.1 për vitin 2025 është: Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktiviteti (4) dhe masa (1) si më poshtë.

2.2.1	Forcimi i kornizës legjislative për garantimin e një veprimtarie eficiente për hetimin e ndëshkimit penal të korrupsionit
-------	---

2.2.1.1	Dokument (analizë) vlerësimi për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e hetimit penal, duke adresuar kërkesat dhe rekomandimet e BE
2.2.1.2	Identifikimi i ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë nevojë për përmirësim, planifikimi i tyre për miratim
2.2.1.5	Zhvillimi i procedurave standarde operative për identifikimin e pasurive dhe burimeve financiare të të dyshuarve për korrupsion dhe palëve të lidhura me to gjatë hetimit (Procedurat Standarde të ZRA), të miratuara
2.2.1.7	Miratimi i udhëzimeve të përgjithshme për hetimin financiar duke rritur fushëveprimin e hetimit financiar të SPAK, duke evidentuar si pjesë të posaçme të kompetencave hetimore në luftën kundër korrupsionit (në relevancë me parashikimin e kreu II:lufta kundër korrupsionit, pjesa 3 (hetimi penal dhe dënimi) të Udhërrëfyesit Shteti i së Drejtës). (Shënim: ky aktivitet është në relevancë të plotë zbatimi me parashikimet e bëra në PV të SND)

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuar për zbatim përgjatë periudhës, siç përmendet përgatitja e akteve paraprake (analiza vlerësimi) për hartimin dhe miratimin të kuadrit ligjor, si edhe aktet rregullatore të organizimit dhe funksionimit të ZRA dhe udhëzime operacionale për Prokurorinë e Posaçme.

Gjatë janar – dhjetor 2025, janë ndërmarrë veprime që lidhen me vlerësimin e zbatueshmërisë së kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e hetimit penal, si dhe me identifikimin e nevojave për përmirësimin e tij, në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe të angazhimeve përmendur në udhërrëfyesin “Për Shtetin e së Drejtës” kapitulli 23 e 24.

Më konkretisht, ka vijuar hartimi dhe miratimi i akteve dhe masave me ndikim në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor të fushës që prek hetimin e ndëshkimit penal të korrupsionit. Konkretisht, me Urdhrin nr. 27061, datë 4.08.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka miratuar “Strategjinë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura 2025-2027”, me qëllim rritjen e eficiencës së hetimeve dhe përmirësimin e menaxhimit të çështjeve. Me Udhëzimin⁶¹ e Përgjithshëm nr. 1093, datë 11.11.2024, janë përcaktuar masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror nga SPAK. Ky dokument pune përcakton, standardizon dhe unifikon mënyrën procedurale të hetimit financiar dhe pasuror të çështjeve, nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të hetimit. Miratimi i një akti të tillë plotëson gjithashtu një angazhim të Udhërrëfyesit “Për Shtetin e së Drejtës” në kuadër të Kapitullit 23 (Lufta Kundër Korrupsionit: (3) Zbatimi i ligjit – Hetimi penal dhe dënimi). Vendimi nr. 231, datë 17.4.2025, janë miratuar Rekomandimet Prioritare në Luftën Kundër Kriminalitetit për vitin 2025, të cilat shërbejnë si instrument orientues për institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, në kuadër të planifikimit afatmesëm dhe në zbatim të angazhimeve strategjike, ka vijuar puna për hartimin e Kodit të ri Penal, si dhe Kodin i Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë.

Paralelisht, Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të procesit të integritetit evropian ka përbushur detyrimet lidhur me pjesëmarrjen në shqyrtimin analitik të legjislacionit, procesin e *screening*-ut, raportimet për Kapitujt 4, 23 dhe 24, si dhe raportimin në MONEYVAL. Kodi i ri Penal përbën

⁶¹ I publikuar në link: <https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Udhezim-i-pergjithshem-nr-1093-date-11.11.2024-Masat-administrative-dhe-procedurale-per-kryerjen-e-hetimit-financiar-dhe-pasuror-ne-strukturen-e-Posacme-Kunder-Korrupsionit-dhe-Krimit-te-Organizuar.pdf>.

një prej akteve në proces diskutimi të tryezave konsultative ndërinstitucionale, me fokus veprat penale të korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimeve të tjera ekonomike dhe financiare, si dhe veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore dhe pasurisë. Janë dhënë mendime dhe sugjerime për përmirësimin e dispozitave përkatëse, në funksion të forcimit të kuadrit ligjor penal dhe përafrimit të tij me standardet evropiane.

Për vitin 2025, nuk është zhvilluar një dokument i detajuar vlerësimi për zbatueshmërinë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e hetimit penal, duke adresuar kërkesat dhe rekomandimet e BE, duke i qëndruar atij dokumenti të bërë pjesë e raportimit *screening* dhe që ka mbështetur propozimet e udhërrëfyesit “Shteti i së Drejtës” për kapitujt 23 e 24, dhe të akteve ligjore dhe nënligjore listuar në të.

Në këtë vit janë kryer zhvillime të rëndësishme në drejtim të forcimit të kapaciteteve hetimore dhe të ndjekjes së pasurive me origjinë të paligjshme ku përmendet miratimi i aktit nënligjor, udhëzimi nr. 203, datë 27.11.2025, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”. Udhëzimi i miratuar vjen në kuadër edhe me agjendën e reformave dhe rregullon procesin e përzgjedhjes së Drejtorit të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve. Kjo zyrë është nën varësinë e Policisë së Shtetit, me fokus gjurmimin dhe identifikimin e pasurive të paligjshme, duke siguruar pavarësi operationale dhe ekspertizë të lartë. ZRA është një njësi e specializuar, të lehtësuar procesin e gjurmimit e të identifikimit, si dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të rikuperimit të asetëve dhe në përputhje me standardet e BE-së për rikuperimin e asetëve.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.2.1. Miratimi i ligjit për Zyrën e Rekuperimit të Aseteve dhe për të siguruar përafrimin me *acquis të BE-së* për fushën, si edhe dhe akti nënligjor në zbatim të tij, udhëzimi nr. 203, datë 27.11.2025, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve”; është miratuar kuadri nënligjor në fushën penale, përmendet: VKM nr.231, datë 17.4.2025, për miratimin e Rekomandimeve Prioritare në Luftën Kundër Kriminalitetit për vitin 2025, dokument i cili përbën një instrument të rëndësishëm orientues për institucionet përgjegjëse në këtë fushë; Urdhri nr. 27061, datë 4.08.2025, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka miratuar “Strategjinë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura 2025-2027”, e cila synon rritjen e eficiencës së hetimeve dhe përmirësimin e menaxhimit të çështjeve dhe Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 1093, datë 11.11.2024, miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ku janë përcaktuar masat administrative dhe proceduriale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror nga SPAK. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2026	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara

	2027	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2028	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2029	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	2030	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	Ligje dhe akte nënligjore të planifikuara për t'u miratuar dhe të miratuara
	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

2.2.2: Raporti i hetimeve penale të përfunduara për korrupsion nga hetimet ende në vijim (zvogëlimi i backlogut) (trend rritës).

Vlera e synuar për treguesin e performancës 2.2.2 për vitin 2025 është: Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (backlog i ulur).

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (16) dhe masat (3) si më poshtë.

2.2.2	Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale të organeve ligjzbatuese dhe stafeve pranë tyre, me fokus hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit
2.2.2.1	Konsolidimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i burimeve tekniko-profesionale të seksioneve të krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave në strukturën qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe në drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit
2.2.2.2	Identifikimi i nevojave për njohuri teknike (trajnime) për stafet dhe profesionistët e organeve të hetimit dhe ndjekjes penale (prokuroritë) dhe të gjyqimit (gjyqësorit) (Raport për kërkesa për trajnime, i miratuar) /vjetor
2.2.2.3	Trajnimi i vazhdueshëm/vjetor i punonjësve të policisë mbi hetimet proaktive, për veprat penale në fushën e korrupsionit, krimeve ekonomike e financiare, të pastrimit të parave dhe aseteve kriminale (trajnime të kryera)
2.2.2.4	Trajnime të specializuara me pjesëmarrje ndërinstucionale (agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit) për të siguruar veprimtari proaktive mbi hetimin financiar, ndjekjen penale dhe gjykimin e korrupsionit në tema si: prokurimi publik, partneriteti publik-privat, koncesionet, pronësia përfituese, pastrimi i parave, etj.
2.2.3	Konsolidimi i qendrueshëm i strukturave të agjencive ligjzbatuese për të siguruar hetime proaktive kundër korrupsionit (përmirësim i performancës)
2.2.3.1	Identifikimi i nevojave për ekspertizë teknike për stafet dhe profesionistët e organeve të hetimit dhe ndjekjes penale (prokuroritë) dhe të gjyqimit (gjyqësorit) (Plan i miratuar për ekspertizë dhe rritje performance) (vjetor)
2.2.3.2	Konsolidimi dhe forcimi i vazhdueshëm i seksioneve të krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave në strukturën qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe në drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit (burime njerëzore dhe tekniko-profesionale të përgatitura dhe efektive)

2.2.3.3	Planifikimi i mekanizmave për ngritjen e infrastrukturës digjitale për sistemin e menaxhimit të çështjeve të SPAK, duke evidentuar hapat e ngritjes së tij brenda vitit 2024 (I); ngritjen dhe testimin brenda vitit 2025 (II); përdorimin e sistemit brenda vitit 2026 (III). (në relevancë me parashikimin e kreut II:lufta kundër korrupsionit, pjesa 3 (hetimi penal dhe dënimi) të Udhërrëfyesit Shteti i së Drejtës) (Shënim: ky aktivitet është në relevancë të plotë zbatimi me parashikimet e bëra në PV të SND). (Shënim: ky aktivitet është në relevancë të plotë zbatimi me parashikimet e bëra në PV të SND)
2.2.3.4	Rritje e ekspertizës hetimore të SPAK duke bërë të mundur aksesin e nevojshëm në bazat e të dhënave shtetërore, në përdorim (baza të dhënash të marra në përdorim)
2.2.3.5	Forcimi i kapaciteteve hetimore të SPAK në përdorimin e bazave të të dhënave shtetërore, të marra në përdorim (trajtime dhe njohuri të shtuara për to)
2.2.3.6	Ngritja e seksionit të përgjimit parandalues në funksion të veprimtarisë së informimit, njësi vlerësimi risku dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në BKH
2.2.3.7	Ngritja dhe organizimi i Zyrës së Rekuperimit të Aseteve (ZRA) pranë Policisë së Shtetit
2.2.3.8	Organizimi dhe vënia në funksion të plotë të njërive (strukturave të brendshme institucionale) që do të bashkëpunojnë me ZRA, në MD dhe pranë prokurorive
2.2.4	Rritja e performancës të agjencive ligjzbatuese të hetimit penal të korrupsionit nëpërmjet bashkëpunimit institucional, komunikimit me publikun dhe administrimit të informacionit statistikor
2.2.4.1	Forcimi i qasjes proaktive në zbulimin e korrupsionit duke përdorur raportet e mediave, analizën e raporteve të auditimit, gjetjet e inspektimeve dhe bashkëpunimin me koordinatorët kundër korrupsionit (raste hetimesh inicuar kryesisht)
2.2.4.2	Veprime në zbulimin e korrupsionit, në bazë të deklaratave të pasurisë dhe kontrollit të tyre
2.2.4.3	Konsolidimi i të dhënave statistikore për veprat penale të korrupsionit nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të e-platformës
2.2.4.4	Hartimi i tipologjive dhe treguesve për rastet e korrupsionit, të konstatuara nga institucionet gjatë trajtimit të rasteve sipas fushave përkatëse të përgjegjësive

Realizimi i masave së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuar përgjatë periudhës dhe në vijim të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, strukturat e hetimit të krimit ekonomik dhe financiar në Policinë e Shtetit nuk kanë pësuar ndryshime dhe ndërhyrje dhe vijon të funksionojë me kapacitetet tekniko-profesionale të deklaruara në vitin e mëparshëm (pjesë e Drejtorisë së Hetimit të Krimeve Ekonomike e Financiare është Sektori për Hetimin e Pastrimit të Parave dhe Aseteve kriminale, me 8 punonjës gjithsej. Një seksion i veçantë i tij, për rekuperimin e asetave vijon të jetë vetëm në DVP Tiranë.

Shkolla e Magjistraturës ka të përgatitur një raport për nevoja për forcim kapacitetesh të ekspertëve dhe profesionistëve teknike që merren me hetimin dhe ndjekjen penale, dhe mbi bazë të të cilit planifikohen dhe ofrohen sesionet e trajnimeve për subjektet (gjyqtarë dhe prokurorë) që ndjekin dhe ushtrojnë hetimin penal.

Sa i takon trajnimin të vazhdueshëm/vjetor të punonjësve të Policisë së Shtetit mbi hetimet proaktive për veprat penale në fushën e korrupsionit, krimet ekonomike dhe financiare, pastrimit të parave dhe aseteve kriminale, gjatë vitit 2025 ka vijuar ofrimi i sesioneve për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore me qëllim ruajtjen e konsistencës së Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Financiare me sektorin e hetimit e pastrimit të parave dhe aseteve kriminale (për të 8 punonjësit). Strukturat e kësaj drejtorie kanë marrë pjesë në 32 trajnime, nga të cilat kanë përfituar gjithsej 458 punonjës policie. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, dinamika e trajnimeve gjatë vitit 2025 paraqet rritje të ndjeshme, konkretisht janë zhvilluar 25 trajnime më shumë dhe kanë përfituar 398 punonjës policie më shumë, duke reflektuar forcimin e kapaciteteve profesionale dhe teknike në hetimin e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.

Po ashtu, në vitin 2025, stafe dhe punonjës të PSH kanë marrë pjesë në 14 trajnime me interes të drejtpërdrejtë për hetimin e pastrimit të parasë, me 341 përfitues nga strukturat që kryejnë hetime pasurore. Ndër trajnimet që specialistët e Sektorit për Hetimin e Pastrimit të Parave dhe Aseteve Kriminale kanë marrë pjesë janë, përmenden sesionet: “Forcimi i përpjekjeve të rikuperimit të pasurive në rajonin e OSBE-së”, në datat 28-29 Janar 2025, 3 përfitues, ose 2 përfitues nga Pastrimi i Parave, ofruar nga OSBE; “Procesi i vlerësimit të raundit të 6-të të vlerësimit nga Komiteti Moneyval”, 11-12 Mars 2025, në ambientet e pallatit të Kongreseve, ofruar nga AIF, me 4 përfitues nga strukturat e Policisë së Shtetit (të gjithë nga DHKEF) dhe me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve kombëtare të përfshira në këtë vlerësim; “Për përdorimin e sistemit të Menaxhimit të Informacionit Policor”, në datat 25-26 Mars 2025, në ambientet e Akademisë së Sigurisë, me 1 përfitues nga strukturat e PP&AK, ose 18 përfitues nga Policia e Shtetit; “Hetimi financiar”, ofruar nga EU4FAST, zhvilluar në Tiranë, me datë 20-22 Maj 2025, me 20 përfitues nga strukturat që merren me Pastrimin e Parave; Workshop me datë 27 Maj 2025, në Tiranë, mbi Kapitullin 4, me pjesëmarrjen e pikave të kontaktit (2 pika kontakti); “Program inovativ për zhvillimin e kapaciteteve, punën në ekip dhe krijimin e ndikimit social”, organizuar nga AAPSK në bashkëpunim me UNICEF, zhvilluar në Tiranë, në datat 16-18 Qershor 2025, me 4 përfitues; “Analiza sektoriale në fushën e krimeve financiare”, ofruar nga OSBE, zhvilluar në ambientet e DPPSH, në datat 17-19 Qershor 2025, me 11 përfitues (8 nga DHKEF dhe 3 përfitues nga Drejtoria e Antiterrorit); “Hetimi i pasurimit të parave nëpërmjet kriptomonedhave”, ofruar nga OSBE në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse të Policisë Italiane dhe Zyrën e Menaxherit Rajonal të Guardia di Finanza për Ballkanin Jugperëndimor në Ambasadën Italiane, në Tiranë, zhvilluar në “Mak Albania”, në Tiranë, më 23-24 Qershor 2025, me pjesëmarrje ndër-institucionale, me 7 përfitues (4 DHKEF dhe 3 DHK Kibernetik); “Rritja e sigurisë së gazetarëve”, ofruar nga Këshilli i Evropës, në ambientet e hotel “Moxart”, në Shkodër, në datat 25-26 Qershor 2025, me 1 përfitues nga DPK; “Darknet dhe kriptomonedha të aplikuara në Pastrimin e Parave dhe financimin e terrorizmit”, organizuar nga Projekti EU4LEA2, zhvilluar në Tiranë, në datat 7-8 Korrik 2025, me 4 përfitues nga këtë 2 persona nga sektori i PP; “Darknet dhe kriptomonedha të aplikuara në Pastrimin e Parave dhe financimin e terrorizmit”, organizuar nga Projekti EU4LEA2, zhvilluar në Tiranë, në datat 9-10 Korrik 2025, me 20 përfitues nga strukturat qendrore dhe vendore të PP; “Rikuperimi i Aseteve”, ofruar nga UNODC, zhvilluar në Tiranë, në datat 22-23 Korrik 2025, me 6 përfitues (1 prej tyre nga Sketori i PP); “Strategjitë ekonomike dhe financiare për të targetuar asetet kriminale për të ulur krimin e organizuar”, ofruar nga Guardia di Finanza në bashkëpunim me Shkollën Financiare të Policisë në Ostia Itali, 19 pjesëmarrës; “Politikat ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit”, ofruar nga Guardia di Finanza në bashkëpunim me Shkollën

Financiare të Policisë në Ostia Itali, 19 pjesëmarrës; “Projekti Global i Tatimeve dhe Krimit – Trajnim bazik”, ofruar nga Guardia di Finanza në bashkëpunim me Shkollën Financiare të Policisë në Ostia Itali, 22 pjesëmarrës; “Planifikimi për menaxhimin efektiv të aseteve: për tu konsideruar përpara sekuestrimit”, ofruar nga Programi Rajonal EU4FATS, në bashkëpunim me rrjetin Ndërinstitucional për Menaxhimin e Aseteve në ballkan (BAMIN), 1 pjesëmarrës, 24-25 shtator 2025; “Mbi pastrimin e parave, luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar”, zhvilluar në datat 29-30 Tetor 2025, ofruar nga OSBE, 2 përfitues; “Interpol Cooperation Against Ndragheta (I-CAN), organizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Interpol, me dt. 18-19 Nëntor 2025, në Lion, Francë, me 2 pjesëmarrës; “Analiza e avancuar financiare për Byronë Kombëtare të Hetimit dhe Policinë e Shtetit”, organizuar nga PSBE, me dt. 17-21 Nëntor 2025, në ambientet e DPPSH, me 5 pjesëmarrës dhe “Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, ofruar nga Policia Turke, në datat 15-19 dhjetor 2025, në Akademinë e Sigurisë, Tiranë, me 20 përfitues.

Gjithashtu, nga Shkolla e Magjistraturës, ndër sesionet e organizuara përmendim, ato⁶²: (1) mbi zbatimin e Jurisprudencës së GJEDNJ-së për çështjet e korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit⁶³, i ndjekur nga 74 persona. (2) modul korrupsioni mbi “Parashikimet ligjore lidhur me veprën penale të korrupsionit. Historiku i rregullimit ligjor dhe ndryshimet ligjore ndër vite. Parashikimet ndërkombëtare mbi korrupsionin dhe zbatimin e Konventave të detyrueshme. Veprat penale të korrupsionit në Kodin Penal⁶⁴, i ndjekur nga 20 persona. (3) modul korrupsioni mbi “Individualizimi i figurave të veprës penale të korrupsionit. Tipizimi i korrupsionit aktiv, ndërmjetësisht për korrupsion dhe korrupsionit. Përcaktimi i përgjegjësive penale të ndërmjetësit korruptiv. Fusha e zbatimit të nenit 245/1 në raport me figurat e posaçme të veprave penale të korrupsionit. Veprimet hetimore dhe mjetet e posaçme të kërkimit të provës në veprat penale të korrupsionit⁶⁵, i ndjekur nga 19 persona. (4) modul korrupsioni mbi “Kuptimi dhe zbatimin e bashkëpunimit në rastet e korrupsionit. Praktika gjyqësore. Korrupsioni dhe bashkëpunimi me krimin e organizuar⁶⁶, i ndjekur nga 13 persona. (5) modul korrupsioni mbi “Korrupsioni, shpërdorimi i detyrës, shkelja e barazisë në prokurime, marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale duke shpërdoruar detyrën, kufijtë ndarës dhe dallimet e këtyre veprave penale. Kompetenca lëndore e prokurorisë dhe gjykatës për hetimin, gjykimin dhe ekzekutimin e dënimeve penale të korrupsionit⁶⁷, i ndjekur nga 27 persona. (6) modul korrupsioni mbi “Korrupsioni, dënimet plotësuese dhe ekzekutimi i tyre. Procedimi pasuror për veprat penale të korrupsionit⁶⁸ i ndjekur nga 3 persona. (7) Trajnimi me temë: “Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik si vepër penale⁶⁹, organizuar në bashkëpunim me OSBE, i ndjekur nga 34 persona. (8) Modul “Pastrimi i Parave”, trajnimi me temë “Veprat penale në fushën e tatimeve dhe evazioni fiskal. Pastrimi i parave, detyrimet ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Koncepti i rikuperimit të produkteve të veprës penale⁷⁰, i ndjekur nga 25

⁶² 310 pjesëmarrës përfitues.

⁶³ 24 – 25 shkurt 2025.

⁶⁴ 10 mars 2025.

⁶⁵ 11 mars 2025

⁶⁶ 17 mars 2025.

⁶⁷ 18 mars 2025.

⁶⁸ 3 mars 2025.

⁶⁹ 4 prill 2025.

⁷⁰ 12 maj 2025.

persona, (9) Modul “Pastrimi i Parave”, trajnimi me temë “Figurat e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale të parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal. Vështrim krahasimor me dispozitat analoge të vendeve të tjera. Raste të praktikës gjyqësore”⁷¹, i ndjekur nga 19 persona. (10) Modul “Pastrimi i Parave”, trajnimi me temë “Hetimi i veprës penale të pastrimit të parave dhe kompleksiteti i tij. Niveli i provueshmërisë përpara gjykatës lidhur me origjinën e pasurisë. Vlera e aktit të ekspertimit kontabël dhe kujdesi që duhet të tregohet në caktimin e detyrave të ekspertit”⁷², organizuar në bashkëpunim me OSBE, i ndjekur nga 46 persona. (11) Modul “Pastrimi i parave, trajnimi me temë: “Ligji antimafia. Zbatimi i tij në praktikë dhe lidhja midis hetimit pasuror dhe procedimit penal të pastrimit të parave”⁷³, organizuar në bashkëpunim me OSBE, i ndjekur nga 28 persona. (12) Modul korrupsioni mbi “Korrupsioni dhe prokurimi publik; Palët që mund të përfshihen në veprime korruptive aktive ose pasive dhe metodat për hetim dhe gjykim në këto raste”⁷⁴ i ndjekur nga 17 persona. (13) Modul “Pastrimi i parave, me temë “Parashikimet ndërkombëtare lidhur me konfiskimin e produkteve të veprës penale. Rëndësia e konfiskimit në luftën kundër pastrimit të parave. Ndihma ndërkombëtare në dispozicion kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”⁷⁵, i ndjekur nga 18 persona. (14) Modul korrupsioni mbi “Korrupsioni i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor”⁷⁶, i ndjekur nga 9 persona. (15) modul korrupsioni mbi “Kudri global dhe evropian për luftën kundër korrupsionit”⁷⁷, i ndjekur nga 32 persona. Referuar pjesëmarrjes në trajnimeve të shtuara dhe të vazhdueshme për fushën specifike për efektive të strukturave të policisë për këtë periudhë janë zhvilluar gjithsej 15 seminare, trajnime dhe workshope, me pjesëmarrje të 112 punonjes (79 meshkuj e 35 femra). Gjithashtu përmendet pjesëmarrja në: Projekti i rikuperimit të pasurive me rajonin, nga 4 punonjës dhe, Hetimi financiar paralel me hetimin penal të veprave penale që gjenerojnë të ardhura kriminale, nga 71 punonjës. Dy trajnime të specializuara me tematikë “Hetimi financiar pro-aktiv i rasteve komplekse të pastrimit të parave”^{78,79}, ku trajnimi i parë, i zhvilluar më 14 nëntor 2025, u ndoq nga 21 gjyqtarë, 40 prokurorë dhe 18 oficerë të policisë gjyqësore, ndërsa trajnimi i dytë, i zhvilluar më 15 dhjetor 2025, u ndoq nga 4 gjyqtarë, 23 prokurorë, 21 oficerë të policisë gjyqësore dhe 2 hetues të BKH-së, duke reflektuar një qasje të integruar ndërinstitucionale në trajtimin e çështjeve financiare komplekse.

Paralelisht, SPAK raporton se gjatë vitit 2025, vetëm në fushën e hetimit financiar, prokurorët e posaçëm, hetuesit e BKH-së dhe hetuesit financiarë kanë marrë pjesë në 16 trajnime të specializuara, të organizuara nga agjenci vendase dhe të huaja të zbatimit të ligjit, me fokus rritjen e kapaciteteve hetimore dhe forcimin e bashkëpunimit profesional në trajtimin e veprave penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), gjatë vitit 2025 janë zhvilluar aktivitete trajnuese të specializuara, ku ndër to përmenden

⁷¹ 13 maj 2025.

⁷² 19 maj 2025.

⁷³ 20 maj 2025.

⁷⁴ 23 maj 2025.

⁷⁵ 26 maj 2025.

⁷⁶ 11 qershor 2025.

⁷⁷ 20 qershor 2025.

⁷⁸ 14 nëntor 2025

⁷⁹ 15 dhjetor 2025

si vijon: (1) Trajnimi i specializuar mbi “Hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që lidhen me asetet kripto”⁸⁰, i ndjekur nga trupa gjyqësore e GJKKO-së, i organizuar nga Projekti i Drejtësisë Penale në Ballkanin Perëndimor (WBCJ), në bashkëpunim me Rrjetin Gjyqësor Evropian për Krimin Kibernetik (EJCN), me fokus hetimin dhe trajtimin penal të veprave që përfshijnë kriptovaluta dhe asete digjitale; (2) Pjesëmarrje e mëtejshme e disa gjyqtarëve të GJKKO-së në trajnime të specializuara mbi kriptovalutat, të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, përfshirë trajnime në Republikën Çeke, me qëllim rritjen e ekspertizës në trajtimin e çështjeve komplekse që lidhen me teknologjitë financiare bashkëkohore; (3) Trajnimi me temë “Prokurimi Publik”⁸¹, i ndjekur nga stafi drejtues dhe administrativ i GJKKO-së (Kancelari, Shefi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Marrëdhëniet me Publikun dhe Median, Shefi i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, Shefi i Sektorit të Protokoll/Arkivës, Shefi i Sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, si dhe Specialisti i IT-së), i organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike; (4) Trajnimi mbi ligjin nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar⁸², i ndjekur nga Specialisti i Statistikës dhe Specialisti i Prokurimeve, i organizuar nga PKF Albania SHPK, me fokus forcimin e njohurive në fushën e legjislacionit tregtar dhe zbatimit të tij në praktikë.

Lidhur me identifikimin e nevojave për ekspertizë teknike për stafet dhe profesionistët e organeve të hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimit, janë ndërmarrë masa të qëndrueshme për rritjen e cilësisë së ekspertizës dhe performancës profesionale. Më konkretisht, Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Këshillin Drejtues, ka vijuar një proces të strukturuar dhe rigoroz për përzgjedhjen e ekspertëve dhe lehtësuesve, duke u fokusuar kryesisht në magjistratë në detyrë, si dhe në profesionistë të tjerë të kualifikuar me përvojë akademike dhe aftësi pedagogjike të certifikuara. Ekspertët i janë nënshtruar një procesi të vazhdueshëm vlerësimi, i cili ka përfshirë seriozitetin në përmbushjen e angazhimeve, cilësinë e materialeve trajnuese, ndërveprimin me auditorin dhe vlerësimet anonime të pjesëmarrësve në përfundim të çdo aktiviteti. Në muajin prill 2025, Shkolla e Magjistraturës ka shpallur gjithashtu thirrjen për shprehje interesi për ekspertë dhe lehtësues për vitin akademik 2025–2026, në zbatim të programit tematik 3-vjeçar 2024–2027, ku është evidentuar një interes i lartë nga magjistratë dhe profesionistë ligjorë për tema dhe module të specializuara. Paralelisht, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar forcimin e kapaciteteve të brendshme përmes funksionimit të 7 seksioneve të posaçme pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, të dedikuara për hetimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin, krimin financiar dhe hetimet pasurore. Në prokuroritë me kapacitete më të kufizuara njerëzore janë caktuar prokurorë të dedikuar për këto kategori veprash. Në mbështetje të ekspertizës financiare dhe pasurore, me Urdhrin nr. 111, datë 5.11.2025, në Prokurorinë e Përgjithshme është emëruar një ekspert kontabël në funksionin e Drejtuesit të Sektorit të Ekspertizës. Gjatë vitit 2025, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar gjithashtu të sigurojë fonde shtesë për kryerjen e ekspertizave financiare në prokuroritë e shkallës së parë, duke garantuar mbështetje efektive për trajtimin e çështjeve komplekse penale.

Seksionet e krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave në strukturën qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe në drejtoritë vendore të Policisë së Shtetit nuk kanë pësuar ndërhyrje dhe ndryshime për vitin 2025, duke funksionuar me të njëjtat kapacitete.

⁸⁰ 05–06 nëntor 2025

⁸¹ 01–07 prill 2025

⁸² 20 nëntor 2025

Lidhur me planifikimin dhe ngritjen e infrastrukturës digjitale për sistemin e menaxhimit të çështjeve të SPAK, ka vijuar zbatimi i fazës së dytë të këtij procesi, në përputhje me parashikimet e Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës dhe Planit të Veprimit të SND. Më konkretisht, pilotimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve ka nisur në janar 2025, duke shënuar kalimin nga faza e planifikimit në fazën e zbatimit dhe testimit. Gjatë vitit, janë populluar me të dhëna funksionale modulet e përfunduara, ndërkohë që ka vijuar puna për zhvillimin e moduleve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025 është përfunduar moduli i referimit dhe i procedimeve pasurore, si dhe moduli i statistikave, i ndërtuar në përputhje me formatin zyrtar të raportimit për kallëzimet penale dhe evidencën e procedimeve penale. Këto module kanë synuar rritjen e standardizimit, gjurmueshmërisë dhe eficiencës në administrimin e çështjeve penale komplekse.

Është shënuar progres në rritjen e ekspertizës hetimore të SPAK me 31% të akteve në ekspertim në laboratorët e BKH dhe me analiza digjitale të thelluara. Gjithashtu, përmes zgjerimit të aksesit në bazat e të dhënave shtetërore. Më konkretisht, në vitin 2025 është siguruar akses në dy databaza shtesë të të dhënave shtetërore, duke e çuar numrin e përgjithshëm të bazave të të dhënave në përdorim në 22 aksese, përfshirë 3 sisteme të reja, duke përmirësuar shpejtësinë, sigurinë dhe eficiencën e proceseve hetimore⁸³. Ky zhvillim ka kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve analitike dhe verifikuese të strukturave hetimore, veçanërisht në hetimet komplekse financiare dhe pasurore si dhe ofruar asistencë plotë për përdorimin e tyre nga prokurorët dhe hetuesit OPGJ. Në këtë kuadër, janë realizuar trajnime të dedikuara për përdoruesit, si dhe asistencë teknike e vazhdueshme për identifikimin dhe adresimin në kohë reale të problematikave operationale, me qëllim garantimin e vazhdimësisë dhe eficiencës së punës institucionale në përdorimin e sistemeve të informacionit.

Në BKH është ngritur seksioni i përgjimit parandalues⁸⁴ ndërkohë që mbeten në proces organizimi për ngritje njësie e vlerësimit të riskut dhe e bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në kuadër të aktiviteteve 2.2.3.7 dhe 2.2.3.8 është shënuar progres i rëndësishëm në ngritjen dhe organizimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve) pranë Policisë së Shtetit. Në vijim të ndryshimeve strukturore të ndërmarra në vitin 2023 në Policinë e Shtetit, pranë Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare ka vijuar funksionimi i Sektorit të Analizës Financiare dhe ZRA, i cili ushtron funksionet e parashikuara në kuadrin ligjor për identifikimin, gjurmimin dhe rikuperimin e asetëve me prejardhje kriminale. Me miratimin e Ligjit nr. 44/2025 “Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve”, i cili ka hyrë në fuqi më 25 korrik 2025, është vendosur baza ligjore për organizimin e ZRA-së në nivel drejtorie, nën varësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky ligj përbën një instrument kyç në luftën kundër pastrimit të parave dhe rikuperimin e produkteve të veprimtarisë kriminale, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Sektori i Analizës Financiare dhe ZRA ka vijuar të administrojë dhe trajtojë kërkesa për shkëmbim informacioni nga Zyrat homologe të Rikuperimit të Aseteve të vendeve të BE-së, rrjeti CARIN, si dhe nga Europol dhe Interpol, në funksion të gjurmimit, identifikimit dhe rikuperimit të asetëve kriminale.

⁸³ Raporti vjetor 2025 i SPAK, faqe 8, në link: https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Raporti-vjetor-2025_SPAK.pdf.

⁸⁴ Raporti vjetor 2025 i SPAK, faqe 100, në link: https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Raporti-vjetor-2025_SPAK.pdf.

Paralelisht, stafi ka marrë pjesë në trajnime dhe workshope në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, të organizuara me mbështetjen e partnerëve, përfshirë Këshillin e Evropës, UNODC dhe Ambasadën Britanike. Në zbatim të ligjit të ri, gjatë vitit 2025 janë miratuar akte nënligjore për funksionimin e ZRA-së, përfshirë procedurat standarde të punës për rikuperimin e asetëve dhe shkëmbimin e informacionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, formatet e komunikimit elektronik zyrtar, si dhe përshtetjet e punës për strukturat përkatëse. Sa i përket strukturës dhe organikës, me miratimin e strukturës së Drejtorisë së Rikuperimit të Asetëve, është parashikuar organizimi i saj me drejtori, dy sektorë funksionalë (Komunikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm; Analiza dhe Statistika) dhe specialistët përkatës. Gjatë vitit 2025 ka përfunduar procedura e konkurrimit për përzgjedhjen e Drejtorit të Drejtorisë së Rikuperimit të Asetëve, si dhe janë emëruar drejtuesit e dy sektorëve kryesorë, ndërkohë që plotësimi i mëtejshëm i stafit specialist është në proces. Në përputhje me Ligjin nr. 44/2025, Drejtori i Drejtorisë së Rikuperimit të Asetëve është përcaktuar edhe si pikë kontakti për koordinimin e ndihmës dhe bashkëpunimit me Këshillin e Evropës dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë në fushën e rikuperimit të asetëve. Në zbatim të nenit 14 të Ligjit nr. 44/2025 “Për Zyrën e Rikuperimit të Asetëve”, Drejtori i ZRA-së ka detyrimin ligjor të kërkojë nga institucionet ligjzbatuese, përfshirë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, caktimin e pikave të kontaktit për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni në fushën e rikuperimit të asetëve.

Institucionet ligjzbatuese kanë vijuar forcimin e qasjes proaktive në zbulimin dhe hetimin e korrupsionit, përmes përdorimit sistematik të informacionit të marrë nga burime të hapura, raportet e auditimit, gjetjet e inspektimeve, kallëzimet e publikut dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në këtë kuadër, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar gjithsej 294 procedime penale të reja, nga të cilat 109 procedime janë iniciuar kryesisht nga prokurorët e posaçëm, duke reflektuar një qasje të shtuar proaktive. 139 procedime penale janë regjistruar mbi bazën e referimeve të shërbimeve të policisë gjyqësore, kallëzimeve të institucioneve vendase dhe autoriteteve të huaja, enteve private dhe shtetasve, ndërsa 46 procedime janë regjistruar mbi bazën e çështjeve të ardhura për kompetencë nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Gjithashtu, përmirësim kanë shënuar edhe referimet e marra nga Policia e Shtetit me rreth 70% dhe nga autoritete të tjera publike me rreth 15%.

Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar forcimin e transparencës dhe komunikimit me publikun dhe median, në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi. Gjatë vitit 2025 janë publikuar 201 njoftime për median dhe janë trajtuar 58 kërkesa për informacion, duke kontribuar në rritjen e besimit publik dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në denoncimin e veprave penale të korrupsionit, në përputhje me standardet ligjore dhe etike. Njoftimet janë publikuar në faqen kryesore dhe në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në rrethet përkatës në gjuhën shqipe dhe angleze. Informacioni shpërndahet gjithashtu edhe në rrjetin social X.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka vijuar veprimtarinë hetimore procedurale në bashkëpunim të ngushtë me prokuroritë, duke kontribuar ndjeshëm në dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme të punonjësve të policisë dhe strukturave mbikëqyrëse. Gjatë vitit 2025 janë referuar pranë organit të ndjekjes penale 336 referime penale për 444 subjekte, përfshirë punonjës

policie të niveleve drejtuese dhe zbatuese, punonjës civilë dhe shtetas⁸⁵. Krahas kësaj, janë zbatuar 133 masa sigurimi, përfshirë ndalime dhe arrestime në flagrancë, si dhe masa të tjera shtrënguese, në funksion të forcimit të përgjegjshmërisë dhe ligjshmërisë. Analiza e rasteve të trajtuara evidenton se shpërdorimi i detyrës dhe korrupsioni pasiv mbeten format më të shpeshta të paligjshmërisë, duke përbërë rreth 30% të totalit të referimeve penale, të ndjekura nga favorizimi i paligjshmërive, veprimet arbitrare dhe shkelje të tjera penale.

Në cilësinë dhe përmbushjen etributeve të Oficerit të Policisë Gjyqësore nga stafi i AMP, janë kryer me iniciativë ndalimet/arrestimet në kushtet e flagrancës si dhe ekzekutuar vendimet e gjykatave për masat e sigurisë të karakterit ndalues dhe shtrëngues, 133 masa, ndër të cilat ndaj 115 punonjësve të strukturave e 18 shtetasve⁸⁶.

Forma klasike e paligjshmërive, e kryer qoftë si formë e vetme apo e gërshetuar me shkelje të tjera ligjore, të shprehura në %, e proceduar nga AMP është: *Shpërdorim detyre & korrupsion pasiv* 30 % e totalit të referimeve penale, *Shpërdorim detyre&favorizim të paligjshmërive* 22 % të totalit të referimeve penale, *Kryerje e veprimeve arbitrare* 13 % e totalit të referimeve penale, *Dëmtime me dashje, kanosje, keqtrajtim, etj.* 19 % e totalit të referimeve penale dhe *Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor* 16 % e totalit të referimeve penale.

Në aspektin administrativ, AMP ka intensifikuar trajtimin e ankesave dhe kryerjen e inspektimeve të planifikuara dhe të paplanifikuara, duke u fokusuar jo vetëm në sasinë, por edhe në cilësinë e gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjatë vitit janë trajtuar 1677 ankesa nga kanale të ndryshme komunikimi dhe janë kryer 40 inspektime, me rekomandime për fillimin e hetimit disiplinor ndaj një numri të konsiderueshëm punonjësish policie, kryesisht për shkelje të rënda dhe të lehta disiplinore. Mekanizmat e përdorur nga AMP përmenden: Linja e gjelbër 0800 90 90 me 3846 telefonata. Ankesat të marra nga të gjitha portat e komunikimit 1677 ankesa, konkretisht: 513 ankesa nëpërmjet adresës së email-it ankesa@amp.gov.al, 331 ankesa nëpërmjet postës zyrtare, 252 ankesa pranë Drejtorive Rajonale të Agjencisë, 241 ankesa në Zyrën e Ankesave të AMP-së, 134 ankesa nëpërmjet Sistemit të Raportimit (Agjencia Dixhitale), 126 ankesa nga institucionet e tjera të administratës, 71 ankesa nga Portali i Bashkëqeverisjes, 5 ankesa nga rrjetet sociale/media dhe 4 ankesa nga Avokati i Popullit. Shënohen 18 inspektime të planifikuara të kryera dhe 22 inspektime të paplanifikuara, të kryera.

⁸⁵ 95 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 330 punonjës policie të nivelit zbatues, 9 punonjës civil (administrativ), 9 efektive të Gardës, 1 punonjës i PMNZSH dhe 62 shtetas,

⁸⁶ Arrestuar/ndaluar në flagrancë 70 persona (9 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 45 punonjës policie të nivelit zbatues, 1 punonjës administrative, 4 efektive të Gardës, 1 efektivi i PMNZSH-së, dhe 10 shtetas). Masa e sigurimit personal “*arrest në burg*” caktuar për 6 persona (4 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 1 punonjës policie të nivelit zbatues dhe 1 punonjës i Gardës). Masa e sigurimit personal “*arrest në shtëpi*” caktuar për 4 persona (1 punonjës policie i nivelit të parë drejtues dhe 3 punonjës policie të nivelit zbatues). Masa e sigurimit personal “*pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik*” caktuar për 41 persona (12 punonjës policie të nivelit të parë drejtues, 24 punonjës policie të nivelit zbatues, 2 punonjës administrative dhe 3 punonjës IKMT (shtetas). Masa e sigurimit personal “*detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” caktuar për 11 persona (5 punonjës policie të nivelit zbatues, 1 punonjës administrativ dhe 5 shtetas). Masa e sigurimit personal “*ndalim i daljes jashtë shtetit*” caktuar për 1 punonjës administrative.

Policia e Shtetit, përmes Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, ka kontribuar në rritjen e ndjeshmërisë së publikut dhe medias ndaj denoncimit të korrupsionit. Gjatë vitit 2025 janë evidentuar dhe referuar në prokurori 72 kallëzime penale për vepra që lidhen me korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës, përfshirë kallëzime të bazuara në investigime mediatike, të cilat kanë çuar në regjistrimin e procedimeve penale përkatëse.

Lidhur me zbatimin e aktivitetit 2.2.4.2, ILDKPKI ka marrë 75 masa administrative gjobë dhe ka proceduar në total me 16 referime penale ose referime të tjera.

Është vijuar me konsolidimin me të dhënave statistikore për veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar përmes përdorimit të vazhdueshëm të *E-Platform for Data Collection of the Enlargement Countries' Criminal Track Records (e-tracking)*, nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë. Platforma është përditësuar në mënyrë të rregullt dhe periodike nga pikat e kontaktit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, në përputhje me procedurat e miratuara dhe mekanizmin e bashkëpunimit ndër-institucional, duke garantuar saktësinë, koherencën dhe konsolidimin e informacionit statistikor. Aktualisht, në platformë janë hedhur dhe konsoliduar të dhënat për vitin 2025, të cilat shërbejnë si bazë për analizë, raportim dhe monitorim të treguesve përkatës.

Në këtë proces, Prokuroria e Përgjithshme, në rolin e koordinuesit dhe monitoruesit, së bashku me prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm si përdorues parësorë të platformës, ka qenë e angazhuar maksimalisht gjatë gjithë vitit 2025, si në hedhjen ashtu edhe në raportimin periodik të të dhënave për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ky angazhim është mbështetur nga bashkërendimi i vazhdueshëm i punës me Koordinatorin Kombëtar në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe me shërbimet përkatëse të Komisionit Evropian, në funksion të mbarëvajtjes së procesit të raportimit.

Në funksion të garantimit të një raportimi të unifikuar dhe cilësor, ka vijuar zbatimi i Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 25.04.2024, “Për përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave për korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili ka përcaktuar detyrime të qarta administrative dhe procedurale për drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, lidhur me hedhjen e saktë, të plotë dhe periodike të të dhënave.

Në e-platformë janë hedhur të dhënat për vitin 2025 për grupveprat e korrupsionit, referuar listës së neneve të dakordësuara me Komisionin Evropian, përfshirë ndër të tjera veprat penale të parashikuara në nenet 135, 244, 245/1, 248, 256, 259, 164 dhe 164/a të Kodit Penal. Sipas të dhënave statistikore të konsoliduara, për vitin 2025 janë regjistruar 699 procedime penale për veprat penale të korrupsionit dhe ato që lidhen me detyrën, me 163 të pandehur, ndërsa janë dërguar për gjykim 212 procedime penale me 421 të pandehur. Krahasuar me vitin 2024, kjo përfaqëson një rritje prej 14,60 % të procedimeve të dërguara për gjykim dhe një rritje prej 59,47 % të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim, duke reflektuar forcimin e raportimit, ndjekjes penale dhe transparencës statistikore.

Sa i përket sistemit gjyqësor, E-platforma nuk aplikohet për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO), për shkak të specifikave të funksionimit të saj.

Në kuadër të sensibilizimit dhe trajnimit për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Agjencia e Inteligjencës Financiare ka përfunduar hartimin e një dokumenti përmbledhës të indikatorëve, treguesve dhe tipologjive që lidhen me veprat penale të korrupsionit, të konstatuara gjatë trajtimit të rasteve nga institucionet përkatëse sipas fushave të përgjegjësisë së tyre. Dokumenti synon të shërbejë si instrument praktik orientues për identifikimin dhe analizën e riskut të korrupsionit, veçanërisht në ndërthurje me pastrimin e parave. Në procesin e hartimit, dokumenti është konsultuar me ILDKPKI, me qëllim sigurimin e koherencës ndërinstytucionale dhe reflektimin e praktikave ekzistuese në fushën e parandalimit dhe zbulimit të korrupsionit. Pas finalizimit, dokumenti është shpërndarë pranë organeve ligjzbatuese dhe institucioneve mbikëqyrëse, në përputhje me fushën e veprimtarisë së secilit, përfshirë Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokurorinë e Përgjithshme, Policinë e Shtetit, si dhe autoritete mbikëqyrëse si Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Njëkohësisht, dokumenti është vendosur në platformën elektronike të AIF, të dedikuar për subjektet raportuese, me qëllim që të shërbejë si referencë e vazhdueshme për rritjen e ndërgjegjësisë, përmirësimin e cilësisë së raportimeve dhe forcimin e kapaciteteve analitike në identifikimin e rasteve të dyshuara për korrupsion.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.2.2. Të dhënat e administruara nga Prokuroria e Posaçme dhe Prokuroria e Përgjithshme evidentojnë sa vijon:

- Organet e Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm kanë përfunduar 148 çështje për grupveprat penale të korrupsionit.
- Prokuroria e Posaçme ka përfunduar 127 çështje për grupveprat penale të korrupsionit.

Më konkretisht për vlerat e treguesit të performancës rezulton se:

- Prokuroria e Posaçme ka mbartur për hetim 389 çështje në vitin pasardhës, 2026, duke reflektuar një trend rritës të stokut të çështjeve (*backlog*) për veprat penale të lidhura me korrupsionin.⁸⁷
- Prokuroria e Përgjithshme ka mbartur (*backlog*) për hetim 113 çështje në vitin pasardhës, 2026, por gjithmonë brenda afateve procedurale hetimore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

Në analizë të të dhënave të konsoliduara nga të dy institucionet, konstatohet një rritje e lehtë e stokut (*backlog*) të çështjeve krahasuar me vitin pararendës, gjë që ka ndikuar në mosrealizimin e treguesit të performancës. Vlen të theksohet se ky tregues matet në bashkim dhe shumë të të dhënave statistikore të marra nga të dy prokuroritë në relevancë me kompetencat procedurale të tyre, sipas legjislacionit penal në fuqi. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance dhe në zbatim të formulës së matjes rezulton se ky tregues është realizuar vetëm në masën 55%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

⁸⁷ Fq.40 https://spak.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Raporti-vjetor-2025_SPAK.pdf

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2026	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2027	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2028	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	2029	Nuk ka <i>backlog</i>
	2030	Nuk ka <i>backlog</i>
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	Trend rritës i përfundimit të hetimeve penale për korrupsion (<i>backlog</i> i ulur)
	viti 2025 (targeti i arritur)	55%

2.2.3: Përqindja e vlerës së pasurive të sekuestruara si rezultat i hetimit të rasteve të korrupsionit nga vlera mesatare e pasurive të sekuestruara në tre vitet e fundit (trend rritës).

Vlera e synuar për *treguesin e performancës* 2.2.3 për vitin 2025 është: Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale.

Plani i veprimit për Objektivin 2.2, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 nuk parashikon masa dhe aktivitete specifike për zbatim, pasi vlerat e tregusit të performancës i referohen vlerave të pasurive të sekuestruara pasi janë administruar vendim/vendime gjykatë të formës së prerë.

Sa më sipër, mbështetur në të dhënat e administruara nga AAPSK rezulton se për vlerën e synuar të tregusit të performancës 2.2.3, vlera të pasurive të sekuestruara janë për 726 pasuri me vlerë 6,043,627,188.04 Lekë dhe nga këto për vepra penale të krimit të korrupsionit janë për 30 pasuri kundrejt vlerës së 693,553,42.00 Lekë (1.15%)

Të dhëna referuar vitit të kaluar, 2024, rezulton se pasuri të sekuestrura kanë qenë 554 me vlerë 2,263,838,910.21 Lekë dhe nga këto për veprat penale të krimit të korrupsionit, janë 12 pasuri me vlerë 90,193,500.00 Lekë (8.76%).

Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance dhe në zbatim të formulës së matjes rezulton se ky tregues është realizuar vetëm në masën 8%.

Paraqitja e realizueshmërisë së tregusit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale

	2026	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2027	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2028	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2029	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	2030	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	Trend rritës i raportit ndërmjet vlerës së aseteve të sekuestruara në korrupsion kundrejt çështjeve të tjera penale
	viti 2025 (targeti i arritur)	8%

Niveli i realizimit të objektivit 2.2

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.2. Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 është **54.3%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 2.2 = \frac{TP\ 2.2.1\ (100\%)+\ TP\ 2.2.2\ (55\%)+\ TP\ 2.2.3\ (8\%)}{3\ TP} \times 100\% = 54.3\%$$

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga autoritetet përgjegjëse si prokuroritë (e Posaçme dhe e Përgjithshme) si dhe AAPSK, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2025.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.2

Për vitin 2025, paraqitet risk i lartë në realizimin e objektivit specifik për shkak të mosarritjes së vlerave të synuara të treguesve.

2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

2.3.1: Raporti i numrit të operacioneve të nisura nga Europol dhe Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë nga numri mesatar i këtyre operacioneve në tre vitet e fundit (trend rritës)

Plani i veprimit për Objektivin 2.3, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 4 aktivitete dhe 3 masa.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 2.3.1* për vitin 2025 është: Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masat (3) si më poshtë.

2.3.1	Përmirësimi dhe evidentimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të organeve ligjzbatuese (të juridiksionit të posaçëm dhe ato të juridiksionit të zakonshëm), për hetimin dhe sanksionimin e krimit të korrupsionit dhe të krimeve me natyrë ekonomike
2.3.1.1	Marrëveshje bashkëpunimi me autoritete të huaja (ndërkombëtare) dhe të dhëna për zbatimin e tyre (platforma rajonale bashkëpunimi)
2.3.1.2	Shkëmbime informacioni në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht në ndihmën e ndërsjellë juridike për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe provave në rastet e korrupsionit dhe krimit ekonomik
2.3.2	Vendosje e bashkëpunimit ndërkombëtar midis Zyrave të Rekuperimit të Aseteve për gjurmimin e informacionit për pasuri dhe asete të vëna nga krime të korrupsionit dhe të krimeve me natyrë ekonomike
2.3.2.1	Ngritja dhe shkëmbimi i informacionit midis strukturave të ZRA-ve me qëllim rekuperimin e aseteve që vijnë nga aktiviteti kriminal
2.3.3	Ngritja e kapaciteteve, shkëmbimi i informacionit dhe aktivitete të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit
2.3.3.1	Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të agjencive të zbatimit të ligjit me Interpolin dhe Europolin (tryeza pune të përbashkëta; forume diskutimi; takime dhe konferenca)

Realizimi i masave së parashikuara kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për zbatim përgjatë periudhës dhe që vijojnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, Policia e Shtetit ka intensifikuar ndjeshëm bashkëpunimin ndërkombëtar, duke nënshkruar gjithsej 25 akte ndërkombëtare me autoritete dhe partnerë të huaj strategjikë, me qëllim forcimin e kapaciteteve operative, teknike dhe institucionale, si dhe rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikut të narkotikëve, migracionit të parregullt dhe veprimtarive të tjera kriminale. Më konkretisht, bashkëpunimi është materializuar përmes termave të referencës, memorandumeve të mirëkuptimit, marrëveshjeve administrative dhe kontratave dhurimi, kryesisht me Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Italinë, Kosovën, Suedinë, Norvegjinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ukrainën, si dhe me institucionet

e Bashkimit Evropian. Këto instrumente kanë mbështetur, ndër të tjera, pajisjen e Policisë së Shtetit me mjete teknologjike të avancuara (dronë termikë, sisteme videoskopike, pajisje skanimi, mjete transporti operativ, pajisje laboratorike për policinë shkencore), përmirësimin e kontrollit të territorit dhe kufijve, si dhe forcimin e kapaciteteve hetimore dhe analitike. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit kundër trafikut të drogës, përmes marrëveshjeve specifike me autoritetet italiane dhe përmes atashimeve policore pranë strukturave partnere ndërkombëtare, si dhe mbështetjes për reformën e policisë, rritjes së profesionalizmit dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Paralelisht, Policia e Shtetit ka qenë pjesë aktive në iniciativa rajonale për trajnim dhe ngritje kapacitetesh, përfshirë themelimin e Shoqatës Rajonale të Akademive të Policisë në Evropën Juglindore (RAPAC SEE). Në tërësi, këto akte përbëjnë një bazë të konsoliduar bashkëpunimi ndërkombëtar, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve operative dhe parandaluese të Policisë së Shtetit, në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e sigurisë dhe sundimit të ligjit.

Marrëveshjet e lidhura përmenden: 1) Marrëveshje Bashkëpunimi për të dërguar forca të huaja policore si vëzhgues operacional Policisë Federale me rastin e UEFA EURO 2024 ndërmjet Selisë së Policisë Federale Gjermane dhe Policisë së Shtetit Shqiptar. Marrëveshja është vijimësi e Deklaratës së Përbashkët të synimit për bashkëpunimin policor gjatë Kampionatit Evropian të Futbollit UEFA për meshkuj (UEFA EURO 2024TM) ndërmjet Ministrisë Federale të Brendshme dhe Komunitetit të Republikës Federale të Gjermanisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Shqiptar, nënshkruar dhe hyrë në fuqi për palën shqiptare më 27.03.2024. Marrëveshja është nënshkruar nga pala gjermane më 01.06.2024 dhe nënshkruar e hyrë në fuqi nga pala shqiptare më 07.06.2024. Ka përfunduar me date 24.06.2024 – pas skualifikimit të Skuadrës Shqiptare nga UEFA 2024; 2) Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të RSH, që vepron nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shtetit Shqiptar dhe Sekretarit të Shtetit të Departamentit të Brendshëm të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut që vepron përmes Departamentit të Jashtëm, Mirëqenies dhe Zhvillimit, përfaqësuar nga Ambasada Britanike në Tiranë mbi Grantin për Ndërtimin e Task Forcës së Përbashkët për Migracionin, nënshkruar në Tiranë, në javën e dytë të Muajit Gusht 2024; 3) Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit. Nënshkruar më 28.3.2022, në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe. Hyrë në fuqi më 22.08.2024; 4) Marrëveshje Administrative ndërmjet DPPSH dhe Departamentit të Sigurisë Publike të Italisë - mbi veprimtaritë teknike të regjistrimit të migrantëve të transportuar nga Italia në Shqipëri, nënshkruar më datë 04.09.2024, në Tiranë; 5) Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Italisë për zbatimin e Protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit të datës 06.11.2023. Nënshkruar për palën tonë në Tiranë më 12.09.2024 dhe për palën italiane në Romë, më datë 19.09.2024; 6) Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës për Implementimin e kontrollit të përbashkët kufitar në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar Qafë Morinë (Tropojë, Gjakovë), Qafë Prush (Has, Gjakovë), Shishtavec Borje, Orgjost (Kukës, Krushevë), nënshkruar më datë 09.07.2024, në Qafë Morinë, Tropojë, Shqipëri nga dy Ministrat e Brendshëm të dy vendeve; 7) Protokoll midis Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Policisë së Malit

të Zi, për bashkëpunim gjatë sezonit turistik veror, nënshkruar për palën shqiptare më datë 18.07.2024 dhe nënshkruar për palën malazeze më dt. 19.07.2024, datë në të cilën ka hyrë në fuqi, për një afat të pacaktuar; 8) Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, për bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit. Nënshkruar më 28.3.2022, në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe. Hyrë në fuqi më 22.08.2024; 9) Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Moldavisë për bashkëpunimin policor, nënshkruar në Moldavi me datë 16.11.2023 dhe ka hyrë në fuqi me datë 23 gusht 2024; 10) Terma reference ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Sekretariatit për Punët e Brendshme të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut që vepron nëpërmjet Zyrës së Operacioneve Ndërkombëtare të Ministrisë së Brendshme Britanike për Dhurimin e DJI MAVIC 3 Thermal Dronë (4 në total) zbatimin e masave shtesë për skanimin dhe kontrollin e territoreve tokësore për aktivitete kriminale. Nënshkruar më, datë 28.01.2025 në Tiranë; 11) Marrëveshje Atashimi ndërmjet Komisionerit të Shërbimit të Policisë Metropolitane dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Shqiptar. Nënshkruar për palën shqiptare më datë 31.01.2025. Ka si objekt atashimin e z. Genci POSTOL pranë Komisionerit të Shërbimit të Policisë Metropolitane për periudhen kohore 01.03.2025 deri më 01.03.2026; 12) Terma Reference Ndërmjet DPPSH dhe Sekretarit të Shtetit për Punët e Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut që vepron nëpërmjet Zyrës së Operacioneve Ndërkombëtare për dhurimin e kompletit FLIR VS80 – me sondë videoskopi 4.6mm, gjatësia e sondës 2 m, Rezolucioni 640 x 480 piksel (3 në total) për zbatimin e masave shtesë për skanimin dhe kontrollin e territorit tokësor për aktivitete kriminale. Nënshkruar në Tiranë më datë 07.03.2025; 13) Akt Dorëzimi ndërmjet Zyrës Federale Kriminale gjermane përfaqësuar nga Ambasadori Z. Karlfried Bergner dhe Policisë së Shtetit Shqiptar përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Ilir Proda, për dhurimin e automjetit Skoda Kodiaq për Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtorisë në DPPSH. Dorëzimin e 2 Laptopëve Lenovo Legion 5 PRO 16IRX9 Gaming Notebook PC, për Institutin e Policisë Shkencore për Dokumentet dhe Krahasimin e Fotove ne kuadër të projektit “SCOPE” të financuar nga BE-ISF Nënshkruar në Tiranë më datë 13.02.2025; 14) Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet DPPSH dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës për organizimin e shërbimeve të përbashkëta të policimit rrugor mes policive të dy vendeve, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nënshkruar në Berat, më datë 25.06.2025; 15) Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Qendrës për Integritetin në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) të Norvegjisë. Asistencë për MB nga qendra CIDS - 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2025 (periudha e mbështetjes); 16) Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Departamentit të Shtetit, Byrosë së Sigurisë Diplomatike dhe Policisë së Shtetit të Shqipërisë për sigurimin e shërbimeve investiguese shtesë, nënshkruar më datë 28.05.2025, më Tiranë, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi pa afat nëse nuk ndërpritet me vendim të përbashkët me shkrim të Pjesëmarrësve ose nga një Pjesëmarrës; 17) Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Kombëtare të Ukrainës për gjetjen, gjurmimin dhe menaxhimin e pasurive që rrjedhin nga korrupsioni dhe krime të tjera. Nënshkruar dhe hyrë në fuqi më datë 29.05.2025, në Ukrainë; 18) Marrëveshje Administrative mbi vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian në rrjetin evropian të migracionit”, nënshkruar më 24.06.2025, në Varshavë; 19) Terma Reference Ndërmjet DPPSH dhe Sekretarit të Shtetit për Punët e Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut që vepron nëpërmjet Zyrës së Operacioneve Ndërkombëtare për dhurimin e 1 (një) makine “TOYOTA

LAND CRUISER HV09”, zbatimin e masave shtesë për skanimin dhe kontrollin e territoreve tokësore për aktivitetet kriminale si dhe Dylbive Termike Multispektrale Pulsar Merger Duo NXP 50 (4 gjithsej), për zbulimin e migrantëve të parregullt për në dhe nga Republika e Shqipërisë. Nënshkruar në Tiranë më datë 14.10.2025; 20) Terma Reference Ndërmjet DPPSH dhe Sekretarit të Shtetit për Punët e Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut që vepron nëpërmjet Zyrës së Operacioneve Ndërkombëtare për ofrimin e ekraneve LG ULTRAFINE 32UR500K (7 gjithsej) për analiza, skanim dhe zbulim të aktiviteteve kriminale në Republikën e Shqipërisë. Nënshkruar në Tiranë më datë 14.10.2025; 21) Terma Reference Ndërmjet DPPSH dhe Sekretarit të Shtetit për Punët e Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut që vepron nëpërmjet Zyrës së Operacioneve Ndërkombëtare për ofrimin e mbështetjes për ambientet e Njësisë Speciale për Kufirin dhe Migracionin DELTA për mbështetjen e operacioneve shtesë duke përmirësuar qëndrueshmërinë e operacioneve në kufi për aktivitetet kriminale. Nënshkruar në Tiranë më datë 14.10.2025; 22) Kontratë dhurimi ndërmjet Republikës Federale Gjermane përfaqësuar nga Ministria e Brendshme dhe për Vendlindje, kjo e fundit përfaqësuar nga Presidiumi i Policisë Federale Gjermane dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më datë 27.10.2025, në Tiranë. Ka si objekt dhurimin e një kabinet për përdorimin e avujve të ciankrilatit për zhvillimin e gjurmëve papilare të padukshme, me vlerë 16.310,0 Euro, për Institutin e Policisë Shkencore të DPPSH; 23) Marrëveshje Mirëkuptimi midis DPPSH të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Qendrore për Shërbimet Antidrogë pranë Ministrisë së Brendshme të Republikës së Italisë “Mision Antidrogë”. Nënshkruar më datë 13.11.2025, në Romë. Ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet palëve, duke i dhënë njëra-tjetrës informacionet ligjore të nevojshme e të lejuara, si edhe mbështetjen teknike e logjistike , në bazë të nevojave operative, në luftën ndaj drogës; 24) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Policisë së Shtetit shqiptar dhe Policisë Suedeze me objekt "Mbështetja suedeze për reformën e policisë në Shqipëri" dhe "Përmirësimi i aftësisë dhe efektivitetit të Policisë së Shqiptar për të respektuar praktikën me të mira ndërkombëtare dhe standardet e të drejtave të njeriut". Nënshkruar në Tiranë, më datë 18.09.2025; 25) Deklaratë e Përbashkët për themelimin e Shoqatës Rajonale të Akademive të Policisë / Qendrave të Trajnimit në Evropën Juglindore (RAPAC SEE). Nënshkruar në Shkup, Maqedoni e Veriut, më datë 14.10.2025, nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kroacia, Kosova, Greqia, Sllovenia, Mali i Zi dhe Moldavia. Ka si qëllim promovimin e zhvillimit të udhëzimeve të përbashkëta, jo detyruese, për të mbështetur aktivitete të përbashkëta trajnimi me cilësi të lartë dhe efektive; Zhvillimi i programeve të përbashkëta trajnimi; Nxitja e kërkimit dhe zhvillimit; Mbështetja e programeve të shkëmbimit; Zhvillimi dhe/ose avancimi i sistemit të të mësuarit gjatë gjithë jetës për punonjësit dhe oficerët e policisë; Zhvillimi i vizitave studimore për shkëmbimin e kurrikulave, metodologjisë së mësimdhënies dhe fushave të bashkëpunimit.

Prokuroria e Përgjithshme ka lidhur një Memorandum Mirëkuptimi me Prokurorinë e Malit të Zi. Ky memorandum synon forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve dhe përmirësimin e shërbimeve dhe mbështetjen në angazhimin e përbashkët për bashkëpunim, respektimin e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe luftën kundër krimit të rëndë, pastrimit të parave etj. për qytetarët e të dy vendeve.

Prokuroria e Posaçme ka nënshkruar një Memorandum Mirekuptimi⁸⁸ me Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës të Ekuadorit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy palëve me qëllim parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, në veçanti trafikun e drogës. Prokuroria e Posaçme ka ndërmarrë hapa konkretë për zgjerimin e rrjetit të bashkëpunimit me autoritete homologe jashtë vendit dhe më 3 dhjetor 2025, janë nënshkruar një sërë Memorandume Mirekuptimi ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe Zyrave të Prokurorëve të Përgjithshëm të disa shteteve të Amerikës Latine, përkatësisht Republikës së Kolumbisë, Republikës së Kilit, Republikës Federative të Brazilit, Republikës së Paraguait dhe Republikës Domenikane. Këto memorandume synojnë rritjen dhe formalizimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, veçanërisht në fushën e parandalimit dhe luftës kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, me fokus të posaçëm në trafikun e lëndëve narkotike, shkëmbimin e informacionit, asistencën e ndërsjellë teknike dhe forcimin e kapaciteteve hetimore. Nënshkrimi i këtyre instrumenteve përbën një hap të rëndësishëm në konsolidimin e bashkëpunimit proaktiv të Prokurorisë së Posaçme me partnerë strategjikë ndërkombëtarë dhe në përputhje me standardet e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

Në vitin 2025, Policia e Shtetit ka forcuar bashkëpunimin operacional ndërkombëtar në funksion të hetimit të korrupsionit dhe krimit ekonomik, përmes një shkëmbimi të zgjeruar informacioni me partnerët e huaj. Në total, janë shkëmbyer 36 632 informacione, nga të cilat 23 493 përmes Interpol-it, 8 324 përmes Europol-it dhe 4 815 përmes Oficerëve të Kontaktit, nëpërmjet kanaleve zyrtare si Interpol Exchange, SIENA dhe SON. Ky shkëmbim ka përfshirë informacione, indicie dhe prova me karakter ndërkombëtar, duke mbështetur drejtpërdrejt hetimet penale dhe rritur efektivitetin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkufitar.

Prokuroria e Posaçme ka vijuar forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet një angazhimi intensiv në fushën e ndihmës juridike ndërkombëtare, hetimeve të përbashkëta, hetimeve pasurore dhe procedurave të ekstradimit, në funksion të hetimit të veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit. Më konkretisht, Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta ka trajtuar 86 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja, të bazuara në konventat e Këshillit të Evropës, konventat e Kombeve të Bashkuara dhe marrëveshjet dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë. Paralelisht, për nevojat e hetimeve të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, janë përgatitur dhe dërguar 151 kërkesa për ndihmë juridike drejt autoriteteve gjyqësore të huaja, kryesisht në vendet e Evropës, Rajonit dhe Amerikës Latine. Në të njëjtën periudhë, janë transmetuar 3 referime penale nga autoritete të huaja, ndërsa në fushën e hetimeve pasurore, në vijim të kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare dhe në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, janë regjistruar 4 referime për hetime pasurore të transmetuara nga autoritetet belge, të cilat ndodhen aktualisht në fazë hetimi. Një element i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe ngritja e Skuadrave të Përbashkëta Hetimore (JIT). Janë krijuar 6 Skuadra të Përbashkëta Hetimore, në kuadër të të cilave janë zhvilluar 16 takime koordinuese me autoritetet e huaja partnere, përfshirë edhe takime të përbashkëta përmes videokonferencës. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional për procedurat e ekstradimit, Prokuroria e Posaçme ka transmetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë 43 kërkesa për ekstradim nga jashtë drejt Republikës së Shqipërisë.

⁸⁸ Lidhur në datë 27.03.2025.

Në vitin 2025 janë hedhur bazat institucionale dhe operacionale për ngritjen dhe shkëmbimin e strukturuar të informacionit ndërmjet Zyrave të Rikuperimit të Aseteve, me qëllim identifikimin, gjurmimin dhe rikuperimin e asetëve me origjinë kriminale. Në përputhje me Ligjin nr. 44/2025, është përcaktuar Drejtori i Drejtorisë së Rikuperimit të Aseteve si pikë kontakti për ndjekjen dhe koordinimin e bashkëpunimit me Këshillin e Evropës dhe partnerët ndërkombëtarë në fushën e ARO. Në aspektin operacional, shkëmbimi zyrtar i informacionit ndërmjet strukturave ARO realizohet përmes kanalit SIENA, i cili siguron komunikim të standardizuar, të sigurt dhe të gjurmueshëm në nivel evropian. Paralelisht, Policia e Shtetit vijon të jetë pjesë aktive e rrjetit CARIN, i cili shërben si mekanizëm informal bashkëpunimi për shkëmbimin e shpejtë të informacionit lidhur me identifikimin dhe rikuperimin e asetëve kriminale, duke plotësuar kështu kornizën formale të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2025 është forcuar ndjeshëm bashkëpunimi dhe koordinimi i agjencive shqiptare të zbatimit të ligjit me Interpolin dhe Europolin, si në nivel operacional ashtu edhe strategjik. Nga ana e Policisë së Shtetit, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar 5 operacione policore ndërkombëtare, në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Interpolin, Europolin dhe autoritete homologe. Këto operacione kanë adresuar fusha prioritare si: 1- krimet mjedisore dhe tregtia e paligjshme e florës dhe faunës (Operation Thunder); 2- lufta kundër produkteve farmaceutike të falsifikuara dhe krimit financiar (Operation PANGEA XVII); 3- falsifikimi i dokumenteve të udhëtimit në bashkëpunim me Maqedoninë e Veriut (Operacioni DVOJNIK); 4- krimet kibernetike financiare dhe pastrimi i parave në internet (Operacioni HAECHE V – CEFIN Faza II); si dhe 5- mashtrimet me kriptomonedha në bashkëpunim me Policinë Spanjolle (Operacioni PIPOL). Këto nisma kanë kontribuar në rritjen e shkëmbimit të informacionit, hetimeve të përbashkëta dhe goditjen e formave të reja të kriminalitetit ndërkufitar.

Nga ana e Prokurorisë së Posaçme, Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta ka vijuar të luajë rolin e pikës qendrore ndërlidhëse me autoritetet e huaja, në përputhje me ligjin nr. 95/2016. Gjatë vitit 2025, bashkëpunimi me Interpolin, Europolin, Eurojust-in dhe autoritetet gjyqësore partnere ka mbështetur drejtpërdrejt hetimet e përbashkëta, procedurat e ekstradimit dhe shkëmbimin operativ të informacionit, duke garantuar koordinim të qëndrueshëm institucional në çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Vlen të përmendet se gjithashtu Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në vitin 2025 ka intensifikuar bashkëpunimin dhe koordinimi me Europolin dhe Interpolin, përmes pjesëmarrjes aktive në forume ndërkombëtare, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe prezantimit të rasteve konkrete operacionale. Më 21–22 shkurt 2025, në Hagë, AMP mori pjesë në Konferencën e Europol-it “Të drejtat themelore në zemër të policimit”, ku Agjencia u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm dhe disa punonjës. Aktiviteti mblodhi mbi 130 pjesëmarrës, nga 25 vende anëtare të BE-së dhe 11 vende joanëtare, të cilët diskutuan mbi respektimin e të drejtave themelore në polici dhe ndërtimin e praktikave bashkëpunuese për ruajtjen e besimit ndërmjet forcave të zbatimit të ligjit dhe komuniteteve. Në kuadër të kësaj konference, u zhvillua gjithashtu një takim zyrtar dypalësh me Drejtorin e Departamentit të Krimit Ekonomik dhe Financiar Evropian, ku u trajtua forcimi i bashkëpunimit operacional dhe shkëmbimi i informacionit, përfshirë përdorimin e të dhënave të siguruar nga platformat e enkriptuara Sky ECC dhe EncroChat. Gjithashtu, më 8 tetor 2025, në Hagë, AMP u përfaqësua në Konferencën e 3-të të Europol-it mbi korrupsionin në organet e zbatimit të ligjit, të organizuar nga Zyra Anti-Korrupsion e Europolit. Në këtë aktivitet morën

pjesë përfaqësues nga 16 vende, anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnerë operacionalë, të angazhuar në luftën kundër korrupsionit në radhët e forcave të zbatimit të ligjit. Në këtë kuadër, AMP prezantoi dy operacione, konkretisht, u paraqit “Operacioni Pika 2” (2022), i zhvilluar në bashkëpunim me SPAK, Policinë Kufitare të Policisë së Shtetit dhe Inspektoratin Policor të Kosovës, ku u ekzekutuan 32 masa sigurie me vendim gjykate ndaj 32 punonjësve të policisë, përfshirë edhe drejtues të niveleve të larta, si dhe ndaj 2 shtetasve, për vepra penale që lidhen me korrupsionin, kontrabandën dhe ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit. Gjithashtu, u prezantua rasti i arrestimit të një mjeku të Akademisë së Sigurisë në vitin 2023, i dyshuar për korrupsion pasiv, shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh shëndetësore, si shembull i hetimeve efektive ndaj korrupsionit në institucionet e sigurisë.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 2.3.1. Më konkretisht, Policia e Shtetit ka ndërmarrë janë 5 operacione me Interpol dhe Europol dhe nga Prokuroria e Posaçme janë ndërmarrë 6 operacione me autoritete ndërkombëtare, duke shënuar një numër total prej 11 operacionesh. Krahasuar me të dhënat kumulative të një viti më parë, 2024, ka një rënie në numrin e operacioneve për të cilin janë shënuar 17 të tilla. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance dhe në zbatim të formulës së matjes rezulton se ky tregues është realizuar vetëm në masën 65%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e vlerësimit
	2025	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2026	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2027	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2028	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2029	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	2030	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
	viti 2025 (targeti i synuar)	Trend rritës i numrit të operacioneve ndërkombëtare ku Shqipëria ka marrë pjesë
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i arritur)	65%

Niveli i realizimit të objektivit 2.3

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2025 është **65%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar raportet e vlerësimit të kryer, dhe të dhënat e administruara, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 2.3 për këtë periudhë raportimi është **65%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga prokuroritë (e përgjithshme dhe e posaçme, dhe Policia e Shtetit).

Risqet për realizimin e Objektivit 2.3

Për vitin 2025, realizimi i objektivit është ka rezultuar në risk të lart për shkak të mosarritjes së vlerave të synuara të treguesit të performancës.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit (Politika Ndëshkuese - II)

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 3 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit. Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave, duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve, realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit është **73.1%**.

Objektivi	Realizueshmëria
2.1. Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit	100%
2.2. Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit	54.3%
2.3. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimin ekonomik dhe të pastrimit të parave	65%

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit, e cila është në masën 73.1%, tregon për një rezultat të moderuar të strukturave me funksione ligjzbatuese, përgjatë periudhës janar - dhjetor 2025.

Si rezultat, vihet re përparim i konsiderueshëm në forcimin e mekanizmave institucionalë dhe kapaciteteve të hetimit administrativ dhe penal kundër korrupsionit. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka të miratuar dhe në funksion të plotë zbatimi rregulloren e brendshme, e cila normon dhe sanksion marrëdhënien e saj me Koordinatorët Antikorrupsion në kuadër të kompetencave të verifikimit dhe hetimit administrativ. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka kryer dhe përfunduar së verifikuari dhe hetuari 439 raste, për të cilat referohen: 71 raporte përfundimtare ku janë propozuar 207 masa administrative dhe 234 rekomandime; 32 raste janë

përcjellë për kompetencë, si dhe 336 raste janë përgatitur memo arkivimi dhe/apo kthim përgjigje për të cilat nuk gjenden raste të procedimit administrative. DPAK ka depozituar në organin e prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë edhe 2 raste kallëzime penale. Në fushën e ndjekjes penale, u miratua kuadri ligjor për rekuperimin e asetëve dhe për konsolidimin institucional dhe organizimi dhe funksionimi i Zyra e Rikuperimit të Aseteve pranë Policisë së Shtetit. Ka vijuar forcimi i strukturave të Policisë së Shtetit dhe krijimi i njësisë të specializuara për hetimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimeve financiare, shoqërohet me intensifikim trajnimesh për oficerët e policisë dhe prokurorët, me mbi 100 aktivitete trajnuese, dhe pjesëmarrje të gjerë në bashkëpunime rajonale, si dhe me kurrikula të rishikuara nga Shkolla e Magjistraturës. Organet e Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm kanë përfunduar 148 çështje për grupveprat penale të korrupsionit. Prokuroria e Posaçme ka përfunduar 127 çështje për grupveprat penale të korrupsionit. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka intensifikuar veprimtarinë hetimore në vitin 2025, duke referuar 336 çështje penale për 444 subjekte dhe duke zbatuar 133 masa sigurimi, në bashkëpunim të ngushtë me prokuroritë. Shpërdorimi i detyrës dhe korrupsioni pasiv mbeten format më të përhapura të paligjshmërisë (rreth 30% e rasteve), duke reflektuar sfida të vazhdueshme në integritetin e strukturave policore. Paralelisht, janë trajtuar 1677 ankesa dhe janë kryer 40 inspektive, duke forcuar mekanizmat e mbikëqyrjes administrative dhe disiplinore. Veprimtaria e AMP karakterizohet gjithashtu nga një qasje e shtuar proaktive, përmes ndërhyrjeve me iniciativë dhe përdorimit të gjerë të kanaleve të raportimit për evidentimin e shkeljeve, me përdorim të mekanizmave të komunikimit. Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Posaçme kanë kryer 11 operacione të përbashkëta me Interpol dhe Europol dhe autoritete të tjera ndërkombëtare. AAPSK ka sekuestruar 726 pasuri me vlerë 6,043,627,188.04 Lekë dhe nga këto për vepra penale të kimit të korrupsionit janë për 30 pasuri kundrejt vlerës së 693,553,42.00 Lekë (1.15%)

Realizimi i kënaqshëm i treguesve të performancës për objektivat 2.1-2.3, dëshmon angazhimin e institucional të organeve ligjzbatuese për organizimin e strukturave dhe rritjen e kapaciteteve profesionale teknike në luftën kundër korrupsionit për efektivitet dhe efikasitet të moderuar në verifikime dhe ndjekje penale të kimit të korrupsionit.

Politika Ndërgjegjësuere (III) - Përmbledhje për arritjet në ndërgjegjësimin mbi korrupsionin


Përmes **qëllimit të politikës ndërgjegjësuere** SNKK, synon të rrisë pjesëmarrjen e publikut në luftën kundër korrupsionit duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativat e parandalimit të korrupsionit, edukimi i të rinjve mbi çështjet e etikës, përfshirja proaktive e organizatave të shoqërisë civile, sektorit privat dhe grave në luftën kundër korrupsionit janë fokusi i qasjes ndërgjegjësuere të SNKK 2024-2030.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

Qëllimet e Politikës		Realizimi i Masave dhe aktiviteteve
----------------------	--	-------------------------------------

	Masat dhe Aktivitetet	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara ⁸⁹	Masa dhe aktivitete të porealizuara ⁹⁰
Ndërgjegjësuere (III)	Masa	10	6	2	2
	Aktivitete	21	13	3	5

Rezultoni se nga 10 masa dhe 21 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2024 – 2026, për vitin 2025, për Politikën Ndërgjegjësuere janë zbatuar plotësisht 6 masa dhe 13 aktivitete, pjesërisht 2 masa dhe 3 aktivitete si dhe pazbatuar 2 masa dhe 5 aktivitete (masa: 3.2.2 dhe 3.4.1 dhe aktivitetet: 3.2.2.2, 3.2.2.3., 3.3.1.2, 3.3.3.3 e 3.4.1.1).



Nga 4 treguesit e performances për Politikën Ndërgjegjësuere (III), është arritur është arritur vlera e synuar për 3 tregues performance dhe për 1 është realizuar vetëm pjesërisht.

Ndërgjegjësuere	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ⁹¹	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ⁹²	Vlera e synuar nuk është e realizuar ⁹³
	4	3	1	0


⁸⁹ Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁹⁰ Aktivitet "i porealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

⁹¹ Që është realizuar në shkallën 100 për qind.

⁹² Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁹³ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna.



3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

3.1.1: Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit.

Plani i veprimit për Objektivin 3.1, në periudhën 2025 parashikon 5 aktivitete dhe 1 masë.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 3.1.1 për vitin 2025 është: 5% rritje e informimit dhe publikim i shtuar në marrjen e informacionit në autoritetet publike.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masa (1) si më poshtë.

3.1.1	Rritja e ndërgjegjësimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit në shoqëri
3.1.1.1	Ngritja e një website për DPAK
3.1.1.2	Plan (vjetor) Vizibiliteti dhe Komunikimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, i hartuar dhe i publikuar
3.1.1.3	Organizimi i fushatës vjetore të ndërgjegjësimit të luftës kundër korrupsionit "Java e Integritetit"

3.1.1.4	Marrëveshje bashkëpunimi me TV publik për transmetime televizive (emisione, intervista, rubrika, njoftime)
3.1.1.5	E-buletin mujor DPAK

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për zbatim përgjatë periudhës dhe që do të vijojnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është ngritur dhe bërë e aksesueshme për publikun faqja zyrtare e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Faqja e internetit jep informacione të detajuara mbi organizimin dhe funksionimin e DPAK, aktivitetin e saj dhe mënyra e komunikimit me publikun e gjerë. Seksione të dedikuara për raportimin e rasteve të korrupsionit (denoncime), dokumente strategjike, njoftime publike dhe materiale edukative për qytetarët, janë të aksesueshme në këtë faqe. Adresa e faqes së internetit është: www.antikorrupsioni.gov.al.

Referuar përgatitjes së një plani komunikimi dhe vizibiliteti, 2025, për luftën kundër korrupsionit, është hartuar, miratuar dhe publikuar dokumenti që përmban aktivitetet e komunikimit publik, fushatat ndërgjegjëse dhe përdorimin e mediave sociale për informimin e qytetarëve mbi pasojat e korrupsionit dhe mekanizmat e raportimit. Dokumenti përmban një listë me aktivitete publike për të promovuar luftën kundër korrupsionit dhe me qëllim ndërgjegjësimin e tij dhe edukimin e publikut të gjerë. Dokumenti përmban në total 8 aktivitete⁹⁴, të shpërndara për zhvillim përgjatë gjithë vitit 2025 (6M1 – 6M2, 2025). Dokumenti mund të aksesohet në link: www.antikorrupsioni.gov.al/kreu/lista-dokumente/.

Në 2-16 dhjetor 2025 u zhvillua edicioni i 7-të i “Javës së Integritetit 2025” një fushatë e gjerë ndërgjegjësimi me aktivitete institucionale, edukative dhe ndërsektoriale, me qëllim forcimin e kulturës së integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike dhe shoqëri. Fushata vjetore kulmoi me punimet e konferencës “Integriteti: Një busull për demokracinë dhe konkurrueshmërinë”⁹⁵, e organizuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike, ekspertëve ndërkombëtarë, sektorit privat dhe shoqërisë civile. Diskutimet u përqendruan në rolin e integritetit në rritjen e besimit publik dhe konkurrueshmërisë institucionale, si dhe në praktikatat e planifikimit lokal të integritetit dhe zbatimin e Planeve të Integritetit sipas SNKK. Këtë edicion të “Javës së Integritetit” u zhvillua debati “Zëri i të Rinjve për Integritet”⁹⁶, me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të mesme, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Ministrinë e Arsimit. Aktiviteti synoi ndërgjegjësimin e të rinjve mbi etikën, përgjegjshmërinë dhe integritetin, si pjesë e Programit Edukativ Kundër Korrupsionit në zbatim të SNKK 2024-2030. Në qendrën COD, u organizua ekspozita “Integriteti Frymëzon: Të rinjtë flasin përmes artit”⁹⁷, ku nxënës të shkollave të mesme prezantuan krijime artistike mbi vlerat e integritetit dhe transparencës. Aktiviteti demonstroi përdorimin e artit si mjet ndërgjegjësimi dhe përfshirjeje aktive të të rinjve në ndërtimin e një kulture integriteti. Në kuadër

⁹⁴ Java e Integritetit 2025, është gjithashtu pjesë e tij.

⁹⁵ <https://mapa.gov.al/newsroom/java-e-integritetit-2025-zhvillohet-konferenca-integriteti-nje-busull-per-demokracine-dhe-konkurreshmerine/>

⁹⁶ <https://mapa.gov.al/newsroom/ne-kuader-te-javes-se-integritetit-zeri-i-te-rinjve-per-integritet-bashkon-shkollat-e-mesme-ne-nje-debat-per-ndershmerine/>

⁹⁷ <https://mapa.gov.al/newsroom/te-rinjte-ne-qender-te-artit-integriteti-frymezon-ekspozite-ne-kuader-te-javes-se-integritetit/>

të forcimit të mekanizmave institucionalë, gjatë “Javës së Integritetit” u lançua Rrjeti i Koordinatorëve dhe Këshilltarëve të Etikës në administratën publike⁹⁸, si një iniciativë e përbashkët e DAP, IDM dhe MAPA. U prezantua gjithashtu Udhëzuesi për Koordinatorët dhe Këshilltarët e Etikës, i cili standardizon rolin, funksionet dhe instrumentet e punës, duke synuar forcimin e rolit parandalues, këshillues dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e etikës. U shënua edhe 30-vjetori i Agjencisë së Prokurimit Publik⁹⁹, ku u reflektua mbi progresin dhe sfidat e sistemit të prokurimit publik, me theks në transparencën, profesionalizimin, përdorimin e sistemeve elektronike, vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe afrimin me standardet evropiane. Aktiviteti përfshiu edhe vlerësime për nëpunës publikë me performancë të lartë dhe mundësi zhvillimi profesional ndërkombëtar. Në vijim, u zhvillua event i “Integriteti në Shëndetësi”¹⁰⁰, gjatë të cilit u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Ambasadën e Zvicrës, që parashikon asistencë teknike nga Instituti i Bazelit për Qeverisje për forcimin e mekanizmave të parandalimit dhe transparencës në sektorin shëndetësor. “Java e Integritetit 2025” u përmbyll me Konferencën e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit¹⁰¹, ku u prezantuan risitë e platformës “Transparent Albania” dhe u riafirmua angazhimi institucional për transparencë proaktive, llogaridhënie dhe institucione më të hapura, në funksion të procesit të integritetit evropian.

Në tërësi, Java e Integritetit 2025 shërbeu si një platformë e konsoliduar ndërgjegjësimiti, dialogu dhe veprimi, duke kontribuar në forcimin e kulturës së integritetit në administratën publike, përfshirjen e të rinjve dhe rritjen e besimit publik në institucionet shtetërore. Të dhëna më shumë për të mund të gjenden edhe në e-buletinin “antikorrupsioni” dhjetor 2025, në link: <https://antikorrupsioni.gov.al/lista-buletineve/>.

DPAK ka përgatitur dhe hartuar tekstin e Marrëveshje të Bashkëpunimit midis Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe RTSH me qëllim: *bashkëpunim për realizimin dhe transmetimin e programeve televizive për etikën dhe integritetin, që promovojnë ndërgjegjësimin publik dhe luftën kundër korrupsionit, përmes informimit dhe edukimit të publikut lidhur me ndikimet e korrupsionit, pasojat e tij, si dhe mundësitë dhe mekanizmat për ta luftuar atë*. Marrëveshja ka për qëllim të krijojë mundësi të: (1) Prodhimi dhe transmetimi i dokumentarëve, spoteve informuese dhe emisioneve edukative, (2) Promovimi i aktiviteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, (3) Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për publikun, dhe (4) Shkëmbimi i informacionit dhe ekspertizës për përmbajtjen televizive. Marrëveshja e Bashkëpunimit mbetet në proces diskutimi dhe nënshkrimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka vijuar rregullisht me hartimin, shpërndarjen dhe publikimin e e-buletinit mujor “Antikorrupsioni”. E-buletini “Antikorrupsioni” është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimit të përmbledhjeve të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore. Për këtë vit janë publikuar numrat 44-55, të muajve janar-dhjetor 2025. Buletinët mund të gjenden të

⁹⁸ <https://mapa.gov.al/newsroom/lancohet-rrjeti-i-koordinatoreve-dhe-keshilltareve-te-etikes-ne-administraten-publike-gjate-javes-se-integritetit/>

⁹⁹ <https://mapa.gov.al/newsroom/gjate-javes-se-integritetit-shenohet-30-vjetori-i-agjencise-se-prokurimit-publik/>

¹⁰⁰ <https://mapa.gov.al/newsroom/integriteti-ne-shendetesi-firmoset-marreveshja-e-bashkepunimit-me-ambasaden-e-zvices/>

¹⁰¹ <https://mapa.gov.al/newsroom/konferenca-e-vii-te-kombetare-e-se-drejtes-per-informim-permbyll-javen-e-integritetit-2025/>

publikuar dhe aksesohen në link: www.antikorrupsioni.gov.al/lista-buletineve/, dhe gjithashtu profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Facebook, LinkedIn, Instagram. Kjo drejtori përdor gjithashtu një adresë emaili posaçërisht për dërgimin e e-buletinit nga infoak@dpak.gov.al.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 3.1.1. Të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike¹⁰² dhe Antikorrupsionin, dëshmojnë për një qasje proaktive informimi dhe ndërgjegjësimi mbi bazën e së cilat mbështetet edhe raporti i vlerësimit që vendos bazat e vlerave për rritje në vitet në vijim të zbatimit të strategjisë. Ngritja dhe funksionimi i faqes së internetit të DPAK, përdorimi i shtuar i rrjeteve sociale të DPAK, dhe informimi i rregullt i qytetarëve dhe publikut të gjerë nëpërmjet tyre dhe mekanizmve informues (e-buletini antikorrupsion) dëshmojnë për një arritje të vlerës së synuar të treguesit të performancës në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	2025	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2026	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2027	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2028	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2029	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
	2030	Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit
		viti 2025 (targeti i synuar)
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të objektivit 3.1

Niveli i realizimit të Objektivit 3.1 *Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2025 është **100%**.

¹⁰² <https://mapa.gov.al>

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar informimet dhe vizibilitetin e shtuar në përputhje me parashikimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.1 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.1

Për vitin 2025, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk të ulët, duke garantuar vijueshmërinë e informimit dhe ndërgjegjësimit për publikun në luftën kundër korrupsionit.

3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

3.2.1: Përqindja e shkollave në të cilat është zbatuar kurrikula e etikës dhe integritetit nga mesatarja e shkollave ku këto kurrikula janë zbatuar në tre vitet e fundit (trend rritës)

Plani i veprimit për Objektivin 3.2, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 7 aktivitete dhe 3 masë.

Vlera e synuar për treguesin e performancës 3.2.1 për vitin 2025 është: 5% rritje vjetore e numrit mesatar të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (7) dhe masat (3) si më poshtë.

3.2.1	Forcimi i komponentit të etikës dhe integritetit në kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar
3.2.1.1	Kurrikul e harmonizuar për integritetin dhe ligjshmërinë në institucionet e arsimit parauniversitar
3.2.1.3	Marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore jo-publike për përfshirjen e aktiviteteve për etikën dhe integritetin
3.2.2	Forcimi i aspektit të etikës dhe integritetit në programet edukative të medias (TV dhe radio)
3.2.2.1	Marrëveshje bashkëpunimi me RTSH për programe për etikën dhe integritetin
3.2.2.2	Bashkëpunim me transmetues radio-televizivë publike dhe jo-publikë, për programe për etikën dhe integritetin
3.2.2.3	Programe radio-televizive për luftën kundër korrupsionit
3.2.3	Promovimi i rëndësisë së angazhimit proaktiv të të rinjve në antikorrupsion
3.2.3.1	Fushata ndërgjegjësuese, të angazhimit proaktiv i të rinjve në luftën kundër korrupsionit

3.2.3.2	Intensifikimi i përdorimit të rrjeteve sociale dhe opinionistëve të njohur si bashkëpunëtor me të rinjtë për inicimin e angazhimit proaktiv të tyre në luftën kundër korrupsionit
---------	---

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për zbatim përgjatë periudhës dhe që do të vijojnë edhe përgjatë viteve të tjera të zbatimit të planit të veprimit. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, është finalizuar me sukses vlerësimi i kurrikulës arsimore për rishikimin e programit për përfshirjen e tematikave antikorrupsioni. Me dy akte nënligjore, të ministrit të arsimit janë miratuar kurrikula si përkatësisht: Urdhri nr. 555, datë 28.10.2025, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë, të disa klasave të arsimit bazë” dhe Urdhri nr. 556, datë 28.10.2025 i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe të kurrikulës me zgjedhje, të arsimit të mesëm të lartë”. Kurrikula e re përfshin informacione dhe njohuri bazike për korrupsionin, format, pasojat dhe lufta kundër tij, të përshtatshme për nxënësit e klasave të 1-ra, 6-ta dhe të 10-ta.

Edhe për vitin 2025, ka mbetur në fuqi marrëveshja e lidhur në vitin 2023, për zbatimin e projektit “Edukimi kundër korrupsionit”, një nismë të rëndësishme për edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve shqiptarë rreth sfidave dhe pasojave të korrupsionit. Kjo iniciativë është rezultat i një marrëveshjeje bashkëpunimi të nënshkruar më 4 dhjetor 2023, ndërmjet Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ambasadës së Italisë në Shqipëri, me përfshirjen e agjencisë italiane të zbatimit të ligjit, Guardia di Finanza. Projekti ka si qëllim kryesor të ndikojë në ndërgjegjësimin dhe edukimin e nxënësve të shkollave të mesme përmes një serie takimesh dhe aktiviteteve kreative të organizuara në 12 shkolla të mesme në qytetet kryesore të Shqipërisë. Për këtë qëllim në vitin 2025, janë zhvilluar orët mësimore me fillimin e vitit akademik 2025-2026, në shkollat e qytetit Tiranë, në shkollat “Asim Vokshi”, “Ismail Qemali”, “Qemal Stafa”, “Petro Nini Luarasi”, “Eqerem Çabej” dhe “Myslym Keta”. Këto aktivitete u realizuan nga përfaqësues të DPAK dhe kishin në fokus ndërgjegjësimin e nxënësve mbi vlerat e integritetit, etikën, përgjegjshmërinë qytetare dhe rolin e tyre në parandalimin dhe denoncimin e korrupsionit që në moshë të hershme.

Ndërkohë, është formalizuar gjithashtu një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën e shoqërisë civile, ALTRI, për zbatimin e projektit “Fuqizimi i studentëve për integritetin: Lufta kundër korrupsionit në arsimin e lartë”. Në këtë kuadër përgjatë muajve maj-qershor, janë zhvilluar tre sesione të hapura pranë universitetit të Durrësit, Shkodër dhe jo-publik “Marin Barleti” me studentë të rinj (viti i parë). Tematika e orës ishin mekanizmat antikorrupsion dhe urat e etikës dhe integritetit në funksion të tyre.

Marrëveshja e bashkëpunimit me RTSH për të ofruar programe për etikën dhe integritetin mbetet një draft për diskutim dhe miratim, e cila do të hapë gjithashtu udhë transmetimit të emisioneve, intervistave dhe rubrikave që informojnë qytetarët mbi pasojat e korrupsionit dhe promovojnë mekanizmat e raportimit.

Mbeten të porealizuara nisma për emisione dhe programe radio-televizive për etikën dhe integritetin.

Referuar organizimit të fushatave ndërgjegjësimi për angazhimin e të rinjve, në 2025 jan kryer takimet (orë të hapura) në tre universitete Universiteti “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, Universiteti “Marin Barleti” në Tiranë dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu” në Durrës, me auditor studentët e shkencave juridike dhe politike. Njohja dhe prezantimi i DPAK, mekanizmat ligjorë dhe institucionale kundër korrupsionit, rëndësinë e integritetit dhe raportimin e rasteve të korrupsionit, shembuj nga praktika dhe dilema etike u ofruan gjithashtu në takime. Takimet u mbajtën nga stafi teknik dhe lektorë të DPAK iu bashkua edhe eksperti i fushës së drejtësisë, pedagog i studentëve, z. Ervin Karamuço. Gjithashtu, në 9 dhjetor 2025 u zhvillua një takim i hapur (forum) me studentë të fakultetit të Drejtësisë për mekanizmat e parandalimit të korrupsionit, me pjesëmarrje staf drejtues të DPAK.

Është vijuar dhe përmirësuar përdorimi i rrjeteve social të DPAK, në Instagram (drejtoriaepergjithshmeak) me qëllim intesifikimin e komunikimit dhe ndarjes së informacionit. Përgjatë dhjetor 2025, rrjetet sociale të DPAK dhe të MAPA janë populluar me video dhe mesazhe ndërgjegjësimi kundër korrupsionit nga personazhe publike të fushave të ndryshme, vendas dhe të huaj.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 3.2.1. Gjithashtu, rezulton se në përputhje me targetin e treguesit të performancës MAS ka bërë progres me kurrikulën e etikës dhe të antikorrupsionit për shkollat (klasa e 1, 6 dhe 10) e miratuar me dy akte si: Urdhri nr. 555, datë 28.10.2025 i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë, të disa klasave të arsimit bazë” dhe Urdhri nr. 556, datë 28.10.2025 i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e programeve mësimore të disa lëndëve të kurrikulës bërthamë dhe të kurrikulës me zgjedhje, të arsimit të mesëm të lartë”. Programet e reja me temat e posaçme priten të nisin nga zbatimi dhe mësimdhënia në vitin akademik 2026-2027. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance dhe në zbatim të formulës së matjes rezulton se ky tregues është realizuar vetëm në masën 50%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	2025	5% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar
	2026	10% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2027	15% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2028	20% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2029	25% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)
	2030	30% rritje vjetore e numrit mesatat të shkollave ku kurrikula e etikës është zbatuar (kumulative)

Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	% rritje vjetore e numrit mesatat
	viti 2025 (targeti i arritur)	50%

Niveli i realizimit të Objektivit 3.2

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.2 “Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit”*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2024 është **50%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar hartimin e kurrikulës për etikën, në përputhje me parashkrimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.2 për këtë periudhë raportimi është **50%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.2

Për vitin 2025, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk mesatar, e lidhur me nisjen nga zbatimi të programit të kurrikulës së etikës dhe integritetit në shkollat e arsimit parauniversitar.

3.3 Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjësues luftën kundër korrupsionit.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

3.3.1: *Përqindja e fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të institucioneve publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademinë dhe median, nga mesatarja e regjistruar në tre vitet e fundit (trend rritës).*

Plani i veprimit për Objektivin 3.3, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 7 aktivitete dhe 4 masë.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 3.3.1* për vitin 2025 është: 5% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (7) dhe masat (4) si më poshtë.

3.3.1	Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit
3.3.1.1	Institucionalizimi i bashkëpunimit me organizatat dhe dhomat e sektorit privat (marrëveshje bashkëpunimi)
3.3.1.2	Takime konsultimi për përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit në fushën e biznesit midis organeve ligjpropozuese dhe sektorit privat
3.3.1.3	Përmirësimi i mekanizmave për raportimin dhe denoncimin e korrupsionit nga sektori privat, promovimi i mekanizmave dhe nxitja e sektorit privat dhe shoqatave (platforma bashkëpunimi)
3.3.2	Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e organizatave të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit
3.3.2.3	Përmirësimi i ndërveprimit midis autoriteteve publike dhe OSHC-ve mbështetur tek parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP)
3.3.3	Përfshirja e akademisë në luftën kundër korrupsionit
3.3.3.2	Konsultimi i rregullt i dokumenteve të politikave dhe raporteve me ekipin e ekspertëve nga akademia
3.3.3.3	Aktivitet vjetor, i rregullt, me pjesëmarrje të pedagogëve dhe ekspertëve nga akademia, për çështje lidhur me luftën kundër korrupsionit, etikën dhe mekanizma kundër korrupsionit
3.3.4	Përfshirja e medias dhe gazetarisë në luftën kundër korrupsionit
3.3.4.2	Takime periodike (3-mujore) me Rrjetin e Gazetarisë Aktive kundër Korrupsionit

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve të parashikuara për zbatim përgjatë periudhës dhe në vijim. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka draftuar një projekt-marrëveshje bashkëpunimi për tu lidhur dhe zbatuar në vijim me njësitë dhe përfaqësuesit e sektorit privat (bizneset). Marrëveshja pritet të krijojë një platformë gjithëpërfshirëse bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve publike, për promovimin e integritetit dhe standardeve antikorrupsion në Shqipëri. Marrëveshja synohet të lidhet midis autoritetit përgjegjës për antikorrupsionin dhe dhomave përfaqësuese të sektorit privat (dhoma biznesi, shoqata biznesi).

Referuar takimeve të konsultimit të akteve ligjore në fushën e biznesit midis organeve ligjpropozuese dhe sektorit privat (aktiviteti 3.3.1.2) nuk paraqiten raste të tilla për vitin 2025.

Në vitin 2025 me aksesimin e faqes së internetit të DPAK, u shtua edhe një tjetër mekanizëm raportimi të rasteve të korrupsionit si konkretisht në platformë: <https://antikorrupsioni.gov.al/denonco-korrupsionin/> . Gjithashtu, me lancimin e platformës www.rrjetantikorrupsioni.al ku DPAK dhe staf i saj janë anëtarë përmendet gjithashtu një tjetër mekanizëm i shtuar për denoncime dhe njoftime rastesh korrupsioni. Gjithashtu, kanë qenë në përdorim mekanizmat e njohur dhe të aplikueshëm më parë si përmenden: adresa koordinatori.ak@dpak.gov.al, kontaktet e Koordinatorëve Antikorrupsion, mënyra e komunikimit zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Gjithashtu, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka mbajtur funksionale një dritare të dedikuar për të denoncuar korrupsionin në platformën e bashkëqeverisjes, ku çdo qytetar dhe biznes mund të dërgojë denoncimin dhe të paraqesë fakte për një veprim korruptiv të ndodhur ose të mbetur në tentativë, kur punonjës të administratës shtetërore apo drejtues institucionesh kanë kërkuar favore apo kanë kryer veprime abuzive. Faqja zyrtare e institucionit: <https://adb.gov.al/> ka rubrikë të posaçme për ‘Denonco Korrupsionin’, për të kanalizuar denoncimet e qytetarëve dhe bizneseve në momentin e përballjes me situata që mbartin elemente korruptive, mitmarrje, etj, që është realizuar në mënyrë që të jetë lehtësisht e përdorshme. Në këtë platformë, janë administruar në total 29 ankesa të ardhura në rubrikën Denonco Korrupsionin, nga të cilat: qytetarë për 25 çështje; biznese për 4 çështje dhe nga të cilat janë përfunduar 21 çështje. ADB monitoron procesin në mënyrë të përditshme dhe në bashkëpunim të ngushtë me strukturën përkatëse, Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Në vitin 2025, DPAK promovoi prej muajit qershor bashkëpunime me shoqërinë civile për nisma konkrete, si përmenden metodologjia e vlerësimit të riskut të korrupsionit, në link: <https://rrjetiantikorrupsion.al/trajnimi-mbi-metodologjine-e-vleresimit-te-riskut-te-korrupsionit20-maj-2025/>, për të vijuar me pjesëmarrjen aktive në lancimin e platformës si një mjet praktik për bashkëpunim, koordinim dhe nisma të përbashkëta ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Platforma ofron hapësirë për dialog, shkëmbim informacioni dhe ndarjen e praktikave të mira, duke mbështetur një qeverisje më të hapur dhe të përgjegjshme, edhe në link: <https://rrjetiantikorrupsion.al/partneritet-per-integritet-dhe-transparence-18-dhjetor-2025/>.

Platforma është konceptuar si një kanal komunikimi midis Organizatave të Shoqërisë Civile të angazhuara në luftën kundër korrupsionit dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari. Platforma synon të inkurajojë pjesëmarrjen e institucioneve kundër korrupsionit, mediave, qytetarëve dhe bizneseve për të ndarë informacionin dhe për të diskutuar dhe avokuar për çështjet relevante. Për këtë qëllim në vitin 2025 është konsultuar raportit të monitorimit vjetor të zbatimit të strategjisë antikorrupsion dhe planit të veprimit, 2024 (maj 2025, njoftimi për pjesëmarrje në punimet e takimit të Ekipit Tematik Antikorrupsion, në 10 qershor 2025¹⁰³ dhe të Planit të Integritetit të ASHK, në link: https://rrjetiantikorrupsion.al/wp-content/uploads/2025/06/Plani-i-Integritetit-ASHK_-per-konsultim-final.pdf.

Raportet e monitorimit të SNKK të hartuar në vitin 2025, ftesa dhe njoftime për pjesëmarrje në takime konsultimi janë kryer në muajt shtator-nëntor 2025 për ligjet e hartuara nga MAPA si ato për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, dhe ai ëpër lobimin janë njoftuar nëpërmjet rrjeteve sociale, e-buletinit dhe komunikimit elektronik me email. Një takim vjetor me ekspertë dhe teknikë që vijnë nga akademia (aktiviteti 3.3.3.3) nuk është arritur të zhvillohet.

Në kuadër të takimeve periodike me Rrjetin e Gazetarisë Aktive kundër Korrupsionit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar takimin e përvitshëm me përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias investigative. Diskutimet u fokusuan në problematikat dhe vështirësitë e hasura nga gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile në sigurimin e informacionit nga autoritetet publike, si dhe në nevojën për forcimin e

¹⁰³ <https://mapa.gov.al/newsroom/miratohet-raporti-i-monitorimit-te-strategjiise-ndersektoriale-kunder-korrupsionit-2024-2030/>.

kulturës së transparencës institucionale. Gjatë këtij takimi u theksua domosdoshmëria e identifikimit të mekanizmave shtesë për thjeshtimin dhe zbatueshmërinë më efektive të legjislacionit për të drejtën e informimit, me qëllim rritjen e eficiencës së autoriteteve publike në dhënien e informacionit të plotë dhe në kohë. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, organizoi Konferencën e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit me temë “Agora e transparencës në kohën e integritetit”¹⁰⁴. Konferenca shërbeu si platformë dialogu ndërmjet autoriteteve publike, medias, shoqërisë civile dhe institucioneve akademike, duke adresuar sfidat e transparencës institucionale dhe forcimin e llogaridhënies në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 3.3.1. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit kanë zhvilluar fushatën kombëtare të ndërgjegjësimit “Java e integritetit, 2025” me pjesëmarrje të grupeve të interesit. Gjithashtu, funksionarë politikë pranë ministrit të linjës, dhe staf teknikë të DPAK i janë bashkuar fushatave të ndërgjegjësimit dhe projekteve të bashkëpunimit me fokus edukimin kundër korrupsionit siç përmenden: projekti me shoqërinë civile¹⁰⁵ “Fuqizimi i studentëve mbi integritetin: Lufta kundër korrupsionit në arsimin e lartë”, përgjatë mars-prill 2025, gjithashtu dhe bashkëpunimi me sektorin privat¹⁰⁶ për konsolidimin e instrumenteve të integritetit (Planet e Integritetit) në nëntor 2025. Gjithashtu përmendet edhe pjesëmarrja në fushatën e ndërmarrë nga studentët e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë për ndërgjegjësimin e mekanizmave kundër korrupsionit, në dhjetor 2025. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance dhe në zbatim të formulës së matjes rezulton se ky tregues është realizuar vetëm në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	2025	5% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media
	2026	10% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2027	15% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2028	20% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarrë nga autoritetet publike me

¹⁰⁴ <https://idp.al/2025/12/16/konferenca-e-vii-kombetare-per-te-drejte-e-informimit/>.

¹⁰⁵ Me Qendra Altri.

¹⁰⁶ Me Dhomenë Amerikane të Tregtisë.

		sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2029	25% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarra nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
	2030	30% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarra nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media (kumulative)
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	5% rritje e numrit të fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të ndërmarra nga autoritetet publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademisë dhe media
	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të Objektivit 3.3

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.3. Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjësues luftën kundër korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2025 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar planifikimin dhe organizimet e bëra, në përputhje me parashikimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.3 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.3

Për vitin 2025, realizimi i objektivit paraqet risk të ulët pasi ka rezultuar me zhvillim të mirë kryerja e bashkëpunimeve me grupet e përmendura të interesit për fushatat e ndërgjegjësimit.

3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performace:

3.4.1: *Raporti i numrit i projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor në krahasim me numrin tyre në tre vitet e fundit.*

Plani i veprimit për Objektivin 3.4, në periudhën Janar-Dhjetor 2025 parashikon 2 aktivitete dhe 2 masa.

Vlera e synuar për *treguesin e performancës 3.4.1* për vitin 2025 është: 5% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore.

Për të arritur vlerat e treguesit në përputhje me pasaportën e treguesve të performancës dhe konkretisht me planin e veprimit 2024-2026, janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

3.4.1	Përfshirja e komponentit gjinor në termat e referencës dhe përcaktimi i një buxheti specifik për projektet e integritetit dhe të antikorrupsionit, të shpallura nga AMSHC
3.4.1.1	Tryezë vjetore me pjesëmarrje gratë dhe vajzat mbi rolin e tyre dhe angazhimin në forcimin e integritetit të administratës publike dhe luftën kundër korrupsionit
3.4.2	Organizimi i aktiviteteve komunikuese dhe ndërgjegjësuere me palë të interesuara me fokus perspektivën gjinore në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit
3.4.2.1	Veprimtari kundër korrupsionit të qytetareve/qytetarëve, aktivisteve/aktivistëve të të drejtave të njeriut dhe grupeve të interesit të grave dhe vajzave si pjesë përbërëse e kalendarit të aktiviteteve gjatë “Javës së Integritetit”

Realizimi i masave të parashikuar kryhet përmes aktiviteteve të parashikuar përgjatë periudhës dhe në vijim. Matja dhe ecuria do të bëhet mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Gjatë janar – dhjetor 2025, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në përputhje me prioritetet strategjike për nxitjen e transparencës, barazisë dhe forcimin e rolit të organizatave të shoqërisë civile, ka intensifikuar përpjekjet për të promovuar tematika me rëndësi të veçantë si antikorrupsioni dhe qasja gjinore. Në kuadër të Thirrjes për Projekte nr. 18 ([vendimi nr. 03, datë 07.07.2025](https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Vendimi-nr-03-date-07.07.2025.pdf)) (<https://amshc.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Vendimi-nr-03-date-07.07.2025.pdf>), janë paraqitur gjithsej 160 aplikime, nga të cilat 36 projekte adresonin në mënyrë të drejtpërdrejtë çështje që lidhen me antikorrupsionin me fokus gjinor, një rritje domethënëse krahasuar me thirrjet e mëparshme, që dëshmon qartë efektin pozitiv të masave sensibilizuese të ndërmarra nga institucioni. Gjatë kësaj periudhe, janë paraqitur 6 aplikime me këtë fokus specifik, prej të cilave 4 janë përzgjedhur për financim, ndërsa 2 janë skualifikuar për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë.

Gjithashtu, AMSHC ka organizuar dhe zhvilluar 6 sesioneve konsultative publike në qytetet Vlorë, Berat, Pogradec, Kukës, Shkodër dhe Tiranë, me pjesëmarrjen aktive të mbi 75 organizatave të shoqërisë civile vendore. Këto të dhëna reflektojnë jo vetëm një trend pozitiv në rritje të interesit për tematika prioritare si antikorrupsioni dhe qasja gjinore, por edhe efektivitetin e punës së vazhdueshme të AMSHC për të krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e projekteve me impakt të gjerë shoqëror dhe qasje gjithëpërfshirëse.

Nuk ka të dhëna për organizimin e një tryeze (aktiviteti 3.4.1.1) për rolin e grave dhe vajzave në forcimin e integritetit dhe etikës si mekanizma antikorrupsioni.

Përgjatë aktiviteteve të Javës së Integritetit 2025, janë zhvilluar larmi organizimesh nga MAPA, DPAK dhe partnerë të tyre të fushës. Detaje dhe të dhëna mund të gjenden në numrin 55 të e-buletinit Antikorrupsioni, të publikuar në link: <https://antikorrupsioni.gov.al/lista-buletineve/>.

Sa më sipër, masat dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2025, kanë ndikuar drejtpërdrejt në vlerën e synuar të treguesit të performancës 3.4.1. Më konkretisht, AMSHC ka financuar 17 projekt-propozime me një grant prej 23,400,000 Lekë, me tematikë aplikimin e projekteve antikorrupsion (prioritet “Qeverisja e mirë dhe Antikorrupsioni) dhe zhvillimin e politikave informuese për parandalimin e tij. Projektet antikorrupsion zënë 21,4% të gjithë projekt-propozimeve vjetore të kërkuara dhe dorëzuara. Si rezultat, mbështetur në të dhënat e administruara ky tregues performance dhe në zbatim të formulës së matjes rezulton se ky tregues është realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2023	
	N/A	
	2024	Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe vendosja e nivelit bazë për fillimin e matjes
	2025	5% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore
	2026	10% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	2027	15% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	2028	20% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	2029	25% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
	2030	30% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore (kumulative)
Vlera synuar/ Targeti	viti 2025 (targeti i synuar)	5% rritje vjetore e projekteve kundër korrupsionit me bazë gjinore
	viti 2025 (targeti i arritur)	100%

Niveli i realizimit të Objektivit 3.4

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.4. Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm*, në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-dhjetor 2025 është **100%**.

Përlllogaritja është kryer duke matur dhe evidentuar të dhënat në përputhje me parashkimin e bërë në listën e treguesve të performancës, aneks 2 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.4 për këtë periudhë raportimi është **100%**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin që administron dhe koordinon Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe nga AMSHC.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.4

Për vitin 2025, realizimi i objektivit ka rezultuar në risk mesatar, që do të ndikohet nga ecuria e zbatimit të projekteve të përzgjedhura nga AMSHC.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 4 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve kundër korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjesuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e korrupsionit është **87.5%**.

Objektivi	Realizueshmëria
3.1. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin	100%
3.2. Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit	50%
3.3. Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjësues luftën kundër korrupsionit	100%
3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm	100%

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e korrupsionit, e cila është në masën 87.5%, tregon për një progres të qendrueshëm në forcimin e kulturës së integritetit dhe transparencës publike përgjatë periudhës janar – dhjetor 2025.

Si rezultat, u ndërmorën një sërë aktivitete me synim ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për pasojat e korrupsionit dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive në parandalimin dhe raportimin e tij. U hartua Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit antikorrupsion për vitin 2025, i cili përfshinte 8 aktivitete ndërgjegjëse, me fokus promovimin dhe edukimin antikorrupsion mbështetur tek etika dhe integriteti, aktiviteteve me të rinjtë/studentë. Është kryer me sukses i edicioni i VII-të i “Javës së Integritetit”, dhe publikim i rregullt të e-buletinit antikorrupsion. Publikimi i faqes së internetit të DPAK, shton mjetet e komunikimit masiv antikorrupsion. Finalizimi i kurrikulës antikorrupsion për moshat e reja, si pjesë e programit të arsimit të mesëm para-universitar ofron një risi dhe hap progresi për edukimin dhe informimin e të rinjve në luftën kundër korrupsionit. Janë shënuar bashkëpunime dhe projekte me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin antikorrupsionin në bashkëpunime me OSHC dhe sektorin privat. AMSHC ka financuar 17 projekt-propozime me një grant prej 23,400,000 Lekë, me tematikë aplikimin e projekteve antikorrupsion (prioritet “Qeverisja e mirë dhe Antikorrupsioni”).

Këto zhvillime të objektivëve 3.1-3.4, dëshmojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik si një shtyllë thelbësore e strategjisë.

IV. PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVËT, REZULTATET DHE IMPAKTIN

4.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Mbështetur në informacionin mbi vlerat e synuar të aktiviteteve dhe masave të realizuara, të treguesve të performances, realizimi i objektivave për *janar - dhjetor 2025* është si më poshtë.

Realizimi sipas aktiviteteve e masave	Realizimi sipas treguesve
<p><u>Dobët</u> – 1 objektiv <u>Mjaftueshëm</u> - 3 objektiva <u>Mirë</u> - 5 objektiva <u>Shumë mirë</u> - 7 objektiva</p>	<p><u>Dobët</u> - 1 objektiv <u>Mjaftueshëm</u> - 1 objektivë <u>Mirë</u>- 2 objektivë <u>Shumë mirë</u> - 11 objektiva *<u>Nuk matet për këtë raport monitorimi</u> – 1 objektiv</p>

Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën *janar - dhjetor 2025*, në zbatim të Planit të Veprimit 2024 - 2026, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, mbështetur në realizueshmërinë e masave prioritare evidentuar në pjesën III të saj, janë si më poshtë vijon:

1. Në vitin 2025, janë hartuar analiza të thelluara ligjore që kanë shërbyer si bazë për zhvillimin e paketës ligjore “Antikorrupsion”, përfshirë miratimin e kuadrit ligjor në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve (ligj i miratuar nga Kuvendi), të lobimit (ligj i miratuar nga KM), donacioneve dhe sponsorizimeve (përgatitje për projektligj) si dhe nismat për konfliktin e interesit dhe kontrollin e financimit të partive politike (projektligje për miratim në Kuvend).
2. Në vitin 2025, është miratuar Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik, duke krijuar një instrument standard për identifikimin dhe menaxhimin proaktiv të risqeve, si dhe duke hapur rrugë për zhvillimin e metodologjive sektoriale dhe zbatimin e tyre në sektorë me risk të lartë si prokurimi publik për të cilën është miratuar metodologjia e vlerësimit të riskut të korrupsionit nga APP.
3. Në vitin 2025, është konsoliduar rrjeti kombëtar i Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në nivel qendror dhe vendor, duke forcuar kapacitetet teknike për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e SNKK, në mbështetje të rolit koordinues të DPAK, konsoliduar rrjeti koordinatorëve të të drejtës së informimit, të etikës, të integritetit.

4. Në vitin 2025, është përfunduar rishikimi i kurrikulës së lëndës “Qytetaria”, me përfshirjen e tematikave antikorrupsion për klasat e 1-ra, 6-ta dhe të 10-ta. Programet janë miratuar në vitin 2025 dhe pritet të zbatohen nga viti shkollor 2026–2027, duke kontribuar në edukimin e hershëm për integritetin.

5. Në vitin 2025, ILDKPKI ka vendosur 75 masa administrative gjobë, për subjekte që kanë detyrimin e dorëzimit të deklaratave të pasurisë në përfundim të kontrollit të tyre.

6. Në vitin 2025, Prokuroria e Posaçme dhe prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm kanë vijuar hetimet për veprat penale të korrupsionit dhe përfunduar 275 çështje për korrupsion.

7. Në vitin 2025, është funksionalizuar faqja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe ka vijuar publikimi i rregullt i e-buletinit “Antikorrupsioni”, si dhe komunikimi i vazhdueshëm përmes rrjeteve sociale, duke rritur aksesin e publikut në informacion dhe ndërgjegjësimin mbi politikat antikorrupsion.

8. Në vitin 2025, janë zhvilluar leksione dhe aktivitete ndërgjegjësuese me studentët në kuadër të projekteve për integritetin në arsimin e lartë, duke forcuar rolin e të rinjve në promovimin e vlerave kundër korrupsionit.

9. Në vitin 2025, AMSHC ka publikuar thirrjen e 18-të, nga e cila janë përzgjedhur fituese 4 projektpropozime me fokus gjinor.

4.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën 1 janar - 30 dhjetor 2025, rezulton se mbështetur në ecurinë e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe të angazhimeve të Planit të Veprimit për vitin 2025, rezulton se:

- Objektiva që paraqesin probleme zbatimi:

Në Politikën I (Parandalimi), objektivi specifik 1.3 (prej 25%) dhe 1.5 (0-30% të masave të zbatuara) tregojnë për vonesa në ndjekjen e masave sektoriale me risk të lartë dhe në mbrojtjen e financave dhe të përdorimit të aseteve publike. Në Politikën II (Ndëshkimi) objektivi 2.2 duhet adresuar nevoja për përmirësim të kapaciteteve dhe mekanizmave për ruajtje të trendit ulës të çështjeve të mbartura (*backlog*) nga organet që ndjekin procedimet penale. Në Politikën III (Ndërgjegjësimi), objektivi 3.2 mbetet ende në 50%, duke reflektuar intensitet të pamjaftueshëm të përfshirjes së të rinjve/aktorëve shoqërorë dhe të sektorit privat.

- Zbatim metodologjisë së riskut të korrupsionit në fillim të zbatimit dhe për hartimin e planeve të veprimit me masa parandaluese:

Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik po edhe metodologjitë e vlerësimit për hapësirat e legjislacionit për shërbimet e kuvendit janë miratuar dhe filluar aplikuar, por kërkojnë ende kohë për testim sektorial si në: prokurime publike, prona dhe fillimi në dogana, tatime, shëndetësi dhe arsim.

- Përfshirje jo e mjaftueshme e aktorëve jo-publikë, partnerë me administratën publike:

Angazhimi i OSHC-ve, akademisë, dhe sektorit privat në bashkërendim, dhe konsultim e komunikim është akoma jo në nivele të kënaqshme, duke kufizuar impaktin e ndërhyrjeve të ndërgjegjësimit dhe informimit.

4.3 Konkluzione dhe rekomandime

Ky raport monitorimi është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës (qasjeve të strategjisë), të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve të performancës sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të zbatueshmërisë së masave (produkte) të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe një identifikim të masave të nevojshme korigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit *janar – dhjetor 2025*, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për ndjekje dhe përmirësim procesi dhe zbatimi të masave antikorrupsion janë:

Masa ligjore:

- Të miratohet projektligji *Për Lobimin*;
- Të miratohet projektligji *Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike*;
- Të hartohet projektligji *Për donacionet dhe Sponsorizimet*;
- Të vijohet me procesin për hartimin e projektligjit *Për Financimin e Partive Politike*.

Masa rregullatore:

- Të finalizohen metodologjitë sektoriale të vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorin e pronave e të nisë zbatimi i tyre dhe vlerësimi i riskut të korrupsionit dhe po ashtu instrumentat sektoriale në dogana e tatime, arsim e shëndetësi;
- Të nisë vlerësimi i riskut të korrupsionit në këta sektorë dhe hartime të planeve të veprimit sektorial antikorrupsion për të gjithës sektorët vulnerabël;
- Të miratohen instrumentet e planeve të integritetit në të gjithë njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki);
- Të lidhen marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve publike dhe, me autoritete jo-publike.

Masa operacionale dhe të rritjes e shtimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike të institucioneve:

- Të ruhet progresi për forcimin e njësive si: pika kontakti antikorrupsion, koordinatorë të së drejtës së informimit; koordinatorë integriteti;
- Të ketë përmirësim të ekspertizave teknike e operacionale të stafeve të njësive publike dhe në institucionet e drejtësisë për çështje të integritetit dhe krimit të korrupsionit;
- Të reduktohet mbartja (*backlog*) i rasteve në hetim për korrupsion nga prokuroritë;
- Të ketë përmirësim të ndërgjegjësimit publik për raportimin e korrupsionit nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit, takime, forume, aktivitete publike.

Konkluzione të përgjithshme:

- Të përmirësohet raportimi financiar dhe të rritet niveli i raportimit standard sipas metodologjisë së ndjekur.
- Të përmirësohet përfshirja e aktorëve jo-publikë, OSHC, akademi/universitete, sektori privat) për incimin dhe zbatimin e elementëve të ndërgjegjësimit të luftës kundër korrupsionit.

V. RISQET DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

5.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur treguesit

Në këtë raport monitorimi, *janar - dhjetor 2025*, është kryer vlerësimi i riskut për çdo objektiv në përputhje me analizën e riskut të sjellë prej institucioneve përgjegjëse ose në mungesë të kësaj analize, të vlerësimit që vetë stafi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion i ka bërë riskut në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së objektivave.

Një listë të risqeve potenciale për vijimësinë e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, të strukturuar sipas natyrës së tyre mund të jenë:

- Kapacitete të pabarabarta (stafe të pamjaftueshme në bashki dhe institucione qendrore).
- Cilësia e të dhënave të raportuara jo e mirë (nevojë e shtuar për konsultime me DPAK).
- Koordinim ndërinstitutional jo i mjaftueshëm.
- Burime financiare të kufizuara.

5.2 Hapat e radhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën për periudhën *janar-dhjetor 2025* të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen këto hapa në vijim:

Së pari, të planifikohet kryerje e procesit të vlerësimit të riskut në prokurimin publik dhe prona, duke pasur në vëmendje përdorimin e metodologjive të fushës. Vlerësimi sektorial do të vijohet përgjatë vitit 2026 dhe në sektorët e shëndetësisë, arsimit, tatime dhe dogana.

Së dyti, të intensifikohet bashkëpunimi midis organeve ligjzbatuese, dhe atyre dhe administratës publike me qëllim rakordimin e masave për raste dhe indicje korrupsioni në sektorin publik dhe nga zyrtarët publikë.

Së treti, të respektohen dhe ndiqen me kujdes plotësimi i raportimit të formateve për të dhënat, si dhe llogaritja e kostos së zbatimit të SNKK.

Së katërti, të përmirësohet koordinimi dhe bashkërendimi i proceseve për hetimin administrative dhe në ndjekje të rekomandimeve nga Drejtoria e Përgjithshme të Antikorrupsionit kundrejt organeve të tjera.

Së pesti, të përmirësohet sistemi u monitorimit të brendshëm të strategjisë antikorrupsion, përmes indikatorëve të matshëm dhe të lidhur drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie në çdo fazë të zbatimit të strategjisë (në relevancë me Manualin e Zbatimit të strategjisë).

Së fundi, të rritet bashkëpunimi me OSHC, akademinë, sektorin privat bazuar tek një kalendar i përbashkët konsultimesh dhe iniciativash të përbashkëta.